




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS**

RELACION


PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK

Ne Zbatim të Urdherit Nr. 794, datë 28.12.2012 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për projektin Trans Adriatik (Projekti TAP)”

Tirane, Shkurt, 2013

	faqe 2 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

 REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES			
PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL PËR GAZSJELLËSIN TRANS ADRIATIK Ne Zbatim të Urdherit Nr. 794, datë 28.12.2012 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës "Për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për projektin Trans Adriatik (Projekti TAP)"			
 Koordinatori i Autoritetit Planifikues	Zoti Sokol Dervishaj	Zevendesminister	
	Prof. Asc. Dr. Stavri Dhima	Pergjegjes Sektori S.RR.M.P.K.H. (DSE)	
Bazuar ne dokumentin mbi të dhënat e mbledhura për Planin Kombëtar Sektorial për projektin TAP, të prezantuar nga Trans Adriatic Pipeline AG			
Date: 18 Shkurt, 2013			

		faqe 3 nga 147
Autoriteti Planifikimit	Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al
Titulli i Dokumentit:	Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	

Përmbajtja

1	Hyrje	7
1.1	Projekti TAP	7
1.2	Qëllimi dhe fusha e veprimit	9
1.3	Metodologjia	9
1.4	Shkurtimet	11
2	Referencat	12
3	Vizioni strategjik i planifikimit të hapësirës dhe zhvillimit të territorit për korridorin e projektit TAP	13
3.1	Vizioni strategjik për projektin TAP	13
3.2	Zhvillimi territorial i projektit TAP	15
4	Parimet e zhvillimit të hapësirës dhe "kohezionit" të territorit	19
4.1	Zbërthimi i konceptit të zhvillimit policentrik territorial, ndërkufitar dhe ndërkombëtar	19
4.2	Programet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale në përputhje me prioritetet e integritimit në BE	20
5	Dokumentet e politikës kombëtare dhe kuadri ligjor	21
5.1	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	21
5.1.1	Strategjia e Energjisë	24
5.1.2	Alternativa strategjike për të lidhur Shqipërinë me rrjetin ndërkombëtar të naftës dhe gazit	26
5.1.3	Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve	27
5.1.4	Strategjia Sektoriale dhe Ndërsektoriale për Mjedisin	28
5.1.5	Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit	30
5.1.6	Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit	31
5.1.7	Strategjia Sektoriale e Transportit	32
5.1.8	Strategjia Sektoriale e Turizmit	34
5.1.9	Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Mbrojtjes	36
5.1.10	Strategjia e Mbrojtjes Sociale	36
5.1.11	Strategjia e punësimit	37
5.1.12	Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimetve	38
5.1.13	Strategjia e Përfshirjes Sociale	40
5.2	Zhvillimi strategjik për planifikimin rajonal të territorit	41
5.3	Kuadri ligjor kombëtar	45
6	Alternativa e planifikimit të territorit për projektin TAP	48
6.1	Alternativat e gjurmës në pjesën kontinentale	48
6.2	Përfundimet e vlerësimit të alternativave	50
6.2.1	Seksioni qendror	50
6.2.2	Seksioni perëndimor	52
6.2.3	Seksioni Lindor i gjurmës së TAP-it	59



6.3	Alternativa e preferuar e gjurmës për projektin TAP	66
6.4	Alternativat e gjurmës në seksionin detar	67
7	Analiza makro-ekonomike, sociale, mjedisore, demografike dhe territorial	69
7.1	Demografia	69
7.1.1	Migrimi dhe ndryshimi i popullsisë	73
7.2	Përdorimi dhe pronësia e tokës brenda gjurmës së projektit TAP	75
7.2.1	Përdorimi i tokës së përfshirë në projektin TAP	75
7.2.2	Pronësia e tokës	80
7.3	Ekonomia, Punësimi dhe të Ardhurat	82
7.3.1	Vështrim i Përgjithshëm në nivel Kombëtar	82
7.3.2	Ekonomia dhe mjetet e jetesës në zonën e studimit	84
7.3.3	Prodhimi Bujqësor	89
7.3.4	Mjedisi socio-ekonomik në pjesën detare	98
7.3.5	Portet	99
7.3.6	Trafiku detar	101
7.3.7	Peshkimi në zonën e studimit	104
7.4	Zonat me rëndësi kombëtare	106
8	Përcaktimi i territorit për projektin TAP brenda korridorit 500 m	107
8.1	Karakteristikat e gjurmës së gazsjellësit në seksionin detar	107
8.2	Karakteristikat e gjurmës së gazsjellësit në pjesën kontinentale	108
8.3	Zonat koncesionare	109
8.4	Zonat bujqësore	113
8.5	Pylli dhe toka kullotë	117
8.7	Zonat turistike	121
8.8	Zonat e mbrojtura dhe të përcaktuara	122
8.8.1	Përshkrim i përgjithshëm për zonat e mbrojtura të mjedisit natyror	122
8.8.2	Zonat e mbrojtura për trashëgiminë e tyre kulturore	127
8.9	Rrjeti Kombëtar i Infrastrukturës	138
8.9.1	Infrastruktura e rrugëve; qarkullimi dhe transporti	138
8.9.2	Infrastruktura e Arsimit	140
8.9.3	Infrastruktura e Shëndetësisë	141
8.9.4	Kanalet e vaditjes dhe të kullimit	143
8.9.5	Linjat e rrjetit elektrik	145
9	Përshkrimi teknik dhe teknologjik i projektit TAP	146
10	Përpunimi i të dhënave në formatin GIS (Sistemit Informativ Gjeografik)	147

LISTA E TABELAVE

Tabela 5-1:	Planet e Zhvillimit Rajonal dhe Komunal.....	43
Tabela 6-1:	Çështjet kryesore në lidhje me secilën prej vendndodhjeve të mundshme të CS03 56	
Tabela 6-2:	Treguesit e ndikimit të përdorur për vlerësimin e Alternativës 6A të gjurmës	63
Tabela 7-1:	Lista e Vendbanimeve brenda Zonës së Studimit Social.....	69
Tabela 7-2:	Vendbanime të Studiuara dhe Popullsia Përkatëse brenda zonës së studimit socio-ekonomik.....	71
Tabela 7-3:	Klasifikim i Tokës (Bujqësore, Pyje, Kullota, Urbane) – Korridor prej 500 m.....	78
Tabela 7-4:	Përdorimi i Tokës sipas Rretheve	79


		faqe 5 nga 147
Autoriteti Planifikimit	Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al
Titulli i Dokumentit:	Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	

Tabela 7-5:	Linjat e trageteve që kalojnë tërthor gazsjellësit.....	104
Tabela 8-1:	Lista e zonave minerare që ndodhen Brenda, ose ne afersi te gjurmës prej 2 km te korridorit te projektit TAP.....	110
Tabela 8-2:	Lista zonave minerare të planifikuara brenda nje korridori prej 2 km të gjurmës së projektit TAP	111
Tabela 8-3:	Studimet e përdorimit bujqësor të vendndodhjeve të tokës	114
Tabela 8-4:	Lista e pronave shtetërore te paluajtshme, nën përgjegjësinë dhe administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes, përgjate korridorit prej 2km të gjurmës së projektit TAP.	119
Tabela 8-5:	Zonat e mbrojtura dhe zonat me rëndësi për ruajtje brenda zonës së studimit të korridorit 2km të gazsjellësit.....	124
Tabela 8-6:	Lista e sajteve të trashëgimisë kulturore dhe zonave me potencial të madh arkeologjik	128
Tabela 8-7:	Sistemi vaditës brenda gjurmës 2 km të TAP-it.....	144

LISTA E FIGURAVE

Figura 1-1:	Gjurma e gazsjellësit TAP në Shqipëri	8
Figura 3-1:	Konteksti i rrejtit të transmetimit të gazit të TAP-it	14
Figura 3-2:	Vështrim mbi shtrirjen e projektit TAP	16
Figura 3-3:	Gjurma e TAP-it në seksionin kontinental në Shqipëri.....	18
Figura 3-4:	Gjurma e TAP-it në seksionin detar	18
Figura 6-1:	Zona e projektit me alternativat e vlerësuara të gjurmës në periudhën ndërmjet 2003 dhe 2009.....	49
Figura 6-2:	Rajoni i Hotovës, korridoret e gjurmëve të vlerësuara dhe seksionet e vështira ..	50
Figura 6-3:	Alternativa 3 (në jug) dhe Alternativa 6 (në veri)	51
Figura 6-4:	Alternativa 6 e gjurmës nga fundi vitit 2010.....	53
Figura 6-5:	CS03 Vendndodhjet e mundshme	54
Figura 6-6:	Gjurma e afrimit në breg të detit dhe alternativat e vendndodhjes së daljes në det	55
Figura 6-7:	Pamje nga afër e alternativave 6A deri në 6D të vendndodhjes së daljes në det	58
Figura 6-8:	Kanali Roskovec-Hoxharë i ndotur me naftë bruto	59
Figura 6-9:	Pistë skish në zonën ndërmjet Korçës - Boboshticës - Dardhës	60
Figura 6-10:	Zonë me potencial turizmi në Dardhë (Komuna Drenovë).....	61
Figura 6-11:	Alternivat e gjurmës së "Lakut të Korçës"	62
Figura 6-12:	Alternativa 6A e gjurmës së rastit bazë.....	67
Figura 6-13:	Alternivat makroskopike të gjurmës në det.....	68
Figura 7-1:	Shpërndarja e Popullsisë përgjatë Gjurmës së Gazsjellësit	72
Figura 7-2:	Zotërimi i tokës nga familjet e përfshira në studim, para vitit 1945	81
Figura 7-3:	Punësimi sipas Aktivitetit Ekonomik në Shqipëri	83
Figura 7-4:	Aktivitetet Ekonomike në Vendbanimet brenda korridorit të gjurmës së gazsjellësit TAP	85
Figura 7-5:	Aktivitetet Ekonomike në Vendbanimet brenda korridorit të gjurmës së gazsjellësit TAP	85
Figura 7-6:	Burimet e të ardhurave të familjeve (% e kontributit të secilit burim) sipas rretheve	86
Figura 7-7:	Totali i të ardhurave të familjeve që përfshin korridori i gazsjellësit TAP (`000 Lek)*	88
Figura 7-8:	Punësimi i kryefamiljarëve brenda korridorit të gjurmës së gazsjellësit TAP	89
Figura 7-9:	Aktivitetet bujqësore që kryhen prej familjeve brenda korridorit të gazsjellësit TAP (sipas rretheve).....	90
Figura 7-10:	Pamje satelitore të ullishtave në Otllak, rrethi Berat (gazsjellësi me të verdhë) ...	92
Figura 7-11:	Pamje satelitore të Zonës së Zhvillimit në Fier (me ngjyrë blu)	94


	faqe 6 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Figura 7-12:	Zona e studimit socio-ekonomik në pjesën detare (me ngjyrë të kuqe)	98
Figura 7-13:	Pamje e Portit të Durrësit	100
Figura 7-14:	Trafiku Detar monitoruar në 2008 (gazsjellësi me të kuqe)	102
Figura 7-15:	Skicë e Dendësisë së Trafikut të Anijeve (gjurma e gazsjellësit me të kuqe) (anije/ditë)	103
Figura 7-16:	Komunitetet lokale të peshkimit	105
Figura 8-1:	Vendndodhjet e Studimeve në Terren	114
Figura 8-2:	Hartë e zonave të propozuara për Rrjetin Emerald në afërsi të gjurmës së propozuar të gazsjellësit	126
Figura 8-3:	Lloji i rrugëve të aksesit sipas vendbanimeve brenda zonës së studimit	139
Figura 8-4:	Objektet arsimore në vendbanimet brenda zonës së studimit	140
Figura 8-5:	Objekte Mjekësore në Zonën e Studimit (sipas qarqeve)	142
Figura 8-6:	Vaditja në vendbanimet brenda korridorit 2km të gjurmës së TAP	144

Shtojcat:

Shtojca 1: Urdhër Nr. 794, datë 28.12.2012 i Ministrit të METE "Mbi hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)";

Shtojca 2: Mbledhja e letrave të përgjigjeve nga institucionet publike

Shtojca 3: AAL00-ERM-641-Y-TAE-1006_00 Përshkrimi i projektit

Shtojca 4: AAL00-ILF-651-Y-TRY-0001_00 Dokumenti mbi mbledhjen e të dhënave për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Shtojca 5: Vendimet e 38 komunave mbi zhvillimin e projektit TAP

Shtojca 6: Harta përmbledhëse për PKS për projektin TAP (1:100.000)

Shtojca 7: Harta e infrastrukturës për PKS për projektin TAP (me topografi, njësitë administrative, infrastrukturën e shërbimeve publike (rrugë, hekurudhë), zonat e hidrocentraleve, zonat/çështjet me rëndësi kombëtare (1:50.000)

Shtojca 8: Harta gjeologjike dhe rezervat e burimeve natyrore përgjatë gjurmës së projektit TAP (Të dhëna të siguruar nga METE, AGS) (1:200.000)


Shtojca 9: Harta hidrogjeologjike përgjatë gjurmës së projektit TAP (1:200.000)

Shtojca 10: Përmbledhje ekzekutive e vlerësimit të rreziqeve sizmike dhe të shkarjeve në Shqipëri dhe hartat e lidhura me to (1:1.000.000; 1:100.000)

Shtojca 11: Harta e përdorimit të tokës përgjatë gjurmës së projektit TAP (Të dhëna të siguruar nga ARM, VNMS, 1:50.000)

Shtojca 12: Harta e zonave natyrore të mbrojtura dhe zonave të trashëgimisë kulturore përgjatë gjurmës së projektit TAP (1:100.000, të dhëna nga VNMS)

Shtojca 13: Zonat e Sigurise dhe ato te Planifikuara

	faqe 7 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

1 Hyrje

1.1 Projekti TAP

Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) është një projekt rajonal i gazit natyror, i cili do të transportojë gaz natyror nga rezerva e fushës Shah Deniz II në Azerbajxhan, duke kaluar përmes Grëeqisë, Shqipërisë, detit Adriatik dhe do të dalë në breg në Italinë e Jugut dhe më tej në tregjet evropiane.

Gjurma e TAP-it do të jetë afërsisht 800 kilometra e gjatë (përafërsisht: Greqi 478 km; Shqipëri 209 km; seksioni detar në detin Adriatik 105 km; Itali 4 km). Pika më e lartë e gazsjellësit TAP do të jetë 1800 metra në malet e Shqipërisë, ndërsa pika e tij më e thellë në seksionin detar do të jetë 810 metra në nivelin e detit. Gazsjellësi është projektuar për të zgjeruar kapacitetin e transportit nga 10 në 20 mmk gaz natyror në vit, në varësi të prodhimit.

Në një kohë kur rritja e kërkesës së Evropës për energji është e kombinuar me rënien e burimeve të energjisë brenda Bashkimit Evropian (BE), gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) ofron alternativën e vetme tregtare dhe realiste nga pikpamja strategjike për të mundësuar mbërritjen e gazit në tregjet e Evropës Juglindore (EJL).


Gjithashtu, politika e Shqipërisë për energjinë është e përqëndruar jo vetëm në rritjen e burimeve kombëtare, por gjithashtu edhe në zhvillimin e ndërveprimeve gjithëpërfshirëse dhe vendosjes së një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet të gjitha vendeve në rajonin e EJL dhe në nivel evropian; kjo politikë merr në konsideratë se siguria e furnizimit me energji po varet gjithnjë e më shumë nga zhvillimet e rrjeteve të energjisë dhe infrastrukturave në një nivel rajonal.

Nga ky këndvështrim projekti TAP është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë sepse ai do të mundësojë lidhjen e Shqipërisë me rrjetin e gazit natyror të ashtuquajturit Korridor Jugor të Gazit, duke rritur sigurinë kombëtare dhe të përgjithshme të Evropës për energji dhe duke kontribuar në diversifikimin e furnizimeve të rajonit me gaz.

Projekti TAP është projekti i parë, i cili do të mundësojë kalimin tranzit të gazit natyror përmes territorit shqiptar dhe do të krijojë mundësinë e furnizimit me gaz natyror të tregut shqiptar. Projekti TAP do të jetë një nga investimet e huaja direkte më të mëdha në Shqipëri dhe si i tillë do të gjenerojë përfitime të konsiderueshme dhe perspektiva për industrinë shqiptare dhe komunitetet lokale.

Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) është planifikuar të fillojë nga Komotini në Greqinë lindore dhe të vazhdojë drejt kufirit grek/shqiptar, të vazhdojë përmes Shqipërisë, përmes detit Adriatik dhe në Itali. Qëllimi i projektit është që të transportojë gazin natyror nga rajoni i Kaspikut nëpërmjet një gazsjellësi me diametër 48" në tokë dhe 36" në det, deri në një terminal pritës në tokë që ndodhet pranë Leçës, në nyjen lidhëse të rrjetit ekzistues SNAM Rete Gas.

Gjurma e TAP-it hyn në pjesën kontinentale shqiptare në jug të qytetit të Bilishtit, vazhdon në fushën e Devollit dhe të Korçës përreth vargmalit të Moravës, duke e shmangur qytetin e Korçës në perëndim deri në fshatin Floq, kalon përreth liqenit të Gjancit, fshatrave Leshnjë, Vithkuq dhe Shtyllë në jug dhe kalon përmes seksionit të malit të Ostrovicës në shpatin e tij jugor, pranë fshatrave të Helmësit, Staraveckës, Backës dhe Potomit dhe vazhdon në kreshtat dhe vargmalet deri në qytetin e Çorovodës. Prej atje ajo ndjek rrjedhën e lumit Osum për rreth 8 km dhe më pas përgjatë bregut jugor të luginës së Osumit deri në Mbrakull. Më pas gjurma ndjek përsëri rrjedhën

		faqe 8 nga 147
Autoriteti Planifikimit Titulli i Dokumentit:	Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al


e lumit Osum deri në Uznovë, e anashkalon qytetin e Beratit në veri, kalon përmes fushës së Kapinovës dhe lumit Osum në jug të aeroportit ushtarak të Kuçovës, e anashkalon Urën Vajgurore në jug dhe Strumin në veri, ku futet në fushën bregdetare, duke kaluar qytetin e Fierit dhe fshatrat Mbrostar, Seman dhe Topojë në veri deri në seksionin shqiptar të daljes në det ndërmjet bregdetit të Semanit dhe grykës së lumit Seman, nga ku seksioni në det kalon përmes detit Adriatik (shiko

Figura 1-1) deri në Leçe në Itali.

Korridori aktual i gjurmës së TAP-it u përpunua në detaje si rezultat i një procesi vlerësimi gjithëpërfshirës të 6 alternativave të gjurmës përmes territorit shqiptar, duke marrë në konsideratë kufizimet përkatëse teknike, mjedisore, të trashëgimisë kulturore dhe socio-ekonomike. Objektiv i këtij procesi ishte i trefishtë:


- të identifikoheshin gjurma optimale në përputhje me planifikimin e territorit në Shqipëri,
- të identifikoheshin masat për të minimizuar ndikimet e mbetjeve mbi mjedisin, aspektet sociale dhe të trashëgimisë kulturore dhe të përfshiheshin autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale dhe popullsia në përgjithsi.

Figura 1-1: Gjurma e gazsjellësit TAP në Shqipëri



Source: AAL00-ILF-600-Y-TAG-0001_00--Proposal Establishing National Importance in Territory Planning TAP Project

Harta topografike dhe tematike të shkallës ndërmjet 1:1.000 000 deri në 1:50.000 i janë bashkëngjitur këtij raporti mbi të dhënat e mbledhura, të cilat tregojnë korridorin e gjurmës së TAP-it (500m të gjerë), rrugët e reja që kërkohen dhe rrugët ekzistuese që duhen zgjeruar dhe përmirësuar për projektin si dhe kufijtë administrativë të komunave dhe bashkive të interesuara,

	faqe 9 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

gjeologjinë, hidrogeologjinë, rreziqet e shkarjeve sizmike dhe tektonike, zonat ushtarake, qendrat e banuara, përdorimin e tokës, zonat e ndjeshme mjedisore dhe të trashëgimisë kulturore.

1.2 Qëllimi dhe fusha e veprimit

Planifikimi i territorit është një kërkesë ligjore dhe një domosdoshmëri për zhvillimin e projektit; shtrirja në hapësirë e projektit TAP do të integrohet brenda planeve rajonale të zhvillimit dhe do të jetë pjesë e këtyre planifikimeve të territorit. Në datë 20 dhjetor 2012, Këshilli Kombëtar i Territorit, me iniciativën e AKPT dhe në përputhje me propozimin e METE-s, vendosi ta përcaktojë projektin TAP si një çështje me të rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit.

Në bazë të Vendimit Nr.2, datë 20.12.2012 të KKT dhe Urdhrit Nr. 794, datë 28.12.2012 të Ministrisë së METE për "Hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për projektin Trans Adriatik" (Shtojca 1), Plani Kombëtar Sektorial për projektin TAP do të konsultohet me autoritetet e planifikimit (ministrinë e linjës dhe qarqet, përmes të cilave do të kalojë projekti), me qëllim për ta përshtatur me planifikimin e territorit për zonën e projektit.

Plani Kombëtar Sektorial për projektin TAP reflekton planifikimin e territorit për gjurmën e TAP-it, duke përshkruar çështjet territoriale, të infrastrukturës dhe të përdorimit të tokës si dhe çështjet mjedisore dhe ekonomike brenda korridorit të gjurmës së TAP-it, i cili është vendosur të jetë një "Zonë kombëtare" sipas vendimit Nr.2, datë 20.12.2012 të KKT.

Draftimi i këtij Relacioni mbi Planin Kombëtar Sektorial për projektin TAP është në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit Nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" dhe VKM Nr.481, datë 22.06.2011 "Per miratimin e rregullores uniforme te instrumentave te planifikimit".

Qëllimi i këtij dokumenti është të reflektojë çështjet strategjike, social-ekonomike, mjedisore dhe territoriale që shogërojnë procesin e planifikimit territorial të projektit TAP në territorin Shqiptar. Dokumentat dhe hartat bashkëlidhur janë pjesë integrale e Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP.


METE në hartimin e këtij dokumenti ka konsideruar të dhënat e vëna në dispozicion nga Trans Adriatik Pipeline AG, të grumbulluara gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të projektit në lidhje me planifikimin social, mjedisor, demografik dhe territorial ku është planifikuar të kalojë korridori i gjurmës së TAP-it.

1.3 Metodologjia

Korridori i projektit TAP, siç përcaktohet nga Vendimi Nr. 2, datë 20.12.2012 i KKT është 500 m (250 m në secilën anë të vijës së mesit).

Të dhënat kryesore që paraqiten në PKS i referohen:

1. Dokumenteve përkatëse të politikës së Shqipërisë (Strategjia e Energjisë, etj.)
2. Studimet në terren dhe të dhënat e përzgjedhjes së gjurmës brenda korridorit prej 2 km;
3. VNMS-së të hartuar nga Shoqëria e gazsjellësit Trans Adriatik;
4. Raportit mbi karakteristikat e projektit (shtojca 3)

	faqe 10 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

5. Të dhënave mbi koncesionet, te dërguara nga ministritë e linjës në kuadër të hartimit të PKS për projektin TAP;

Shoqëria Trans Adriatik Pipeline AG ka kryer shumë studime brenda një korridori 2 km të gjerë (1 km në secilën anë të vijës së mesit) me qëllim që të përcaktoheshin alternativat e gjurmës për projektin TAP.


Pasi u përcaktuan karakteristikat teknike, mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore të secilës alternativë, u përdorën 'treguesit e ndikimit' për çdo disiplinë për të nxjerrë në pah veçoritë kryesore të mundshme të alternativave që mund të lidhen me ndikimet kryesore të mundshme të një projekti standart të gazit si dhe me detajet specifike të zonës së studimit (d.m.th. mbështetur në rezultatet e studimit në zyrë dhe vëzhgimit në terren). Përdorimi i këtyre treguesve mundësoi në fund krahasimin dhe identifikimin e ndryshimeve dhe ngjashmërive ndërmjet alternativave që u studiuuan. Të dhënat e të gjithë treguesve u paraqitën më pas si një tabelë ose 'matricë treguesish' për krahasim. Lista e treguesve të përzgjedhur për vlerësimin e 6 alternativave është paraqitur në tabelën 4-6 të Shtojcës 4 të VSM-se,

Si një aktivitet paralel dhe integral iprosesit të përzgjedhjes së alternativave, është zhvilluar një proces i vazhdueshëm dhe intensiv i konsultimit të publikut dhe përfshirjes së palëve të interesuara gjatë të gjithë periudhës ndërmjet 2006 dhe 2011. Trans Adriatik Pipeline AG ka zhvilluar takime në çdo qark dhe në çdo komunë dhe/ose vendbanim (jane zhvilluar më shumë se 180 takime konsultative dhe në këtë proces konsultimi kane marrë pjesë më shumë se 2,400 njerëz). Objektivat e aktiviteteve për përfshirjen e palëve të interesuara kane qenë: (1) të prezantohej projekti tek palët e interesuara që mund të prekeshin; dhe (2) të grumbullohej informacioni përkatës për procesin e përzgjedhjes së gjurmës. Këto aktivitete të konsultimit me publikun dhe përfshirjes së palëve të interesuara kanë ndikuar për të përcaktuar gamën dhe rezultatet e vlerësimit të alternativave dhe ato janë përdorur si një mjet nga palët e interesuara për të ndikuar në hartimin e projektit, planifikimin dhe vendimet deri në atë shkallë që është e mundshme.

Si rezultat i të gjithë këtij procesi konsultimi, të 38 komunat ku do të kalojë gazsjellësi kanë dhënë aprovimin e tyre për projektin; një kopje e secilit prej këtyre vendimeve gjendet në Shtojcën Nr.5 të PKS për projektin TAP.

PKS p-ër projektin TAP, pasqyron:


- të dhënat përkatëse dhe të disponueshme mbi dokumentet e politikës në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal (lokal); programet e zhvillimit strategjik në nivel qendror dhe rajonal (lokal); kuadri ligjor që duhet të merret në konsideratë gjatë hartimit të PKS për projektin TAP;
- të dhënat në formë shifrore që disponohen mbi hapësirën në formatin GIS për korridorin 500 m të projektit TAP në lidhje me: (i) përdorimin e tokës brenda korridorit të projektit TAP; (ii) zonat industriale; (iii) zonat bujqësore; (iv) infrastrukturën publike brenda zonës, d.m.th. rrugët, hekurudhat, rrjetin e furnizimit me energji,; (v) përdorimi i tokës për qëllime të veçanta (p.sh. hidrocentral,etj.); (vi) zonat e burimeve natyrore (d.m.th. rezervat ujore, zonat pyjore, kullotat, zonat e mbrojtura natyrore, , zonat e koncesioneve, rezervat minerare; (vii) monumentet kulturore dhe historike; (viii) zonat ushtarake;

		faqe 11 nga 147
Autoriteti Planifikimit	Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al
Titulli i Dokumentit:	Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	

- VSM për projektin TAP.

1.4 Shkurtime


AFSS	Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe e Ushqimit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
BE	Bashkimi Evropian
CARDS	Asistence e Komunitetit (BE) për rindertim, zhvillim dhe stabilizim
CEMAT	Konferenca Evropiane e Ministrave përgjegjës për Planifikimin Rajonal
DPRR	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve
EBRD	Banka Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim
EIB	Banka Evropiane e Investimeve
EIU	Njesia e Inteligjences Ekonomike
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
ESDP	Dokumenti i Perspektivës së Zhvillimit të Hapësirës Evropiane
GDP	Prodhimi I Brendshëm Bruto
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IUCN	Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KM	Këshilli i Ministrave
KRRTRSH	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
PKS	Plani Kombëtar Sektorial për gazin
PKSHT	Plani Kombëtar Shqiptar i Transportit
QSH	Qeveria e Shqipërisë
RKPT	Rëndësia Kombëtare në Planifikimin e Territorit

	faqe 12 nga 147
Autoriteti Planifikimit Titulli i Dokumentit:	Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
CSO	Stacionet e kompresorëve
TAP	Gazsjellësi Trans Adriatik
TK	Trashëgimia Kulturore
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

2 Referencat

- Dokumentet strategjike të aprovuara nga qeveria shqiptare:
 - Strategjia Kombëtare Shqiptare për Integrimin dhe Zhvillimin, 2007 – 2013
 - Strategjia për Energjinë,
 - Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2007 – 2013;
 - Strategjia Mjedisore Sektoriale dhe Ndërsektoriale, 2007-2013
 - Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit;
 - Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit;
 - Strategjia Sektoriale e Transportit;
 - Strategjia Sektoriale e Turizimit;
 - Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Mbrojtjes;
 - Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2007 - 2013;
 - Strategjia e Punësimit;
 - Strategjia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017;
 - Strategjia për Përfshirjen Sociale;
 - Strategjia për Arsimin;
 - Strategjia për Shëndetin;
 - Strategjia për Zhvillimin Rajonal;
 - Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural, 2007-2013;
- Dokumente të përgatitura nga shoqëria e gazsjellësit TAP me konsulencën e kompanisë ERM në kuadër të studimit të detajuar të VNMS-së:
 - AAL00-ERM-641-Y-TAE-1002_00—VNMS në Shqipëri SEKSIONI 0 – Përmbledhja joteknike
 - AAL00-ERM-641-Y-TAE-1006_00-- VNMS në Shqipëri SEKSIONI 4 – Përshkrimi i projektit

	faqe 13 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- AAL00-ERM-641-Y-TAE-1008_00-- VNMS në Shqipëri SEKSIONI 6 – të dhënat referuese mjedisore, sociale dhe kulturore
- AAL00-ERM-641-Y-TAE-1004_00-- VNMS në Shqipëri SEKSIONI 2 – Arsyeja për propozimin e projektit
- Dokumente të përgatitura nga shoqëria e gazsjellësit TAP me konsulencën e kompanisë ILF në kuadër të fillimit të hartimit të PKS për projektin TAP dhe fillimin e procedurave për përcaktimin e projektit TAP si një çështje me RKPT.
 - AAL00-ILF-600-Y-TAG-0001_00—Propozimi që e përcakton projektin TAP si një çështje me rëndësi kombëtare për planifikimin e territorit
 - AAL00-ILF-600-Y-TAG-0002_00—Fillimi i hartimit të Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP
- Planifikimi i hapësirës si instrument kryesor për zhvillim dhe qeverisje efektive me referencë të veçantë për vendet në tranzicion, Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara, 2008
- Dokumenti i gjelbër i Komisionit Evropian mbi kohezionin e territorit, tetor 2008


3 Vizioni strategjik i planifikimit të hapësirës dhe zhvillimit të territorit për korridorin e projektit TAP

3.1 Vizioni strategjik për projektin TAP

Planifikimi i hapësirës është një instrument kryesor për të përcaktuar kuadrin afatgjatë dhe të qëndrueshëm për zhvillimin social, territorial dhe ekonomik si brenda ashtu edhe ndërmjet vendeve. Roli i tij kryesor është të intensivikojë integrimin ndërmjet sektorëve, si transporti, energjia, industria, bujqësia, turizmi dhe të përmirësojë sistemet kombëtare dhe lokale të zhvillimit urban dhe rural, duke marrë në konsideratë çështjet mjedisore, të shtimit dhe shpërndarjes së popullsisë, punësimin, përdorimit të tokës, infrastrukturës dhe shërbimeve.

Legjislacioni i ri për planifikimin e territorit në Shqipëri ka përcaktuar bazën për planifikimin e hapësirës; qëllimi i Ligjit Nr. 10119, datë 23.03.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, është të inkurajojë dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit nëpërmjet një koordinimi dhe harmonizimi të politikave sektoriale me planet e territorit që aprovohen dhe harmonizohen në nivel lokal dhe kombëtar; si rrjedhim, koncepti i ri i planifikimit të territorit, siç përcaktohet nga legjislacioni i ri në fuqi, kërkon një harmonizim të politikave sektoriale me proceset e vendimmarrjes dhe pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara në këtë proces të planifikimit të territorit.


Strategjia e Energjisë përcakton një vizion dhe drejtim të qëndrueshëm për zhvillimin e hapësirës, bazuar në përdorimin e burimeve, kuadrin rregullator shqiptar dhe vendimmarrjen efektive në lidhje me investimet e mundshme, siç është projekti TAP.

	faqe 14 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Politika e Shqipërisë për energjinë synon jo vetëm rritjen e burimeve kombëtare, por edhe zhvillimin e ndërveprimeve gjithëpërfshirëse dhe vendosjen e një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet të gjitha vendeve në rajonin e EJT dhe në nivel evropian; kjo politikë merr në konsideratë faktin se siguria e furnizimit me energji po varet gjithnjë e më shumë nga zhvillimet e rrjeteve dhe infrastrukturave të energjisë në nivel rajonal.

Projekti TAP synon të kontribuojë për sigurinë dhe diversitetin e furnizimit të Evropës me energji duke u lidhur me rrjetet ekzistuese të gazit dhe do të mundësojë rrjedhjen e gazit direct nga rajoni i kaspikut për në tregjet evropiane. Projekti TAP do të sigurojë infrastrukturën e nevojshme për të transportuar gazin nga fusha e *Shah Deniz II* në Azerbajxhan nëpërmjet gjurmës më të drejtpërdrejtë për në Evropën Jugore (referohu *Figura 3-1*); pasi të fillojë prodhimi në *projektin Shah Deniz II* në 2018.

Figura 3-1: Konteksti i rrjetit të transmetimit të gazit të TAP-it



Burimi: SHOQËRIA E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (2012), Prezantim i Shoqërisë_TAP_Jan_2012


Bashkimi Evropian e ka pranuar Projektin TAP në kuadër të udhëzimeve të ashtuquajtura TEN-E (Rrjetet *Trans-Evropiane të Energjisë*) si një *projekt me interes të përbashkët* për objektivat e përgjithshme të politikës së Bashkimit Evropian për energjinë.

Nga ky këndvështrim, projekti TAP është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë sepse ai siguron lidhjen e vendit me rrjetin e gazit natyror të të ashtuquajturit Korridorit Jugor të Gazit, duke rritur sigurinë kombëtare dhe të gjithë Evropës për energji dhe duke kontribuar në diversifikimin e furnizimeve të rajonit me gaz.

Projekti TAP është projekti i parë, i cili do të mundësojë kalimin transit të gazit natyror përmes territorit shqiptar dhe do të krijojë një alternativë të furnizimit të tregut shqiptar me gaz natyror. Nëpërmjet gjurmës së përzgjedhur TAP do të jetë një nga investimet e huaja më të mëdha direkte në Shqipëri dhe si i tillë do të gjenerojë përfitime të konsiderueshme dhe mundësi për industrinë shqiptare dhe komunitetet lokale.

Në nivel rajonal projekti TAP është pjesë e një gjurme të re të transportit të gazit nga rajoni i Kaspikut për në Evropën Jugore dhe Qendrore. Më poshtë është paraqitur një listë me objektivat kryesore të projektit:

- Të mbështesë Evropën në arritjen e objektivit të saj strategjik për të siguruar dhe diversifikuar furnizimet me gaz natyror dhe për të rritur aftësitë e saj për të plotësuar nevojat në rritje për energji;
- Të rrisë sigurinë dhe diversifikimin e furnizimeve me gaz për tregjet evropiane;

	faqe 15 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- Të hapë një Korridor të ri Jugor të gazit për Evropën dhe treg shitjeje për gazin natyror nga deti Kaspik dhe rajonet e Lindjes së Mesme; dhe
- Të lidhë rrjetet ekzistuese dhe ato të planifikuara për transportin e gazit natyror në Evropën Juglindore me sistemet e gazit në Evropën perëndimore në mënyrën më efikase dhe ekonomike.

Në nivel kombëtar projekti TAP ka objektivat e mëposhtme:

- të sigurojë lidhjen e Shqipërisë me infrastrukturën rajonale të gazit natyror;
- të zhvillojë infrastrukturën e energjisë së Shqipërisë dhe të nxisë investimet e huaja të mëdha;
- do të inkurajojë aktivitetin ekonomik duke krijuar vende pune dhe duke zhvilluar aftësitë dhe kapacitetet lokale;
- duke gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe të parashikueshme pasi të vihet në punë, TAP do të kontribuojë në zhvillimin e sistemit të gazit në Shqipëri;
- të krijojë infrastrukturën e vlefshme shtesë, si rrugët, etj.;
- të rrisë rëndësinë rajonale dhe gjeostrategjike të vendit, ndërkohë që mbështet stabilitetin e vazhdueshëm.

Planifikimi i territorit (Plani Kombëtar Sektorial) për gjurmën e TAP-it është realizuar duke vlerësuar dhe analizuar politikat përkatëse sektoriale në kontekstin e projektit TAP dhe duke marrë në konsideratë të gjithë infrastrukturën ekzistuese publike, zonat industriale, turizmin, zonat e mbrojtura, zonat ushtarake, zonat bujqësore dhe pyjore dhe aspektet sociale dhe mjedisore në zonën e projektit. Ai është pjesë e Strategjisë së Energjisë të qeverisë shqiptare dhe pjesë e dokumentit të politikës së BE mbi "Prioritetet e infrastrukturës së energjisë për 2020 dhe më tej – propozim për një rrjet të integruar energjetik evropian (nëntor 2010)", në të cilin projekti TAP është pjesë e Korridorit Jugor të Gazit, duke e konsideruar atë si një projekt kryesor për diversifikimin e furnizimit me gaz natyror për rajonin dhe Evropën gjithashtu.

Ky dokument do të paraqesë të gjitha këto të dhëna dhe do të konsultohet dhe koordinohet me autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara me qëllim që të sigurojë një planifikim të përshtatshëm dhe transparent të territorit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të ri të Shqipërisë dhe zhvillimin e planifikimit të hapësirës.

3.2 Zhvillimi territorial i projektit TAP

TAP është një gazsjellës me diametër të madh, me presion të lartë që fillon në Greqinë verilindore pranë Komotinit¹, nga ku ai kalon përmes Greqisë së veriut, kalon përmes Shqipërisë, detit Adriatik dhe në fund del në breg të detit në jug të Italisë pranë zonës së San Fokas (Leçe).

Një përmbledhje skematike e projektit TAP në tërësi është paraqitur në *Figura 3-2*.

¹ Është parashikuar shtrirja e gazsjellësit TAP deri në kufirin turk (përtej Komotinit); harta e re zyrtare është duke u përgatitur



	faqe 16 nga 147
Autoriteti Planifikimit: Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al
Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	

Figura 3-2: Vështrim mbi shtrirjen e projektit TAP



Burimi: SHOQËRIA E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (2012) Prezantim_ i shoqërisë_ TAP_ Jan_2012
Legjenda: bcm/a = miliarda metra kub/vit; CS = Stacion kompresorësh

Gazsjellësi është afërsisht 800 km i gjatë dhe është projektuar me një diametër 48 inç në tokë dhe reduktohet deri në një diametër prej 36 inç në seksionin detar. Gazsjellësi do të ketë në fillim një kapacitet për të transportuar 10 miliardë metra kub standard të gazit natyror në vit (mmk/vit), 1,350,000 m³ në orë rrjedhje maksimale. Në një fazë të dytë ky kapacitet mund të dyfishohet deri në rreth 20 mmk/vit duke e rritur kapacitetin e instaluar të stacioneve të kompresorëve.


Sistemi i gazsjellësit në Shqipëri do të kërkojë instalimet kryesore të mëposhtme:

- Një tubacion gazsjellësi² 48 inç të futur në tokë, rreth 203 km të gjatë, nga kufiri greko-shqiptar deri në stacionin e kompresorëve CS03;
- Një stacion matjeje/kompresorësh (CS02) që nuk është i detyrueshëm, pranë kufirit shqiptaro-grek; në fillim për 10 mmk/vit – vetëm një stacion mirëmbajtjeje/matjeje.

Në varësi të studimeve të mëtejshme teknike të sistemit, vendndodhja do të jetë ose në Shqipëri ndërmjet fshatrave Kuç dhe Trestenik, në rrethin e Devollit – kjo është aktualisht vendndodhja e preferuar nga Shoqëria Trans Adriatic Pipeline AGë – ose në mënyrë alternative, në anën greke, afërsisht 2 km në perëndim të qytetit të Mesopotamisë. Me qëllim që të planifikohet territori në kuadër të PKS për projektin TAP, CS02 është supozuar se do të ndodhet në territorin shqiptar.

- Afërsisht 10 stacione valvulash bllokimi (SVB) përgjatë gjurmës në pjesën tokësore, me interval të parashikuara maksimumi 30 km, për të ndërprerë rrjedhën e gazit në rast të punimeve të mirëmbajtjes ose emergjencës;
- Një stacion kompresori (CS03) pranë qytetit të Fierit;

²Gazsjellësi me diametër 48 inç në pjesën tokësore do të ketë një presion të projektuar prej 95 bmpa (bar mbi presionin atmosferik), i cili do të jetë i mjaftueshëm për rastin bazë të kapacitetit të TAP-it prej 10 mmk/vit si dhe për rritjen e mundshme në të ardhmen të kapacitetit të sistemit të TAP-it deri në 20 mmk/vit.

	faqe 17 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- Një tubacion lidhës 36 inç të futur nën tokë, afërsisht 4 km të gjatë, nga CS03 deri në daljen në det në breg të detit Adriatik;
- Një tubacion gazsjellësi me diametër 36 inç në seksionin detar³, afërsisht 60 km të gjatë, nga dalja në det në Shqipëri deri në vijën e mesit të detit Adriatik.

Stacionet e kompresorëve do të kërkojnë një sipërfaqe toke prej rreth 35 hektarësh (ha), përfshirë hapësirat e sigurisë dhe hapësirat e gjelbra, pa ndërtesa ose instalime – njolla fizike e ngritjes së ndërtesave do të jetë afërsisht 20 ha. Pasi të jenë plotësisht funksionale, ndërtesat e stacioneve të kompresorëve do të jenë rreth 20 m të larta, oxhaqet e turbinave të gazit rreth 30 m dhe në secilin stacion do të ketë një oxhak me lartësi rreth 70 m.

Brezi i punimeve i projektit TAP është 38 m dhe mund të reduktohet në 28 m atje ku e kërkojnë kufizimet fizike ose për të reduktuar humbje të caktuara në bimësi, si në pyjet e njohura. Në zonat ku gazsjellësi duhet të ndërtohet në majën e shpateve malore, gjerësia do të reduktohet më tej deri në një korridor minimal prej 18 m.

Seksioni i gazsjellësit në pjesën kontinentale do të futet pothuajse tërësisht nën tokë. Për arsye sigurie dhe me qëllim që të minimizohen ndikimet mbi përdorimet ekzistuese të tokës (p.sh. bujqësore) gazsjellësi i futur nën tokë do të mbulohet me një shtresë dhe prej të paktën 1 m. Kjo mund të rritet nëse është e nevojshme atje ku e kërkojnë kushtet, për shembull, në zonat e ndjeshme mjedisore ose atje ku gazsjellësi ka nevojë për mbrojtje shtesë.


Seksioni detar do të shtrihet në shtratin e detit, me përjashtim të seksionit në ujërat e cekta (ndërmjet 0 dhe 30 m thellësi në det), i cili do të vendoset në thellësi nga 0.5 dhe që i kalojnë 2 m. Në zonën e daljes në det thellësia e shtrimit të tubacionit është parashikuar të jetë deri në 5 m. Përballë zonës së daljes në det do të nevojitet gjurmimi i një kanali lundruar (afërsisht 2 km të gjatë) për të lejuar afrimin e anijes për shtrimin e tubave pranë bregut. Gjatë operacionit të gjurmimit do të zhvendosen në total rreth 1,600,000 m³ sedimente detare, shumica e të cilave do të përdoren përsëri gjatë rimbushjes së kanalit dhe rikthimit të shtratit të detit në gjendjen e mëparshme.

Gjurma e projektit TAP në Shqipëri është përzgjedhur pas një procesi vlerësimi të gjerë dhe të kujdesshëm të alternativave të gjurmës që u krye nga mbështetësja e projektit, shoqëria e gazsjellësit Trans Adriatik, me qëllim që të përzgjidhte një gjurmë gazsjellësi që është e mundur nga pikpamja teknike, me ndikimet dhe rreziqet më të vogla mjedisore, socio-ekonomike dhe mbi trashëgiminë kulturore.

Me përzgjedhjen e gjurmës së preferuar, u ndërmor një proces përmirësimi me synimin për ta perfeksionuar sa më shumë atë, sidomos duke u përqëndruar në ato seksione, të cilat paraqisnin kufizime teknike, mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimë kulturore që mbeten (shiko Shtojcën 3 për përshkrimin e detajuar teknik dhe teknologjik 3).


Gjurma përfundimtare e përmirësuar përmes Shqipërisë hyn nga Greqia në afërsi të fshatit Trestenik, në lindje të vendit. Më pas ajo kalon përmes luqinës së Devollit, përreth varqmalit të Moravës, duke e anashkaluar qytetin e Korçës në perëndim derisa arrin në fshatin Floq. Nga atje ajo kalon përmes malit të Ostrovicës, kalon nëpër luqinën e Osumit nga Çorovoda deri në Berat

³ Tubacioni lidhës dhe seksioni i gazsjellësit në det me diametër 36 inç do të kenë një presion të projektuar prej 145 bmpa

	faqe 18 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

dhe më pas kalon përmes fushës para-Adriatike derisa arrin në breg të detit, afërsisht 15 km në veripërendim të qytetit të Fierit. Në Figura 3-3 është paraqitur një përmbljedhje e gjurmës.

Figura 3-3: Gjurma e TAP-it në seksionin kontinental në Shqipëri




Burimi: ERM (2012)


Nga dalja në det, pjesa shqiptare e gjurmës së TAP-it vazhdon me një seksion detar prej rreth 60 km të gjatë përgjatë fundit të detit Adriatik, përmes ujërave territorial shqiptare dhe në ujërat ndërkombëtare derisa arrin në pikën e mesit ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë (referohu

Figura 3-4). Pjesa italiane e gjurmës së TAP-it vazhdon më pas në ujërat territoriale italiane, derisa arrin në daljen në det në zonën e San Fokas (Leçe).

Figura 3-4: Gjurma e TAP-it në seksionin detar



Burimi: ERM (2012)

	faqe 19 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

4 Parimet e zhvillimit të hapësirës dhe "kohezionit" të territorit

4.1 Zbërthimi i konceptit të zhvillimit policentrik territorial, ndërkufitar dhe ndërkombëtar

Ideja e zhvillimit policentrik ka qenë një gur themeli për planifikimin e hapësirës evropiane për mbi një dekadë.

Dokumenti i Perspektivës së Zhvillimit të Hapësirës Evropiane (ESDP) që u botua në 1999 ka ushtruar një ndikim të vazhdueshëm mbi procesin e të menduarit në lidhje me planifikim e hapësirës në mbarë Evropën. Ideja e zhvillimit policentrik është në qendër të ESDP.


Çështja e zhvillimit policentrik u përsërit si prioritet i parë në Programin mbi Territorin të BE-së për 2020 që u aprovua nga ministrat e 27 shteteve anëtare në maj 2011. Në dokument konfirmohet se "ne theksojmë se zhvillimi policentrik dhe i ekuilibruar i territorit të BE-së është element kryesor në arritjen e kohezionit territorial. Atje ku qytetet dhe rajonet më të zhvilluara brenda Evropës bashkëpunojnë si pjesë të një modeli policentrik, ata i shtojnë vlerat dhe veprojnë si qendra që kontribuojnë në zhvillimin e rajoneve të tyre më të gjera."

Që prej 1986 objektivi i politikës së kohezionit ka qenë që të forcojë kohezionin ekonomik dhe social. Traktati i Lisbonës dhe strategjia e re e nivelit të lartë të BE-së (Programi Territorial i BE-së për 2020) paraqet një dimension të tretë: kohezionin territorial, i cili kërkon koordinim ndërmjet politikave sektoriale dhe territoriale si një mjet shumë i rëndësishëm për të rritur në maksimum ndërveprimin dhe për të shmangur konfliktet e mundshme.

Parimet kryesore të kohezionit territorial⁴ janë marrë në konsideratë gjatë planifikimit të territorit për projektin TAP:

1. **Të vlerësojë diversitetin e territorit;** projekti TAP kalon përmes Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë dhe planifikimi i territorit për gjurmën e korridorit është kryer duke marrë në konsideratë ndër të tjera (çështjet mjedisore dhe teknike) dhe madje edhe asetet e ndryshme dhe potencialet e çdo qarku ku kalon gazsjellësi;
2. **Identifikimi i potencialeve;** Çdo pjesë e territorit përballet me dinamika të ndryshme zhvillimi. Gjurma e projektit TAP është planifikuar duke marrë në konsideratë me shumë kujdes potencialet ekonomike të çdo pjese të territorit në nivel kombëtar (territori shqiptar) dhe ndërkombëtar (territori grek dhe italian);
3. **Të pranojë kontekstin territorial;** Kjo përfshin potencialet e brendshme për zhvillim dhe anët e dobta, si dhe faktorët e jashtëm, si ndikimi i zhvillimeve mbi territoret e tjera dhe ndikimet e politikave të ndryshme sektoriale në nivele të ndryshme të vendimmarrjes. Plani Kombëtar Sektorial për projektin TAP është hartuar duke marrë në konsideratë të gjitha politikat/strategjitë sektoriale si dhe ndikimin mbi zhvillimin që do të ketë ky projekt në tre qarqe (Korçë, Berat, Fier) ku kalon gazsjellësi.
4. **Të sigurojë mundësi të barabarta për të përdorur infrastrukturën dhe shërbimet;** Njerëzit dhe komuniteti kanë nevojë të marrin shërbime të standarteve të caktuara. Ofrimi

⁴ Dokumenti i Gjellbër i BE-së mbi Kohezionin Territorial

	faqe 20 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

i këtyre shërbimeve mund të varet nga konteksti territorial. Plani Kombëtar Sektorial për projektin TAP ka marrë në konsideratë të gjitha aspektet e infrastrukturës dhe shërbimeve, në mënyrë që të integrohen në planifikimin e territorit për projektin TAP.

5. **Të përmirësojë procedurat e qeverisjes;** palët e interesuara lokale dhe rajonale kanë njohuri nga përvoja në territoret e tyre, të cilat nevojiten për hartimin e strategjive të integruara dhe identifikimin e potencialeve dhe anëve të dobta të territorit. Por kjo nuk ka lidhje vetëm me njohuritë. Të gjithë aktorët në terren kanë burime në dispozicion, të cilat mund të përdoren në një mënyrë ose një tjetër: masat e përmirësuar si duhet të qeverisjes mund t'i ndihmojnë ata t'i përdorin burimet e tyre në një mënyrë të koordinuar. Kjo metodë nuk kërkon domosdoshmërisht burime shtesë. Vetëm njerëzit dhe kompanitë që punojnë në një zonë mund ta zbatojnë vizionin e tyre të zhvillimit për zonën. Në këtë mënyrë procedurat e qeverisjes janë mjete të rëndësishme për të kuptuar dinamikën e zhvillimit në një zonë dhe për të inkurajuar faktorët që nxisin zhvillimin.

Planifikimi i territorit për gjurmën e TAP-it është udhëhequr nga këto parime të politikës së kohezionit në planifikimin e territorit, duke marrë në konsideratë të gjitha politikat sektoriale, mjedisore, sociale dhe pasojat demografike brenda korridorit të projektit TAP, si dhe duke marrë parasysh fuqizimin ekonomik të disa zonave rurale me më pak burime natyrore dhe zhvillim ekonomik.


Gjurma e projektit TAP në Shqipëri është përzgjedhur duke ndjekur një proces vlerësimi të gjerë dhe të kujdesshëm të alternativave të gjurmës, i cili u realizua nga Shoqëria e gazsjellësit Trans Adriatik me synimin për të përzgjedhur një gjurmë të gazsjellësit që është e mundshme për tu realizuar nga piknamja teknike, me ndikimet më të vogla mbi mjedisin, aspektet socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore.

Me përzgjedhjen e gjurmës së preferuar (ose 'rastit bazë'), filloi një proces i përmirësimit të gjurmës me qëllimin për ta perfeksionuar sa më shumë gjurmën, sidomos në ato seksione që paraqesin sfidat më të mëdha teknike, mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore. Ky ka qenë një proces që është përsëritur dhe është zhvilluar gjatë 8 viteve, me një rritje të intensitetit dhe nivelit të detajeve.

Procesi i përpunimit të gjurmës së rastit bazë, përfshirë ripërcaktimin e gjurmës në detaje të vogla për seksionin e gazsjellësit në pjesën kontinentale, përfundoi në nëntor 2011. Pas kësaj periudhe do të shqyrtohet më tej vetëm përmirësimi i gjurmës lokale për të minimizuar kryesisht ndikimet e mundshme. Këto përmirësime të gjurmës do të lidhen me përcaktimin e vendndodhjes përfundimtare të gazsjellësit (brezit të punimeve) në lidhje me pika të veçanta, si kalimet e rrugëve, lumenjve dhe infrastrukturës tjetër, pemëve të vjetra të veçuara, strukturave fizike ose zonave të Trashëgimisë Kulturore.

4.2 Programet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale në përputhje me prioritetet e integritimit në BE

Rëndësia e planifikimit të hapësirës në procesin e zhvillimit urban është pranuar në dokumentet e politikave gjatë disa dekadave, por Karta Evropiane për Planifikimin e Hapësirës (Karta e Torremolinos) u aprovua në 1983 nga Konferenca Evropiane e Ministrave të ngarkuar me

	faqe 21 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Planifikimin e Rajonal (CEMAT). Ajo përcaktoi gamën e planifikimit të hapësirës dhe identifikoi objektivat dhe aktivitetet e tij kryesore. Aktivitetet kryesore sipas Kartës përfshijnë koordinimin ndërmjet sektorëve të ndryshëm të politikës, koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet niveleve të ndryshme të vendimmarrjes dhe nxitjen e pjesëmarrjes së publikut.

ESDP, i cili u aprovua në takimin informal të Këshillit të Ministrave të ngarkuar me planifikimin e hapësirës në 1999, e pranon se politikat e zhvillimit të hapësirës mund të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet një structure të ekuilibruar të hapësirës. Dokumenti kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për politikat sektoriale, përfshirë edhe ato që janë ngarkuar me zhvillimin e hapësirës në çdo nivel përkatës (integrimi horizontal) dhe ndërmjet aktorëve në nivelin e komunitetit dhe në nivelet ndërkombëtare, rajonale dhe lokale (integrimi vertikal). Sipas ESDP, bashkëpunimi është elementi më i rëndësishëm për një politikë të integruar të zhvillimit të hapësirës dhe ai përfaqëson një vlerë të shtuar mbi politikat sektoriale që veprojnë të izoluara.

Parimet udhëzuese të CEMAT për planifikimin e hapësirës, për të cilat u ra dakort në vitin 2000 dhe u aprovuan nga Këshilli i Evropës në 2002, identifikojnë një grup parimesh kryesore për politikën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rekomandimet kryesore për të forcuar planifikimin e hapësirës. Ky dokument, i cili është ndikuar në mënyrë të dukshme nga Karta e Torremolinos dhe ESDP, përmban rekomandime mbi çështje të tilla, si bashkëpunimi horizontal, bashkëpunimi vertical dhe pjesëmarrja e publikut në procesin e planifikimit të hapësirës.


Me legjislacionin e ri për planifikimin e territorit, në përputhje me udhëzimet e ESDP (dokumenti bazë i BE-së për planifikimin e hapësirës), qeveria shqiptare ka përcaktuar bazën për planifikimin e hapësirës. Aktualisht, të gjitha dokumentet e planifikimit të territorit në nivel kombëtar dhe lokal janë në proces përgatitjeje dhe/ose miratimi. Ndërkohë, sipas VKM nr.88 datë 7.02.2012 "Për një ndryshim në VKM nr.502, datë 13.07.2011 "Mbi aprovimin e rregullores uniforme për kontrollin e zhvillimit të territorit", të gjitha planet rregulluese rajonale dhe të përgjithshme që janë aprovuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 10119, datë 23.04.2009 "Mbi planifikimin e territorit", do të mbeten në fuqi, derisa të hartohet dhe të miratohet gjithashtu planifikimi i ri i territorit sipas legjislacionit të ri.

Ndërkohë, Dokumenti i Planifikimit të Hapësirës 2012-2020, si një dokument shumë strategjik për planifikimin e territorit në Shqipëri, është duke u përpunuar gjithashtu dhe do të reflektojë progresin e Shqipërisë në planifikimin e hapësirës brenda vendit dhe përtej kufijve, duke siguruar plane zhvillimi për çdo pjesë të territorit shqiptar, sipas ndarjes së zonave të tyre përkatëse (industriale, turistike, bujqësore, et.), mbështetur në aktivitetet kryesore ekonomike në zona të tilla.

5 Dokumentet e politikës kombëtare dhe kuadri ligjor

5.1 Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin 2007-2013 përfaqëson dokumentin bazë strategjik për një zhvillim të qëndrueshëm social-ekonomik të vendit, në përputhje me programin

	faqe 22 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

për integrimin në strukturat e BE-së dhe të NATO-s dhe për përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit⁵.

Që nga 2003 Shqipëria ka punuar drejt integritit në Bashkimin Evropian, i cili ka kërkuar përmbushjen e detyrimeve për reformat politike, ekonomike, të tregtisë dhe të drejtave të njeriut, me synimin për t'i përshtatur ato më mirë me vendet e tjera të BE-së. Në 2008 Këshilli i Evropës hyri në një partneritet evropian me Shqipërinë dhe në prill 2009 hyri në fuqi një Marrëveshje Stabilizim Asocimi (MSA), e cila konsiderohet si procesi përfundimtar përpara integritit të plotë. Një element kyç për procesin e reformës është Sistemi i Integruar i Planifikimit (SIP), një grup parimesh funksionale për të ndihmuar në planifikimin dhe zbatimin e politikës qeveritare dhe i aprovuar nga qeveria në nëntor 2005. Një prej proceseve themelore të SIP ishte një proces planifikimi strategjik afatmesëm dhe afatgjatë, Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin (2007-2013), e publikuar në mars 2008, e cila përcakton prioritetet dhe objektivat strategjike kombëtare.


Objektivat kryesore për 2013 janë si vijon:

- Integrimi i vendit në Bashkimin Evropian dhe NATO (objektiv i përmbushur në prill 2009).
- Të zhvillohet dhe të konsolidohet shtetin demokratik në bazë të lirive dhe të drejtave themelore të individëve; të zbatohet qeverisje e mirë, të luftohet korrupsioni dhe fenomene të tjera negative që pengojnë zhvillimin dhe integrimin e vendit dhe të garantohet funksionimi i sundimit të ligjit..
- Të arrihet një zhvillim i shpejtë, i ekuilibruar dhe i qëndrueshëm ekonomik, social dhe njerëzor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritit përqëndrohet në 20 fusha, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Infrastruktura e transportit, sidomos transporti rrugor, do të përmirësohet. Rreth 6,000 km rrugë rurale do të riparohen.
- Do të zhvillohet sistemi i energjisë dhe do të rritet kapaciteti për të prodhuar energji me qëllim që të plotësohen kërkesat totale për energji me kosto minimale sociale dhe mjedisore. Jo më vonë se 2013 në vend do të prodhohen më shumë se 8,500 GWh energji elektrike në vit.
- Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve do të zhvillohet në përputhje me standartet e Bashkimit Evropian. Përpara 2013 përqindja e popullsisë që do të mbulohet nga shërbimet e mëposhtme do të jetë: 95% për furnizimin me ujë, 83% për kanalizimet dhe 45% për trajtimin e ujit të përdorur.
- Mjedisori do të mbrohet nga ndotja dhe degradimi. Në 2013 cilësia mesatare e ajrit në Tiranë dhe në qytetet kryesore do të përmbushë standartet e Bashkimit Evropian.

⁵ Në shtator 2000, në Kombet e Bashkuara udhëheqësit e botës arritën një marrëveshje historike mbi Deklaratën e Mijëvjeçarit, duke i dhënë zë vlerave që ndahen globalisht dhe përkushtimit pa ekuivok për të përgjysmuar varfërinë në botë në 2015. Në korrik 2003, parlamenti shqiptar aprovoi një rezolutë në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) duke inkurajuar të gjitha palët e interesuara për të ndjekur rregullisht progresin në arritjen e OZHM nëpërmjet sistemeve kombëtare të monitorimit dhe vlerësimit dhe hartimit të raporteve vjetore të progresit që nxisin debatin public dhe japin rekomandime mbi mënyrat për të përmirësuar politikën kombëtare dhe rajonale të zhvillimit. Parlamenti shqiptar ka kërkuar të zhvillohen takime periodike për tu informuar mbi OZHM – në takimin e fundit të zhvilluar në maj 2006 u shqyrtua natyra plotësuese që kanë OZHM dhe integrimi në Bashkimin Evropian (BE).


	faqe 23 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- Do të ruhet niveli mesatar i rritjes ekonomike prej më shumë se 6% në vit dhe do të synohet që të arrijë në 7%.
- Do të ruhet stabiliteti makroekonomik nëpërmjet konsolidimit fiskal, reduktimit të vazhdueshëm të borxhit të brendshëm, përmirësimit të bilancit të llogarisë korrente dhe hartimit të politikës fiskale në përputhje me politikën monetare.
- Përqindja e taksave kryesore do të ulet, ndërkohë që do të ruhet niveli i mbledhjes së të ardhurave publike në 27 - 28% të GDP nëpërmjet reduktimit të informalitetit dhe menaxhimit të mirë të sistemit fiskal.
- Do të krijohet një klimë e favorshme për biznesin për zhvillimin dinamik të sipërmarrjeve private dhe tërheqjen e investimeve të huaja.
- Do të lehtësohet funksionimi i tregut të punës nëpërmjet përmirësimeve në shërbimet e punësimit, zbatimit të programeve aktive dhe arsimit dhe trajnimit profesional. Niveli i papunësisë do të jetë më pak se 10% në 2013.
- Përqindja e varfërisë për numrin total të popullsisë do të reduktohet nën 10% në 2013⁶.
- Do të hartohet një kuadër i plotë ligjor për politikën sociale, i cili do të sigurojë mbrojtjen sociale për të gjithë qytetarët.
- Do të promovohen mundësi të barabarta.
- Do të ristrukturohet dhe reformohet sistemi aktual i pensioneve publike dhe do të synohet drejt një sistemi pensionesh me shumë shtylla.
- Sistemi i shëndetit publik do të ofrojë një shërbim bazë, me cilësi të mirë dhe efektiv për të gjithë. Deri në 2013 niveli i vdekshmërisë foshnjore do të reduktohet në 5 për 1000 lindje të gjalla.
- Një sistem arsimor me cilësi të mirë, përfshirës, fleksibël do t'i përgjigjet nevojave të ekonomisë së tregut. Deri në 2013 niveli neto i regjistrimit në shkollat e arsimit të mesëm do të rritet në 76%.
- Do të zbatohet një model i ri, gjithëpërfshirës dhe i integruar i planifikimit të hapësirës.
- Do të zbatohet një politikë e integruar dhe koherente që do të synojë arritjen e zhvillimit rajonal të ekuilibruar dhe reduktimin e pabarazisë ndërmjet rajoneve.
- Do të konsolidohen programet publike që mbështesin zhvillimin bujqësor dhe rural në përputhje me praktikën e BE-së. Do të prezantohet gradualisht një sistem modern i sigurisë ushqimore dhe do të konsolidohen institucionet që garantojnë standartet e saj.

Në dhjetor 2011 Komiteti i Planifikimit Strategjik i kryesuar nga Kryeministri, si struktura vendimmarrëse më e lartë për Sistemin e Planifikimit të Integruar, aprovoi procedurën dhe metodologjinë e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritit 2007-2013. Krahas kësaj, ky proces u formalizua me Urdhrin Nr. 12 datë 02.02.2012 të Kryeministrit "Për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritit 2013-2020". SKZHI 2013-2020 është parashikuar të hartohet brenda një periudhe një vjeçare, janar 2012-janar 2013, kur ajo do të diskutohet me palët e interesuara dhe shoqërinë civile. Finalizimi dhe aprovimi i SKZHI 2013-2020 është parashikuar për në muajin mars 2013.

Në seksionet në vijim janë paraqitur strategjitë kombëtare sektoriale që janë marrë në konsideratë me qëllim të hartimit të Planit Kombëtar Sektorial për projektin TAP.

⁶ Në nivelin e varfërisë përfshihet çdo person që fiton më pak se 4891Lek (€35) në muaj. Shiko <http://ëëë.instat.gov.al/graphics/doc/doënloads/Neë/Living%20Standard%20Measurement%20Survey%202008.pdf>

	faqe 24 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

5.1.1 Strategjia e Energjisë

Strategjia Kombëtare për Energjinë është aprovuar me VKM Nr. 424, datë 26.06.2003 për periudhën 2013 – 2015.

Strategjia Kombëtare e Energjisë për periudhën 2013-2020 është hartuar si një detyrim që Shqipëria ka marrë në kuadër të integrimit të saj në BE. Ajo mbështetet në Urdhrin Nr.93, datë 7.08.2012 "Për hartimin e strategjive kombëtare sektoriale dhe ndërsektoriale për periudhën 2013-2020, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integrimit 2013-2020"; versioni aktual përfundimtar është në fazën përfundimtare të procesit të konsultimit dhe aprovimit.


Vizioni

Qeveria shqiptare synon të zhvillojë një sistem energjie që bazohet në parimet e tregut, që të jetë në gjendje të plotësojë kërkesat për energji, për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë dhe që garanton sigurinë, mbrojtjen e mjedisit dhe rrit mirëqënien sociale me kosto minimale.

Prioritetet strategjike

Prioritetet e mëposhtme janë përcaktuar me qëllim që të arrihen objektivat e strategjisë:

- Përfundimi i procesit të ristrukturimit të sektorit shqiptar të energjisë;
- Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe efektiv institucional;
- Të rritet siguria e furnizimit me energji nga brenda vendit,
- Të rritet kontributi i sektorit të energjisë në zhvillimin ekonomik të vendit, në buxhetin e shtetit dhe bilancin financiar të vendit,
- Rritja e kapaciteteve gjeneruese dhe diversifikimi i tyre,
- Shtimi i aktiviteteve të kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve dhe tërheqja e investitorëve strategjikë në këtë sektor si dhe për zhvillimin e rezervave ekzistuese, për të mundësuar përdorimin efektiv dhe efekshmërinë e naftës bruto.
- Ndërtimi i linjave të reja të interkonjeksionit në sektorin e energjisë,
- **Angazhimi për realizimin e projekteve rajonale të interkonjeksionit me linjat e rrejtit të gazit dhe diversifikimin e burimeve të furnizimit,**
- Të rritet efektshmëria e burimeve të energjisë të sistemit të furnizimit me koncepte të planifikimit me kosto më të ulta dhe ndikim minimal mbi mjedisin,
- Të promovohet përdorimi eficient dhe ekonomik i burimeve të energjisë si dhe të promovohet përdorimi i mjeteve të ndryshme të menaxhimit të energjisë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- Të inkurajohet përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme,
- Krijimi i një tregu të brendshëm dhe integrimi i tij me tregun rajonal,

	faqe 25 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- Përmirësimi i kapaciteteve menaxhuese në sektorin e energjisë,
- Të përmirësohet organizimi institucional i sektorit të energjisë dhe nënsektorëve të tij (energji elektrike, hidrokarburet, energjia e rinovueshme dhe eficienta e energjisë).

Qëllimet strategjike

Strategjia Kombëtare e Energjisë synon të udhëheqë zhvillimin e sektorit të energjisë nëpërmjet liberalizimit të mëtejshëm të tregut të energjisë, inkurajimit të investimeve, diversifikimit të burimeve të energjisë, përdorimit eficient të burimeve të energjisë dhe burimeve të rinovueshme, promovimit të përdorimit të mjeteve të ndryshme për menaxhimin e energjisë, përdorimit të një sistemi fiskal inkurajues për aktivitetet e sektorit të energjisë dhe tarifave reale, rritjes së konkurrencës dhe integritit rajonal të sektorit të energjisë.

Të gjitha këto do t'i shërbejnë qëllimit strategjik të rritjes së sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike, mbështetjes së zhvillimit ekonomik dhe social të vendit dhe mbajtjes së një qëndrimi miqësor ndaj ambientit.

Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Energjisë mbështetet në dy skenarë referues:

- Prezantimi i gazit natyror dhe
- Pa gaz natyror

Për secilin nga këto skenarë janë hartuar dy nënskenarë zhvillimi, duke marrë parasysh gjithashtu angazhimet e Shqipërisë si palë nënshkruese e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë, për të arritur objektivat për eficientë e energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.


Skenarët e zhvillimit shqyrtojnë politika të rëndësishme të energjisë, të cilat do të përballen me vendimet e strukturave që hartojnë politika, përfshirë:

- Alternativat që kërkojnë sigurinë e furnizimit për të plotësuar kërkesat në rritje për energji në një periudhë afatgjatë,
- Metodën e rritjes së sigurisë së furnizimit me energji në një sistem ku mbizotëron prodhimi nga hidrocentralet,
- Mundësitë dhe alternativat financiare për arritjen e objektivave të Komunitetit të Energjisë dhe të Bashkimit Evropian për eficientë e energjisë dhe menaxhimin e saj, burimet e rinovueshme dhe emetimet e CO₂ (iniciativat 20/20/20).

Skenarët alternativë janë duke marrë në konsideratë:

Objektivat për zhvillimin e Energjisë së Rinovueshme : Kjo politikë trajton përdorimin në rritje të energjive të rinovueshme për të arritur një nivel përdorimi prej 39% në 2020, krahasuar me konsumin e përgjithshëm përfundimtar të energjisë (në përputhje me kërkesat e Komunitetit të Energjisë).

Objektivat për të rritur Eficientë e Energjisë : Ky skenar është ndërtuar duke respektuar detyrimin e Shqipërisë, të përcaktuar nga Komuniteti i Energjisë dhe Bashkimi Evropian për

	faqe 26 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

rritjen e efikasitetit të energjisë deri në 9% përpara 2018, krahasuar me konsumin e përgjithshëm përfundimtar të energjisë. Politika duhet të marrë parasysh se për të përmbushur këtë detyrim dhe kërkesën për energji deri në 2020, duhet patjetër të rishikohen programet për promovimin e tregut, depërtimin e teknologjive të përparuara (për të arritur në 50% të blerjeve të pajisjeve të reja të teknologjisë së përparuar, krahasuar me detyrimin prej 10%, që është përmendur në skenarin e referencës, pa ndërhyrjen aktive të qeverisë në sektorin e energjisë).

Kombinimi i politikave të Energjisë së Rinovueshme dhe Efikasitetit të Energjisë: Ky kombinim, si në pikpamjen e realizimit të furnizimit, ashtu edhe të plotësimit të kërkesës, shqyrton rezultatet ndërvepruese të këtyre dy faktorëve.


Lidhja e Shqipërisë me rrjetin rajonal të gazit natyror: Skenari i referencës presupozon zhvillimin e sektorit të energjisë, duke e ditur që deri në 2018 rrjeti shqiptar i gazit nuk do të jetë i lidhur me rrjetin rajonal të gazit. Projekti TAP, sipas skenarit, është parashikuar që të jetë efektiv pas 2018. Është me vlerë të përmendet që skenarët marrin në konsideratë alternative të tjera për furnizimin e vendit tonë me gaz natyror nga Maqedonia, Greqia dhe Mali i Zi (projekti IAP, Unaza e Gazit e Ballkanit Perëndimor, etj.).

Skenari që përmendet është ndërtuar duke u mbështetur në zhvillimet aktuale të vendit tonë, si edhe në parametrat bazë të zhvillimeve makroekonomike të vendit tonë. Ai presupozon se një pjesë e madhe e kërkesës për energji elektrike në të ardhmen do të plotësohet nga zgjerimi i kapacitetit gjenerues termik (mbështetur në naftën që nxirret nga deti, karburantin, naftën bruto ose gazin natyror të importuar) dhe të hidrocentraleve. Produktet e naftës do të kenë një dominim të madh në ekuilibrin e energjisë. Presupozimi në këtë skenar është i lidhur me performancën aktuale, ku objektivat në sektorin e energjisë nuk zbatohen në mënyrë strikte. Në këtë analizë viti 2006 është marrë në konsideratë si fillim, me qëllim që të shihet tendenca e zhvillimit të sektorit të energjisë dhe ekonomisë, bazuar në konsumin real në vitet e fundit.

5.1.2 Alternativa strategjike për të lidhur Shqipërinë me rrjetin ndërkombëtar të naftës dhe gazit

Aktualisht Shqipëria ka një prodhim minimal të gazit natyror, rreth 4-5 million Nm³, e cila është një sasi pothuajse e parëndësishme që shërben vetëm për të furnizuar proceset teknologjike të rafinerisë dhe industrisë së naftës. Pavarësisht përpjekjeve dhe inkurajimit të investitorëve të huaj nga të gjitha strukturat e shtetit shqiptar, Shqipëria nuk është ende e lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit. Është e kuptueshme se lidhja e Shqipërisë me rrjetin e gazit do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës së energjisë në vend dhe do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në përdorimin e energjisë. Deri më sot ngarkesa kryesore i përket produkteve të naftës dhe energjisë elektrike. Shqipëria nuk është e lidhur me rrjetet ndërkombëtare të naftës dhe gazit natyror dhe është duke shqyrtuar aktualisht mundësinë e lidhjes së saj me këto rrjete. Skenari i energjisë së rinovueshme mbështet të gjitha alternativat, të cilat e përfshijnë vendin tonë në rrjetin ndërkombëtar të naftës dhe gazit, duke i dhënë përparësi projektit, i cili e konsideron Shqipërinë si një vend tranzit dhe merr parasysh avantazhet e alternativave që vendi ynë ofron për ruajtjen e gazit nën tokë.

Ndër projektet, të cilat mund të kenë zhvillim të mundshëm për lidhjen e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit dhe zhvillimin e tregut të bredhshëm të gazit, janë:

	faqe 27 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- Projekti i gazsjellësit Trans Adriatik (gazsjellësi Trans Adriatik - TAP)**, që po zhvillohet nga një konsorcium aksionerësh: Kompania norvegjeze Statoil me 42.5% të aksioneve, kompania zvicerane me 42.5% dhe kompania gjermane E.ON Ruhrgas me 15% të aksioneve. Ky gazsjellës do të jetë pjesë e një korridorit të ri të furnizimit me gaz të Evropës, i ashtuquajtur "Korridori Jugor i Gazit", i cili do të sjellë gazin nga Kaspiku dhe Lindja e Mesme në vendet evropiane. Gazsjellësi me një gjatësi prej 800 km dhe me kapacitet transportues prej 10 mmk (me mundësi për tu rritur deri në 20 mmk), do të kalojë përmes Greqisë, Shqipërisë, detit Adriatik deri në Italinë e jugut.

Shqipëria e ka mbështetur këtë variant dhe e ka rritur bashkëpunimin me shoqërinë e gazsjellësit Trans Adriatik, duke hyrë në negociime për një Marrëveshje Ndërqeveritare ndërmjet tre vendeve (Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë) dhe në një Marrëveshje të Qeverisë Pritëse që Shqipëria do të realizojë me shoqërinë e gazsjellësit Trans Adriatic. Aktualisht ERE është duke shqyrtuar kërkesën e dërguar nga shoqëria e gazsjellësit Trans Adriatik AG për të aprovuar përjashtimin nga aksesit të palëve të treta dhe po punon në këtë drejtim me autoritetet rregullatore të dy vendeve, Greqi dhe Itali. Shqipëria shfrytëzon pjesëmarrjen në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, i cili mbështet projektet e gazit, të cilat krahas furnizimit të vendeve evropiane, realizojnë gazifikimin për shumë vende të Evropës juglindore.

- Projekti i gazsjellësit Jon Adriatik - IAP.** Projekti ka lidhje me planet e zhvillimit të rrejtit të gazit natyror në Ballkanin perëndimor, nga Kroacia në Bosnje & Hercegovinë, Mal të Zi dhe Shqipëri. Ky projekt shpresohet të funksionojë në një sistem qarku të mbyllur, ku furnizimi do të realizohet në dy drejtime, veri dhe jug nga sistemi kroat i transportit të gazit dhe TAP. Projekti IAP do të jetë gjithashtu pjesë e Unazës së gazit të Komunitetit të Energjisë (Cikli i Gazit i Komunitetit të Energjisë), i cili është një projekt rajonal, i aprovuar nga Komuniteti i Energjisë dhe BE. Projekti i gazsjellësit IAP është aktualisht në fazën e kryerjes së studimit të fizibilitetit, me një fond prej 3 milionë Euro nga BE.


5.1.3 Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (2007-2013) është aprovuar me VKM Nr.795, datë 11.07.2007.

Strategjia ka si qëllim të krijojë një partneritet të qëndrueshëm qeveri-biznes dhe një ambient miqësor për realizimin e investimeve dhe politikave të eksporteve nëpërmjet industrializimit dhe orientimit të investimeve në degët me teknologji të lartë.

Ekonomia shqiptare është tani plotësisht e hapur, me një tregti krejtësisht të liberalizuar dhe një sektor bankar që është krejtësisht në pronësi private. Shqipëria u bë anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë në vitin 2000. Regjimi tregtar i Shqipërisë është vlerësuar se është shumë liberal, me tarifa doganore mesatare, një sistem të lehtësuar për marrjen e licensave dhe pothuajse mosekzistencën e pengesave jotarifore.

Objektivat e rëndësishme afatmesme dhe afatgjata të kësaj strategjie përfshijnë; i) liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë, ii) monitorimin e koordinimit ndërinstitucional me qëllim që të sigurohet përqasja e legjislacionit ekonomik dhe tregtar shqiptar me standartet e Organizatës Botërore të

	faqe 28 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Tregtisë dhe Bashkimit Evropian dhe për të zbatuar Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe marrëveshjen e përkohshme me BE.

Kjo strategji përcakton objektiva për: i) provovimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; ii) nxitjen e investimeve në industrinë joushqimore; iii) zhvillimin e industrisë minerare; iv) promovimin e eksportit; dhe v) investimet e huaja dhe të drejtpërdrejta.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2013-2020 është hartuar dhe është në proces konsultimi. Vizioni i kësaj projekt strategjie është: *Zhvillimi i një sipërmarrjeje dinamike dhe i një industrie productive, e aftë për t'iu përgjigjur sfidave të zhvillimit dhe integritit, konkurrencës rajonale dhe globale.*

Duke pasur si qëllim krijimin e kushteve dhe orientimin e investimeve të tjera në Shqipëri, vizioni strategjik do të përqëndrohet në:

- Përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe investimeve, duke reduktuar pengesat burokratike dhe kostot e biznesit;
- Zhvillimin e një sektori produktiv industrial dhe minerar, i cili të jetë në gjendje të përpunojë lëndët e para në vend dhe të rrisë vlerën e shtuar nëpërmjet investimeve dhe përdorimit të teknologjive të reja, prodhimit të pastër, rritjes së profesionalizmit dhe punësimit, i cili nxit krijimin e një industrie konkurruese.
- Krijimin e një partneriteti ndërmjet qeverisë dhe biznesit në lidhje me nevojat për përmirësimin e teknologjisë, novacionit dhe aftësisë për të përgatitur një "fuqi punëtore të kualifikuar".
- Krijimin e një industrie konkurruese dhe dinamike, investimet e huaja, rritjen dhe diversifikimin e eksporteve dhe nxitjen dhe krijimin e bizneseve të reja.


5.1.4 Strategjia Sektoriale dhe Ndërsektoriale për Mjedisin

Strategjia Sektoriale dhe Ndërsektoriale për Mjedisin është aprovuar me VKM Nr. 847, datë 29.11.2007.

Strategjia Sektoriale dhe Ndërsektoriale për Mjedisin (SSNM) është pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim. Ajo duhet të shihet në kontekstin e një politike kombëtare. Ajo synon të përmbushë një detyrim kushtetues ndaj qytetarëve, të cilët kanë të drejtë të jetojnë në një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjik, drejt zhvillimit të Shqipërisë në një mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet përdorimit racional të burimeve natyrore, mbrojtjen e tyre nga ndotja dhe degradimi si dhe duke promovuar vlerat e tyre mjedisore, me qëllim që t'i shndërojë ato në asete të rëndësishme për rritjen e mëtejshme ekonomike të vendit.

Vizioni

Zhvillimi i shpejtë dhe i qëndrueshëm është objektivi themelor i qeverisë shqiptare. Shqipëria duhet të zhvillohet duke mbrojtur burimet e saj natyrore deri në shkallën më të lartë të mundshme nda ndotja dhe degradimi. Si rrjedhim, promovimi i vlerave mjedisore dhe përdorimi i tyre për të

	faqe 29 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

ndihmuar përparimin ekonomik të vendit garanton sigurinë e rritjes ekonomike. Në funksion të këtij zhvillimi, Shqipëria ka nevojë për një Plan Veprimi, që do të funksionojë në drejtim të:

- përmirësimin të cilësisë së jetës;
- krijimit të kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar; dhe
- integrimin e strategjisë mjedisore me strategji të tjera sektoriale


Prioritetet strategjike

Prioritetet e përcaktuara në programin e qeverisë mund të konsiderohen në lidhje me disa objektiva të përgjithshëm:

- Zbatimin e legjislacionit për mjedisin
- Aproximin e standarteve ligjore të Komunitetit Evropian
- Investimet kapitale për mbrojtjen e mjedisit (furnizimi me ujë të pijshëm – i besueshëm, i mjaftueshëm dhe me një cilësi të përshtatshme; grumbullimi i ujit të përdorur – kanalizimet e ujërave të zeza në të gjitha qytetet me popullsi më të madhe se 2000 banorë; trajtimi i ujit të përdorur – trajtimi dytësor i ujit të përdorur të grumbulluar për të gjitha qytetet; mbetjet e ngurta - grumbullimi, riciklimi dhe asgjësimi (vendet e groposjes dhe djegies së plehrave); cilësia e tokës – riparimi i dëmeve në "zonat e nxehta"; përmirësimi teknologjik i industrive që janë në pronësi të shtetit
- Mbështetja financiare për infrastrukturën mjedisore
- Menaxhimi i Burimeve Mjedisore (shfrytëzimi i burimeve minerale – administrimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme, pa ndikime negative mbi mjedisin; shfrytëzimi i pyjeve dhe kullotave – menaxhimi i qëndrueshëm që garanton të ardhmen e tyre; shfrytëzimi i peshkimit – administrimi në përputhje me konceptet e mbrojtjes së natyrës; menaxhimi i tokës – kontrolli i zhvillimit me qëllim që të ruhet peizazhi dhe biodiversiteti; administrimi i qëndrueshëm i zonave të mbrojtura – rritja e sipërfaqes së tokës që përcaktohet për këtë qëllim dhe përmirësimet në menaxhimin e këtyre zonave; mbrojtja e tokës – parandalimi i erozionit dhe braktisjes së tokës; mbrojtja e faunës – parandalimi i humbjeve të florës dhe faunës si rezultat i shfrytëzimit të gabuar; burimet dhe të drejtat për ujë – kontrolli mbi sasinë e përdorur të ujit dhe ruajtja e cilësisë së tij).
- Komunikimi dhe ndërgjegjësimi
- Decentralizimi dhe pronësia

Objektivat e kësaj strategjie janë:

- Arritja e standarteve të kërkuara nga (BE, OBSH) për cilësinë e ajrit, furnizimin dhe trajtimin e ujit, zhurmat, mbetjet urbane dhe zonat e mbrojtura, me qëllim që të përmirësohet cilësia e jetës;

	faqe 30 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- Reduktimi i emetimit të gazrave serë dhe substancave që e reduktojnë shtresën e ozonit, me synimin për të kontribuar në parandalimin e ndryshimeve klimatike,
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e të gjitha burimeve ujore tokësore dhe nëntokësore për përdorim aktual dhe në të ardhmen,
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës me synimin për të rritur në maksimum pjellorinë e saj, për të minimizuar dhe për të parandaluar ndotjen,
- Mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit i zonave dhe specieve të mbrojtura me synimin për të ruajtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore të mjedisit tonë, në përputhje me angazhimet tona evropiane dhe ndërkombëtare;
- Një planifikim efektiv i hapësirës dhe zhvillimit të integruar, i cili merr në konsideratë objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore në një mënyrë të ekuilibruar;
- Riparimi dhe restaurimi i zonave të dëmtuara rëndë me synimin për të parandaluar rreziqet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit, që vijnë si pasojë e këtyre dëmtimeve.

5.1.5 Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit

Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit është aprovuar me VKM Nr.668, datë 29.09.2007.

Koncepti i Menaxhimit të Integruar të Kufirit është:


Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjitha autoriteteve dhe agjencive përkatëse të përfshira në kontrollin e kufirit, lehtësimi i tregtisë dhe bashkëpunimi rajonal ndërkufitar për të vendosur sisteme efektive dhe efikase për menaxhimin e integruar të kufijve, me qëllim që të sigurohet qëllimi i përbashkët për kufij të hapur, por të kontrolluar dhe të sigurtë.

Objektivi i përgjithshëm strategjik i qeverisë shqiptare është të zhvillojë një sistem të sigurisë së kufirit që do të integrojë të gjitha institucionet shtetërore, të cilat kanë përgjegjësi për kontrollin e kufirit. Objektivi specifik i strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK) është që të sigurojë një bazë për koordinimin dhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve dhe agjencive përkatëse të përfshira në sigurinë e kufirit dhe lehtësimin e tregtisë, me qëllim për të vendosur sisteme efektive dhe efikase për menaxhimin e integruar të kufirit, që do të sigurojnë kufij të hapur, por të kontrolluar dhe të siguruar mirë.

Strategjia shqiptare e MIK përmban një vlerësim të situatës aktuale në fushën e menaxhimit të kufirit dhe identifikon fushat ku përmirësimi është i domosdoshëm. Plani i Veprimit i MIK përmban objektiva konkrete, të cilat mbështeten në rekomandimet e strategjisë. Secili objektiv është i zbërthyer në masa dhe secila masë është zbërthyer më tej në aktivitete për të lehtësuar zbatimin e planit.

Disa prej objektivave të Planit të Veprimit të strategjisë së MIK trajtojnë çështje që janë tashmë në rrugën e zgjidhjes:

- Riorganizimi i Policisë Kufitare dhe të Migracionit për të siguruar autonominë,
- Drejtimi dhe kontrolli civil i vëzhgimit të kufirit detar,
- Harmonizimi progresiv i kuadrit ligjor; dhe

	faqe 31 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- Hartimi i procedurave

Fushat kryesore ku qeveria duhet të përqëndrojë aktivitetet e saj me qëllim që ta shndërrojë sistemin aktual të sigurisë së kufirit në një sistem të sigurisë së kufirit që do të sigurojë kufij të hapur, por të sigurtë, janë: i) Kuadri ligjor dhe rregullator; ii) Menaxhimi dhe organizimi; iii) Procedurat; iv) Burimet njerëzore dhe trajnimet; v) Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit; vi) Infrastruktura dhe pajisjet.

Objektivat strategjike

- Ndryshimet e duhura në legjislacionin përkatës (për të tre shtyllat) do të sigurojnë që strukturat e kufirit janë organizuar dhe funksionojnë siç kërkohet nga BE. Të gjitha procedurat e strukturave të kufirit janë përcaktuar në Procedurat e brendshme Standarte Operacionale (PSO) në lidhje me personelin, trajnimet, financat dhe logjistikën, duke u konsultuar ndërmjet tyre.
- Reformat organizative dhe ristrukturimi në vijim të ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe rregullator sigurojnë metodën e përshtatshme të drejtimit, kontrollit dhe menaxhimit të burimeve të saj njerëzore, materiale dhe financiare.
- Zbatimi i procedurave të duhura dhe transparente për përzgjedhjen dhe emërimin në detyrë të punonjësve të strukturave të kufirit, të cilat janë miratuar më parë. Rritja e cilësisë dhe profesionalizmit të punonjësve të strukturave të kufirit.
- Të përmirësohet komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit si dhe shpërndarja e informacionit ndërmjet strukturave të kufirit dhe të krijohet një sistem për menaxhimin e të gjitha informacioneve
- Infrastruktura dhe pajisjet e përshtatshme mbështesin përpjekjet e strukturave për t'i ofruar shërbim profesional qytetarëve dhe palëve të tjera përfituese.


5.1.6 Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit

Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit (AFSS) 2007 – 2013 është aprovuar me VKM Nr.924, datë 14.11.2007.

Qëllimi i AFSS është që të garantojë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë dhe agro-industrisë, ndërsa objektivat kanë lidhje me menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, rritjen e standartit të jetesës së fermerëve, rritjen e sigurisë ushqimore, përmirësimin e marketingut bujqësor, etj. Të gjitha këto objektiva reflektojnë tre kriteret e MSA.

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë kombëtare, duke kontribuar me rreth 21% të GDP (në 2006). Familjet në zonat rurale vazhdojnë të dominojnë me më shumë se 50% të popullsisë dhe bujqësia është alternative kryesore e punësimit të njerëzve që banojnë në zonat rurale.

Sipërfaqja totale e tokës bujqësore përfaqëson vetëm 24% (about 699,000 ha) të sipërfaqes së përgjithshme të vendit. Për më tepër, vetëm 561,000 ha janë tokë e punueshme. Rreth 43% (ose

	faqe 32 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

304,000 ha) të sipërfaqes totale të tokës bujqësore ndodhet në zonat e ulta me potencial prodhimtarie relativisht të lartë, rreth 34% (ose 239,000 ha) ndodhet në zona të tjera të ulta dhe pjesa e mbetur prej 23% (ose 159,000 ha) ndodhet në zona malore dhe është caktuar pothuajse në mënyrë ekskluzive për kultivimin e pemëve frutore.

Vizioni

Sektori i bujqësisë dhe i përpunimit të produkteve bujqësore duhet patjetër të arrijë një nivel të lartë prodhimtarie dhe konkurrence si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm, mbi bazën e përmirësimit të kushteve për të lejuar iniciativën private për të funksionuar dhe mbështetur plotësisht zhvillimin në një mënyrë të qëndrueshme, të garantuar nga institucionet efikase. Sektori varet nga niveli i teknologjisë dhe njohurive dhe rendimenti i përdorimit të tokës, nga puna dhe elementët e tjerë. Prodhimtaria dhe konkurrenca më e lartë janë themelet për rritjen e prodhimit, për përmirësimin e kushteve për fermerët dhe bizneset e përpunimit të produkteve bujqësore për të dalë të treg, për rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e standartit të jetesës së fermerëve dhe familjeve të tyre.

Rritja e cilësisë së produkteve agroushqimore është një factor themelor për rritjen e konkurrencës. Rritja e cilësisë do të vijë si rezultat i përmirësimeve teknologjike, por edhe nga metodat dhe teknikat e reja të menaxhimit të integruar të sistemeve të prodhimit dhe reduktimit të përdorimit të plehrave kimike, të cilat do të nxisin rritjen e prodhimeve organike. Vizioni strategjik i AFSS merr në konsideratë zhvillimin e bujqësisë dhe të përpunimit të produkteve bujqësore nëpërmjet spektrit të integritimit evropian, i cili udhëheq vizionin e qeverisë për këto sektorë dhe struktura për të përmbushur standartet dhe kërkesat për një integrim më të shpejtë të Shqipërisë në BE, në përgjithësi dhe MSA në veçanti.


Gjatë periudhës së kohëve të fundit, politika bujqësore mund të karakterizohet si një mbështetje kryesore indirekte, e cila është përqëndruar në aspektet kryesore të mëposhtme: Rehabilitimin e infrastrukturës; krijimin e një mjedisi miqësor për biznesin; mbështetjen e shërbimeve për fermerët; fuqizimi institucional.

AFSS përcakton pesë prioritetet:

1. Do të rritet mbështetja financiare për fermat, bizneset bujqësore dhe të përpunimit të produkteve bujqësore.
2. Do të përmirësohet menaxhimi, ujitja dhe kullimi i tokave bujqësore.
3. Do të përmirësohet marketingu i produkteve bujqësore dhe atyre të përpunuara.
4. Do të përmirësohet niveli dhe cilësia e teknologjive, informacionit dhe njohurive të fermerëve dhe bizneseve që përpunojnë produktet bujqësore.
5. Do të rritet cilësia e ushqimeve dhe siguria e produkteve bujqësore dhe agroushqimore.

5.1.7 Strategjia Sektoriale e Transportit

Strategjia Sektoriale e Transportit 2007 – 2013 është aprovuar me VKM Nr. 1214, datë 3.9.2008. Shqipëria ka planifikuar tashmë një seri masash për të përmbushur detyrimet e saj si një anëtare me të drejta të plota e procesit të Stabilizimit dhe Asociimit. Integrimi në BE në sektorin e transportit rrugor nënkupton përafrimin e kuadrit ligjor të transportit me standartet dhe rregulloret ndërkombëtare.

	faqe 33 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Qeveria shqiptare ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit për Rrjetin Core (**SEETO**). Ky rrjet synon kryesisht të lehtësojë integrimin e Evropës Juglindore në përputhje me objektivat e procesit të Stabilizimit dhe Asociimit.

Objektivi strategjik synon të krijojë një rrjet unik të transportit rrugor, i cili do të shërbejë si një mjet komunikimi për të ekuilibruar gradualisht nivelet ekonomike, sepse:


- shkurtohet distanca ndërmjet tregjeve
- shmangen zonat e mbipopulluara
- trafiku shpërndahet në mënyrën më të mirë të mundshme dhe do të ulë nivelin e ndotjes dhe të aksidenteve.

Politika për zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit rrugor rrjedh nga Plani Kombëtar Shqiptar i Transportit (PKSHT), i aprovuar nga qeveria në maj May 2006. PKSHT po azhurnohet rregullisht dhe ai përfaqëson dokumentin, tek i cili duhet referuar për analizën e politikave të transportit që duhet të ndiqen. PKSHT është hartuar duke u mbështetur në modelin e transportit që kombinon kërkesën për transportin e mallrave dhe të njerëzve.

Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë në lidhje me organizimin institucional, hartimin e akteve nënligjore (përfshirë gjithashtu respektimin e disa konventave) dhe zbatimin e tyre në lidhje me përmirësimin e komponentëve të sigurisë rrugore.

Politikat kryesore për periudhën afatmesme dhe afatgjatë për zhvillimin e Rrjetit Kombëtar Rrugor synojnë:

- Zbatimin e **Planit Kombëtar të Transportit** dhe azhurnimi i vazhdueshëm për pjesën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore, përfshirë planifikimin e investimeve në përputhje me Programin e Buxhetit Afatmesëm (PBM) dhe planifikimin e buxhetit për mirëmbajtjen e aseteve rrugore (ai përmirëson përmbushjen e prioriteteve të programit të rrjetit kombëtar rrugor, të përcaktuara gjatë hartimit të projekt-buxhetit për vitin pasardhës).
- Hartimin dhe aprovimin e **standarteve të rrugëve** (përcaktimi dhe aprovimi i standarteve të rrugëve sipas kushteve fizike dhe ekonomike të vendit). (Përcaktimi i standarteve duke iu referuar normave të BE-së, të financuara nga projekti CARDS i Delegacionit të BE-së).
- Përmirësimi i mirëmbajtjes së rrugëve nëpërmjet **Sistemit të Menaxhimit të Pasurive Rrugore** (SMPRR), ndërkohë që përfshin në sistem urat, duke i dhënë përparësi përcaktimit të buxheteve për mirëmbajtjen e urave (ngritjen e Sistemit për Menaxhimin e Pasurive Rrugore dhe të mekanizmave për të financuar mirëmbajtjen e rrugëve, me qëllim që të dyfishohen shpenzimet e mirëmbajtjes).
- Rishikimi i rezultateve të klasifikimit për një pjesë të rrugëve dytësore, të cilat janë aktualisht nën administrimin e DPRR si rrugë kombëtare. Këto rrugë duhet të riklasifikohen si rrugë lokale. Ky klasifikim është duke u studiuar aktualisht dhe po përgatitet nga DPRR në bashkëpunim me Grupin e Asistencës Teknike nga MPPTT.
- Studim me pjesëmarrje i nevojave të rehabilitimit për tu përfshirë në një program për përmirësimin e rrugëve lokale dhe rurale, përfshirë prioritetet dhe investimet vjetore (Master Plani i Rrugëve Lokale dhe Urbane, i cili do të çojë në një plan investimesh që ka përparësi).

	faqe 34 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- **Riorganizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve** (me synimin e përmirësimeve të ndjeshme të kapaciteteve të saj për menaxhimin e kontratave të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve)
- Përgatitja e **hartave të azhurnuara të rrugëve** nga Instituti i Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, me përfshirjen e konsulentëve përkatës.
- Rishikimi dhe **ndryshimi i Ligjit për Shpronësimet** Nr. 8561 dhe ndryshimi i procedurave të regjistrimit të tokës të parashikuara në Ligjin për Regjistrimin e Tokës Nr. 7843.
- Përgatitja e **sistemit të ngarkesës për aks** (përgatitja e projekt dokumenteve nga DPRR dhe Grupi i Asistencës Teknike i MPPTT).
- Përfshirja e projekteve të infrastrukturës rrugore në një cikël të plotë të menaxhimit të investimeve publike, përfshirë identifikimin, aprovimin dhe vlerësimin e projekteve (në vazhdimësi).

Programi i investimeve sipas prioriteteve për periudhën 2008 – 2013

Përfundimi i investimeve madhore në rrjetin kombëtar të rrugëve (i cili është përfshirë pothuajse plotësisht në rrjetin kryesor rajonal) përfshin si vijon:

Korridorin Lindje – Perëndim (Korridori 8)

- Ndërtimi i rrugës Lushnje – Fier, 21.5 km e gjatë, e financuar nga qeveria italiane me 24 milionë Euro (e përfunduar në 2008).
- Ndërtimi i rrugës Fier – Levan – Vlorë, 43 km e gjatë, me vlerë 101 milionë Euro, bashkëfinancim i BERZH dhe Bankës Evropiane e Investimeve (BEI) (e përfunduar në 2010).
- Ndërtimi i rrugës Qafë Thanë – Pogradec – Korçë, 64 km e gjatë, me vlerë 90 milionë Euro (për tu përfunduar në 2011).

Korridori Veri – Jug


- Ndërtimi i rrugës Fier – Levan – Tepelenë, 71 km e gjatë (me vlerë 70 milionë Euro), bashkëfinancuar nga BERZH dhe BEI (e përfunduar në 2010).

5.1.8 Strategjia Sektoriale e Turizmit

Strategjia Sektoriale për Turizmin është aprovuar me VKM Nr. 844, datë 11.06.2008. Strategjia u hartua për ta zgjeruar dhe forcuar këtë sektor, duke u përqëndruar në mënyrë të veçantë në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe identifikimin e sfidave, për të rritur sa më shumë efektshmërinë e kontributeve në këtë sektor.

Sfidat e përgjithshme për zhvillimin e turizmit në Shqipëri:

- Krijimi i një pozicioni të qartë në treg në një treg të mbipopulluar. Ka shumë produkte dhe vende që konkurojnë për të tërhequr vëmendjen e udhëtarëve, agjenci udhëtimi dhe botime.


	faqe 35 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

- Kapërcimi i koncepteve të mëparshme dhe perceptimit për Shqipërinë. Kërkimi fillestar tregon për një "mungesë imazhi" ndërmjet turistëve profesionistë. Ka interes për destinacionet e reja dhe gjithashtu interes në rritje për llojin e eksperiencës që Shqipëria ka për të ofruar, por kjo do të kërkojë një përpjekje të koordinuar. Në disa tregje të caktuara që synohen, perceptimet e përgjithshme për Shqipërinë variojnë nga neutrale në negative për shkak të zhvillimeve negative gjatë periudhës së tranzicionit.
- Investimet duhet patjetër të planifikohen në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. I gjithë vendi nuk mund të përfshihet në këtë angazhim me lehtësi. Suksesi në tregjet ndërkombëtare kërkon vijueshmëri në mesazhe dhe prani në tregje vit pas viti. Kjo kërkon investim të kapitalit politik nga qeveria dhe nga sektori privat, publik dhe shoqëria civile. Për më tepër, suksesi kërkon gjithashtu një numër mekanizmesh të reja ose të përshtatura, për të siguruar vijueshmërinë dhe koordinimin, por edhe për të shmangur konfliktin dhe për të siguruar besueshmëri në investimet dhe vendimmarrjen.
- Infrastruktura. Një nga avantazhet e dukshme të turizmit natyror dhe kulturor është se kërkesat për infrastrukturë të specializuar janë minimale. Sidoqoftë, kapacitetet bazë për të lëvizur turistët në mënyrë të sigurtë (në vetura, furgonë, autobuzë dhe aeroplanë) janë një kusht i domosdoshëm. Telekomunikacioni dhe Interneti janë një komponent i rëndësishëm dhe gjithnjë e më i domosdoshëm për promovimin e sektorit të turizmit, komunikimin (nga operatorët dhe zyrat lokale turistike) dhe për vizitorët. Shqipëria përballlet me sfida të rëndësishme në të gjitha këto fusha.
- Koordinimi ndërmjet një numri të madh institucionesh qeveritare. Një sektor i suksesshëm turizmi për Shqipërinë do të kërkojë përpjekje të koordinuara nga një numër ministrish, të pushtetit vendor, instituteve si edhe OJQ-ve, Akademisë së Shkencave, agjencive ndërkombëtare dhe programeve të asistencës dypalëshe.
- Informacioni i përpunuar mbi tregun. Pa një njohje të detajuar të tregjeve të turizmit dhe parashikimit të pritshmërive dhe dëshirave të segmenteve të synuara, Shqipëria rrezikon të humbasë investime të konsiderueshme dhe kohë të çmuar. Vendi do të duhet të investojë për informimin e tregut dhe në njohuritë për të identifikuar mundësitë dhe përshtatur produktet dhe shërbimet.
- Të dhënat e brendshme. Shqipëria do të duhet të bëjë investime të rëndësishme për të grumbulluar të dhënat në vend dhe sistemet e menaxhimit për të monitoruar dhe analizuar vizitat e turistëve, shpenzimet, sjelljet, profilet e turistëve dhe karakteristika të tjera. Planifikimi i turizmit pa këto të dhëna është praktikisht i pamundur dhe burimet e pakta do të humbasin.

Vizioni i mëposhtëm shpreh arritjet e dëshiruara për të ardhmen e turizmit shqiptar. Ai synon që 2013 të jetë viti për të realizuar arritjet e dëshiruara, të cilat do të jenë shprehja e arritjes së objektivave të përcaktuara në strategji.

Vizioni

"Shqipëria është një destinacion turistik i sigurtë, me vlera të larta, që karakterizohet nga një larmi e pasqorë e elementëve natyrorë dhe kulturorë të klasit botëror që tërheqin vëmendjen në

	faqe 36 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

një zonë të vogël gjeografike, e menaxhuar në mënyrë të përgjegjshme mjedisore dhe sociale, lehtësisht e arritshme nga tregjet turistike evropiane."

Strukturimi dhe organizimi i turizmit dhe produkteve të tij përbëjnë prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme. Potenciali i zhvillimit do të arrihet nëpërmjet kombinimit të turizmit për interesa të veçanta dhe biznesit të konferencave për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, duke zhvilluar paralelisht turizmin e "diellit dhe rërës" në përputhje me standartet ndërkombëtare.

Planet e Veprimit janë përshkruar më poshtë:

- Për periudhën afatshkurtër, ndërtimet e paautorizuara duhet patjetër të shihen në raport me ligjin dhe rregulloret përkatëse;
- Përqëndrimi në periudhën afatshkurtër në përmirësimin e produktit ekzistues, të lokalizuar në rasjonet me potencial të madh zhvillimi dhe sidomos rritjen e cilësisë së njësive të akomodimit;
- Përfshirjen e aseteve natyrore dhe kulturore në zhvillimin e turizmit;
- Identifikimi dhe analiza e produktit ekzistues të turizmit dhe promovimi i tij;
- Rishikimi dhe analiza e zhvillimit të zonave turistike deri më sot, përmirësimi i planeve të aprovuara për përdorimin e tokës në zonat turistike, në raport me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, krijimi i peizazheve tërheqëse natyrore dhe kulturore;
- Zhvillimi i elementëve të infrastrukturës, kryesisht menaxhimi i ujërave të zeza dhe i mbetjeve të ngurta inerte;
- Hartimi i planeve për përdorimin e tokës në zonat me një potencial të madh për zhvillimin e turizmit, duke dhënë përparësi zonave me potencial natyror dhe kulturor dhe fshatrave që ofrojnë një potencial për zhvillimin e turizmit rural.

5.1.9 Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Mbrojtjes


Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Mbrojtjes, 2007 – 2013 është aprovuar me VKM nr.763, datë 14.11.2007. Qëllimi kryesor i Strategjisë Sektoriale është të zhvillojë një concept të integruar dhe të udhëheqë zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse me efekte ndërvepruese të përdorimit të të gjithë komponentëve të fuqisë ushtarake të Forcave tona të armatosura.

Objektivi themelor i Forcave të Armatosura është të sigurojnë integritetin, jetën, pronën, dinjitetin dhe mirëqënien e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Në kontekstin e sigurisë kolektive dhe të sistemit tonë të mbrojtjes, objektivi do të përmbushet me angazhimin e plotë të të gjitha instrumenteve, aftësive dhe burimeve kombëtare.

5.1.10 Strategjia e Mbrojtjes Sociale

Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2007 – 2013 është aprovuar me VKM Nr.80, datë 28.01.2008.

Strategjia Sektoriale për Mbrojtjen Sociale, si pjesë e Strategjisë për Përfshirjen Sociale, siguron objektiva konkretë për reduktimin e varfërisë dhe ofrimin e shërbimeve për grupet e pambrojtura në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

	faqe 37 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Qëllimi i Strategjisë Sektoriale për Mbrojtjen Sociale është të ofrojë një politikë të qartë për reformimin e sistemit të pagesave dhe shërbimeve sociale, jo vetëm për grupet e pambrojtura, por për të gjithë shoqërinë.

Në Strategjinë Sektoriale për Mbrojtjen Sociale janë rivlerësuar dhe koordinuar objektivat që janë përcaktuar në dokumente të tjera, si:

- Strategjia Kombëtare për Fëmijët,
- Strategjia për Personat me Paaftësi,
- Strategjia për Komunitetin Roma, dhe
- Strategjia për Barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje.

5.1.11 Strategjia e punësimit


Strategjia e Punësimit, 2007 – 2013 është aprovuar me VKM Nr.751, datë 7.11.2007.

Kjo strategji synon të shërbejë si një instrument për të rritur nivelin e punësimit në të gjithë ekonominë, për të gjithë sektorët në tregun e punës; të mundësojë ndryshimin gradual nga përpjekjet pasive të papunësisë në favor të politikës së punësimit aktiv nëpërmjet krijimit të vendeve të punës. Strategjia përcakton metoda të reja të menaxhimit të biznesit duke i mundësuar atyre të vazhdojnë të përshtaten me ndryshimet ekonomike, globalizimin, konkurrencën, etj, nëpërmjet krijimit të mundësisë për tu përshtatur, sigurisë, reformimit dhe zgjerimit të formave të trajnimit profesional gjatë të gjithë jetës.

Strategjia parashikon përmirësimin e sistemeve të shërbimit të punësimit dhe të trajnimit profesional, që do të arrihet nëpërmjet: *ngritjes së një sistemi modern dhe unik të shërbimeve të punësimit në të gjithë vendin; krijimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve të partneritetit me aktorë të tjerë në tregun e punës; zhvillimit të teknologjisë së informacionit (IT) në shërbimet e punësimit; përmirësimin të kontakteve me sipërmarrjet; zhvillimit të kapaciteteve njerëzore; përmirësimin të bashkëpunimit me shërbimet private të punësimit; krijimit të një sistemi unik dhe cilësor të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), që të jetë në gjendje të kontribuojë në zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale dhe pjesëmarrjes aktive qytetare të të rinjve dhe të rriturve; ofrimit të kurseve kualifikuese profesionale në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, në kuadër të integritimit evropian dhe rajonal.*

Shërbimi i punësimit publik në tregun e punës kryhet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është një shërbim publik autonom, me statusin e një administrate qendrore shtetërore, që raporton tek Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabararta. Autoriteti më i lartë vendimmarrës i Shërbimit Kombëtar i Punësimit është Këshilli Administrativ Trepalësh, me pjesëmarrjen e tre përfaqësuesve nga punëdhënësi, tre përfaqësues nga punëmarrësit dhe shtatë përfaqësues nga shteti.

Objektivi strategjik për periudhën 2007-2013 në fushën e shërbimeve të punësimit është modernizimi i shërbimeve, duke e transformuar vazhdimisht SHKP nga një institucion që ofron shërbime administrative në një institucion që i ofron shërbime dy klientëve të tij kryesorë, të papunëve që kërkojnë punë dhe bizneseve.

	faqe 38 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Shqipëria e ka ratifikuar Konventën nr. 181 të ILO-s për "Agjencitë Private të Punësimit" ku janë përcaktuar aktivitetet që një agjenci private punësimi duhet të kryejë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e klientëve të shërbimeve të tilla.

Objektivat për tregun e punës janë si vijon:

- të rritet bashkëpunimi i tyre me shërbimet publike të punësimit;
- kontroll më rigoroz në fazën e licensimit, duke siguruar që ata që kanë marrë një licensë të jenë të aftë të kryejnë shërbimet e kërkuara;
- në bashkëpunim me projektin "ILO migrant" të krijohet forumi i agjencive private të punësimit, me qëllim që këto agjenci të aprovojnë një kod etike dhe të shkëmbejnë përvojë.

Programet e nxitjes së punësimit u paraqitën për herë të parë në Shqipëri në 1999. Objektivat kryesore të këtyre programeve janë:

- krijimi i vendeve të reja të punës dhe ulja e nivelit të papunësisë;
- trajnimi profesional i të papunëve që kërkojnë punë, sidomos në ato zona ku mungojnë kapacitetet e trajnimit;
- të ndihmohen sipërmarrjet të rrisin aktivitetin e tyre dhe të kryejnë një përzgjedhje më të mirë të fuqisë punëtore;
- inkurajimi i drejtpërdrejtë i punësimit të disa prej të trajnuarve;
- minimizimi i punës së zezë;
- përfshirja në këto programe e të papunëve që kërkojnë punë, të cilët përfitojnë nga skemat e përkrahjes sociale, duke synuar reduktimin e kostove të këtyre programeve;
- nxitja e punësimit të të rinjve dhe grupeve sociale të personave të papunë.

5.1.12 Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimetve


Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017 është aprovuar me VKM Nr. 643, datë 14.9.2011.

Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve mbështetet në alternativën e aprovuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 706, datë 16 tetor 2003. Kjo strategji është një strategji kombëtare dhe ajo ka bashkërenduar politikat sektoriale të zhvillimit për të dyja zonat e banimit: (i) zonat urbane; dhe (ii) zonat rurale.

Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve paraprihet nga një përmbledhje, në të cilën specifikohen vendndodhja e zonave gjeografike, lloji dhe diversiteti i burimeve ujore. Përmbledhja ofron gjithashtu kontekstin social, mbi bazë të të cilit është propozuar kjo strategji, një përshkrim të shkurtër të lëvizjeve të popullsisë, përfshirë tendencën e saj afatmesme dhe standartin e jetesës.

Vizioni

Qeveria e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimeve të domosdoshme të lidhura me të si një prioritet për të nxitur një rritje të qëndrueshme ekonomike, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e nivelit të jetesës në vend.

	faqe 39 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve janë një prej atyre fushave të domosdoshme të shërbimeve publike, të cilat Qeveria e Shqipërisë i ka përcaktuar si prioritetet për shkak të ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë dhe rolit të veçantë që ato luajnë në përmirësimin e kushteve bazë të higjenes, rritjes së standartit të jetesës dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë.


Për të përmbushur vizionin e zhvillimit të këtij sektori jetësor të ekonomisë, mjedisit dhe jetës, Qeveria e Shqipërisë ka identifikuar objektiva kryesorë që janë paraqitur më poshtë:

- Një model i konsoliduar i reformës në këtë sektor, i cili është orientuar nga decentralizimi, ndarja rajonale dhe pjesëmarrja e sektorit privat;
- Përmirësimi i gjëndjes financiare të kompanive që ofrojnë shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe rikuperimi i kostove të drejtpërdrejta funksionale, duke hequr gradualisht në këtë mënyrë subvencionin deri në 2010;
- Zgjerimi gradual i përqindjes së popullsisë që mbulohet me këto shërbime deri në një shkallë, respektivisht 98 % për shërbimin e furnizimit me ujë dhe 80% për shërbimin e kanalizimeve deri në 2015;
- Zgjerimi gradual i mbulimit me shërbimin e trajtimit të ujërave të zeza deri në shkallën 50% të popullsisë deri në 2015;
- Përmirësimi i cilësisë së ujit duke minimizuar deri në masën që është e mundur incidentet e ndotjes në sistem dhe duke siguruar përqindjen e klorit të mbetur në 100% të mostrave deri në 2015;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit duke shtuar numrin e orëve të furnizimit me ujë deri në 24 orë në ditë për zonat urbane dhe gjithashtu një mesatare prej 18 orësh në ditë në shkallë vendi,
- Menaxhimi i sektorit në një mënyrë të tillë që ai të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme, të cilat do të mbulojnë koston totale të shërbimit, duke ofruar një shërbim i cili është i përballueshëm gjithashtu nga shtresat e varfëra deri në 2015.

Qeveria e Shqipërisë ka përdorur një sistem që mbështetet në tre etapa kohore në lidhje me arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare Sektoriale për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, e cila synon të stabilizojë sektorin nëpërmjet një modeli të konsoliduar të reformës, të përmirësimit të shërbimit dhe të arrijë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit.

Qëllimet kryesore për të siguruar arritjen e objektivave janë si vijon: *Rehabilitimi i rrjeteve të vjetra dhe të amortizuara të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve; zgjerimi i këtyre rrjeteve për të siguruar shtrirjen e mbulimit me shërbim; ndërtimin e rrjeteve të reja me qëllim që të mbulohen me shërbim zonat, të cilat kanë interes për zhvillimin ekonomik; dhe zgjerimi i trajtimit të ujërave të zeza.*

Këto qëllime do të udhëheqin në mënyrë të përhershme zhvillimin e sektorit. Krahas kësaj, strategjia identifikon kursin e reformës si qëllim të rëndësishëm të transformimit institucional në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

	faqe 40 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Realizimi i këtyre qëllimeve do të kombinohet me një seri reformash në sektor, të cilat konvergjojnë në tre drejtime kryesore, si vijon:

a) Një reformë teknike, ligjore dhe regullatore dhe një program investimesh deri në 2010:


- Transferimin e pronësisë së infrastrukturës së kompanive të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve tek njësitë e qeverisjes vendore dhe fillimi i një program kombëtar trajnimi me qëllim që të rritet efikasiteti i sektorit.
- Kryerja e investimeve për të përmirësuar/zgjeruar sistemet e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe përmirësimi i cilësisë së ujit.
- Përmirësimi i rikuperimit të kostove dhe reduktimi i humbjeve nëpërmjet veprimeve efikase të operatorëve, në lidhje me, por duke mos u kufizuar në aspektet e mëposhtme:
 - Azhurnimi i niveleve të tarifave dhe përdorimi i tarifave të diferencuara për konsum shumë të madh të ujit;
 - Matja e konsumit të ujit dhe faturimi në bazë të konsumit aktual të ujit të konsumatorit;
 - Prerja e lidhjeve të paligjshme, dhe
 - Përmirësimi i sistemit të faturave dhe mbledhjes së detyrimeve
- Decentralizimi i shërbimit, investimeve, funksionimi dhe kontrolli t'i kalojë pushtetit lokal, me një pushtet lokal të përqëndruar në menaxhimin e burimeve ujore, rregulloret dhe standartet dhe monitorimin e zbatimit të tyre;
- Fillimi i përdorimit të metodave alternative për menaxhimin e kompanive të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si kompani nën administrimin e pushtetit lokal, të cilave iu është ofruar asistencë teknike, kontrata menaxhimi, koncesione dhe inkurajimi i përfshirjes së sektorit privat.

b) Një program reformash, investimesh afatmesme dhe transformimesh deri në 2015, dhe

c) Objektivi afatgjatë i qeverisë për sektorin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve konsiston në shtrirjen në të gjitha zonat urbane dhe rurale të këtyre shërbimeve, të cilat do të jenë efektive dhe në përputhje me standartet evropiane deri në 2020.

5.1.13 Strategjia e Përfshirjes Sociale

Strategjia e Përfshirjes Sociale është aprovuar me VKM Nr. 218, datë 03.02.2008. Kjo Strategji e Përfshirjes Sociale është një komponent i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo përqëndrohet tek varfëria dhe rreziqet e përjashtimit social, të cilat mbeten edhe pas fillimit të rritjes ekonomike. Si një strategji ndërsektoriale ajo është plotësisht në përputhje me strategjitë sektoriale bazë dhe në mënyrë të veçantë me ato politika dhe masa institucionale të përshkruara në këto strategji, të cilat synojnë të ndihmojnë individë, familje dhe grupe të pambrojtura në

	faqe 41 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

komunitet, në mënyrë që ato të jenë në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur, ta sigurojnë vetë jetesën dhe të kenë të drejta të njëjta si anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Vizioni

Çdo fëmijë do të ketë fillimin më të mirë të mundshëm në jetë. Do të ketë mundësi për të punuar për të gjithë ata, të cilët janë të aftë për të punuar dhe ata që nuk janë në gjendje për të punuar do të kenë të ardhura të mjaftueshme për t'i mundësuar një cilësi të denjë jetese. Askush nuk do të përjashtohet ose nuk do të mbetet prapa.

Për të arritur këtë vizion qeveria i ka dhënë përparësinë më të madhe: Sigurimit të mbrojtjes së tregut formal të punës; rritjes së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës; trajtimit të disavantazheve në arsim dhe trajnime, duke i kushtuar rëndësi të veçantë regjistrimeve në shkollat e mesme; modernizimit të asistencës sociale; reduktimit të varfërisë së fëmijëve; përmirësimi i mundësive të grupeve të pambrojtura për të marrë shërbime; të luftohen barrierat për pjesëmarrjen e komunitetit Rom, personave me paaftësi dhe të moshuarve; reduktimi i dhunës në familje;


Politika të veçanta, të përfshira në Strategjinë Sektoriale të Punësimit (e cila nuk është përfunduar ende) duke reflektuar angazhimin për barazi dhe mosdiskrimin në favor të grupeve të varfra, janë:

- Profesionalizimin e shërbimeve të punësimit dhe zbatimin e standarteve ndërkombëtare në trajnimin e aftësive për punë;
- Asistencë e veçantë për trajnimin dhe punësimin e grupeve të varfra,
- Heqja e tarifave të kurseve për grupe të veçanta, të cilat janë përjashtuar nga tregu i punës, pasi ato të jenë regjistruar si të papunë. Këto përfshijnë: personat me paaftësi, adoleshentët e varfër, viktimat e trafikeve, ish-të burgosurit dhe gratë e komunitetit Rom dhe egjiptian.
- Programet e nxitjes së punësimit që synojnë përmirësimin e punësimit të grave, sidomos grave nga komuniteti Rom, grave mbi 35 vjeç, grave të divorcuara me probleme sociale dhe grave me paaftësi. Këto programe funksionojnë nëpërmjet a) subvencioneve të drejtpërdrejta për punëdhënësit b) trajnimi gjatë punës dhe c) heqjes së tarifave për programet e trajnimit profesional.

5.2 Zhvillimi strategjik për planifikimin rajonal të territorit

Planet e zhvillimit rajonal duhet patjetër të përputhen me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim siç është pëshkruar në mënyrë të përmbledhur më sipër. Autoriteteve rajonale i kërkohet të hartojnë planet në përputhje me 20 fushat ku duhet përqëndruar vëmendja për SPI dhe çështjet me rëndësi të veçantë për fushën, të cilat më pas transferohen për aprovim tek qeveria qendrore. Fondet për planet e zhvillimit do të sigurohen nga institucione të ndryshme qeveritare, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare dhe donatorë. Nuk janë përcaktuar afate kohore për dorëzimin e planeve të zhvillimit; sidoqoftë, ato zakonisht koordinohen me proceset politike, siç janë zgjedhjet dhe ndryshimet në udhëheqjen politike.

Dokumentet strategjike bazë në nivel rajonal janë:

	faqe 42 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

1. Strategjia e Zhvillimit Rajonal, e aprovuar me VKM Nr.773, datë 14.11.2007
2. Strategjia e Zhvillimit Rural, e aprovuar me VKM N.775, datë 14.11.2007
3. Strategjia e Decentralizimit, që është duke u hartuar

Në nivel vendor, është përgjegjësi e kryetarit të komunës ose të bashkisë që të bashkëpunojë me drejtuesit e komunitetit për të rënë dakort dhe propozuar një plan zhvillimi për periudhën që është zgjedhur për të mbajtur atë post. Më pas plani i zhvillimit të komunës ose bashkisë i dërgohet zyrës rajonale për aprovim dhe për caktimin e fondeve. Autoritetet rajonale dhe komunale kanë raportuar për probleme në lidhje me zbatimin e planeve të zhvillimit për shkak të mungesës së fondeve dhe nuk është diçka e pazakontë që planet të aprovohen dhe mos të zbatohen kurrë për këtë shkak.

Tabela 5-1 më poshtë paraqet në mënyrë të përmbledhur planet aktuale të zhvillimit në nivel rajonal dhe komunal brenda zonës së studimit. Të dhënat nuk janë bindëse dhe shumë plane zhvillimi duhet të rihartohen në përputhje me ndryshimet në ligjin mbi planifikimin.

Tabela përfshin të dhëna për vendndodhjen e planit, statusin aktual në procesin e aprovimit, nëse plani është në nivel rajonal ose komunal dhe nëse do të kërkohet që plani të ridërgohet në përputhje me Ligjin Nr. 10119, datë 23.03.2010, i ndryshuar.

Për të ndihmuar autoritetet rajonale dhe komunale në zbatimin e ndryshimeve që vijnë si rezultat i ligjit të ri për planifikimin, AKPT ka zhvilluar takime me palët kryesore të interesuara për të diskutuar ligjin e ri, krahas hartimit të një serie me manuale për komunat mbi mënyrën se si duhet të kryhet ky proces.



Autoriteti Planifikimit **Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**
Titulli i Dokumentit: **Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik**

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001,
web: www.mete.gov.al

Tabela 5-1: Planet e Zhvillimit Rajonal dhe Komunal


Rrethi	Vendndodhja	Statusi i aprovimit	Autoriteti përgjegjës	Ligji Nr. 10 119	Komente
Devoll	Komuna Bilisht	I aprovuar	Komuna	Nuk ka ndryshim	Plani i bashkisë përqëndrohet në përmirësimin e tubacioneve të rrjetit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Është planifikuar të fillojë këtë vit. Zona e dytë ku është përqëndruar vëmendja është përmirësimi i rrugëve në qendër të bashkisë dhe jo në zonat rurale.
	Komuna Progër	I planifikuar	Komuna	Nuk ka ndryshim	Planet për përmirësimin e rrugëve, rrjetit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Planet e kanë origjinën në 2007 kur u hartuan, sidoqoftë ato nuk janë aprovuar/publikuar ende.
Korçë	Rruga Korçë-Pogradec	I aprovuar	Rajonal	Nuk është i zbatueshëm (shiko komentet)	Zona përgjatë rrugës Korçë-Pogradec e planifikuar për zhvillim. Ndërtimi ka filluar tashmë përtej fshatrave Bulgarec dhe Ciflik.
	Komuna Drenovë	I planifikuar	Komuna	Nuk ka ndryshim	Do të instalohen tubacionet e rrjetit të ujit të pijshëm nga Turani në Ravonik.
Devoll	Komuna Bilisht	I aprovuar	Komuna	Nuk ka ndryshim	Plani i bashkisë përqëndrohet në përmirësimin e tubacioneve të rrjetit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Është planifikuar të fillojë këtë vit. Zona e dytë ku është përqëndruar vëmendja është përmirësimi i rrugëve në qendër të bashkisë dhe jo në zonat rurale.
	Komuna Progër	I planifikuar	Komuna	Nuk ka ndryshim	Planet për përmirësimin e rrugëve, rrjetit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve. Planet e kanë origjinën në 2007 kur u hartuan, sidoqoftë ato nuk janë aprovuar/publikuar ende.



Autoriteti Planifikimit **Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**
Titulli i Dokumentit: **Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik**

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001,
web: www.mete.gov.al


Rrethi	Vendndodhja	Statusi i aprovimit	Autoriteti përgjegjës	Ligji Nr. 10 119	Komente
Skrapar	Qyteti i Çorovodës	Aprovimi nuk është më i vlefshëm	Rajonal	Ridërguar	Projekt-plani i zhvillimit të qytetit është aprovuar në 1987, Planet nuk janë azhornuar që prej aprovimit fillestar. Nuk është më i vlefshëm për shkak të kohës që ka kaluar që prej aprovimit të pare
Berat	Qyteti i Beratit	Në pritje të aprovimit	Rajonal	Ridërguar	Plani i zhvillimit të qytetit nuk është aprovuar ende.
Fier	Autostrada Lushnje – Fier	Në pritje të verifikimit	Rajonal	Nuk ka ndryshim	Përmirësimi i autostradës ndërmjet Lushnjes dhe Fierit
	Autostrada Lushnje-Fier	Në pritje të aprovimit	Rajonal	Ridërguar	Qeveria vendore i ka dërguar planet tek autoritetet kombëtare për të aprovuar zhvillimin në komunën Mbrostar përgjatë autostradës Lushnje-Fier. Ndërtimi ka filluar tashmë, vetëm se një pjesë e tij është i ligjshëm.
	Zona bregdetare në Fier (Komuna Topojë)	Aprovuar	Rajonal	Ridërguar	Zhvillimi i zonës turistike përgjatë bregdetit ndërmjet lumenjve Vjosë dhe Seman. Qeveria i ka aprovuar planet. Në pritje të sigurimit të fondeve.
	Verri, komuna Mbrostar	Nën studim	Rajonal	Nuk është i zbatueshëm	Është planifikuar zona rajonale për groposjen e plehrave Nuk është e qartë nëse plehrat do të groposen apo do të digjen

	<p>Faqe 45 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>


5.3 Kuadri ligjor kombëtar

Aktet e mëposhtme, që janë në fuqi, përcaktojnë rregullat për procedurën e planifikimit të territorit për projektin:


- Kushtetuta e Shqipërisë
- Kodi Civil; Kodi i Procedurave Administrative, Kodi Rrugor, Kodi Detar;
- Ligji Nr.10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, ka hyrë në fuqi që prej datës 30.09.2011); dhe aktet nënligjore përkatëse:
 - o VKM Nr. 42, datë 16.01.2008, "Kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi";
 - o VKM Nr. 459, datë 16.6.2010 për "Aprovimin e standarteve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS";
 - o VKM Nr. 460, datë 16.6.2010 për "Organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit";
 - o VKM Nr. 481, datë 22.06.2011 "Për aprovimin e rregullores uniforme të instrumenteve të planifikimit";
 - o VKM Nr. 502, datë 13.07.2011 "Për aprovimin e rregullores uniforme për kontrollin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligjet dhe aktet nënligjore në sektorin e energjisë në përgjithsi dhe në sektorin e gazit në veçanti:
 - o Ligji Nr. 9946, datë 30.06,2008, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar;
 - o Ligji Nr. 9072 datë 22.05.2003, "Për sektorin e energjisë" i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse.
 - o Ligji Nr. 7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet"
 - o Ligji Nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportin dhe tregtinë e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;
 - o Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin e minierave në Republikën e Shqipërisë"
- Ligjet dhe aktet nënligjore për çështje themelore kushtetuese dhe administrative, si e drejta e pronës, organizimi dhe funksionimi i autoriteteve vendore, taksat vendore, procedurat administrative, administrimi i tokës, toka e punueshme dhe pyjet, toka në zonat urbane dhe informale, legalizimi i ndërtimeve informale, kompensimi i tokës, etj. si:
 - o Ligji Nr. 750, datë 19. 07. 1991, "Për tokën";
 - o Ligji Nr. 7843, datë 13.07.1994, (i ndryshuar me Ligjin Nr. 8090/1996 dhe 9407/2005) "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme";

	<p>Faqe 46 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

- Ligji Nr. 8318, datë 01.04.1998, "Për dhënien me qira të tokës bujqësore dhe pyjore, kullotave dhe lëndinave që janë pronë shtetërore";
- Ligji Nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik";
- Ligji Nr. 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme shtetërore", i ndryshuar
- Ligji Nr. 8744, datë 22.02.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore";
- Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore";
- Ligji Nr. 7699, datë 21.04.1993, "Për kompensimin në vlerë ose me sheshe ndërtimi të ish-pronarëve të tokave bujqësore, kullotave, livadheve, tokave pyjore dhe pyjeve";
- Ligji Nr. 8337, datë 30.04.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore dhe pyjore, livadheve dhe kullotave," sanksionon të drejtën dhe mënyrën e përfitimit të pyjeve, kullotave dhe livadheve;
- Ligji Nr. 7983, datë 27.07.1995, "Për shitblerjen e tokave bujqësore, kullotave dhe livadheve që janë në pronësi të shtetit";
- Ligji Nr. 8318, datë 1/04/1998, "Për dhënien me qira të tokave bujqësore, kullotave dhe livadheve që janë pronë shtetërore";
- Ligji Nr. 7980, datë 27/07/1995, "Për shitblerjen e trojeve";
- Ligji Nr. 8752, datë 26/03/2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës";
- Ligji Nr. 8312, datë 26.03.1998, "Për tokat bujqësore të pandara";
- Ligji Nr. 8318, datë 01.04.1998, "Për dhënien me qira të tokave bujqësore, pyjore, kullotave dhe livadheve që janë pronë shtetërore";
- Ligji Nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"
- Ligji Nr. 9385, datë 04.05.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor";
- Ligji Nr. 7928, datë 27.04.1995, "Për taksën mbi vlerën e shtuar";
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore";
- Ligji Nr. 8438, datë 28.02.1998, "Për taksën mbi të ardhurat";
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore";
- Ligji Nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare";
- Ligjet dhe aktet nënligjore sektoriale si: për bujqësinë, arsimin dhe shëndetin, pyjet dhe kullotat, administrimin e ujit, torizmin dhe trashëgiminë kulturore, faunën dhe florën, hidrokarburet dhe minierat, emergjencat civile, hidrokarburet, mjedisin, mbrojtjen nga zjarri, ndërtimin dhe strehimin, transportin dhe infrastrukturën, komunikimet elektronike.

	<p>Faqe 47 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

- Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" do të hyjë në fuqi në fund të janarit 2013;
- Ligji Nr. 8934, datë 05.09.2002, "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligji Nr. 9700, datë 26. 03. 2007, "Për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkuftare";
- Ligji Nr. 8990, datë 23.01.2003, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
- Ligji Nr. 8897, datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligji Nr. 8905, datë 06.06.2002, "Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9251, datë 08.07.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë"
- Ligji Nr. 9010, datë 11.02.2003, "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta," i ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11.05.2009";
- Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006, "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme"
- Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura";
- Ligji Nr. 9478, datë 16.02.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II/14 dhe III/7, amendamentet e ESPOO-s Për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në kontekstin ndërkuftar";
- Ligji Nr. 9055, datë 24.04.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për të drejtën e detit të OKB-së";
- Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis";
- Ligji Nr. 10062, datë 29.01.2009, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin "Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit ose flukseve të tyre ndërkuftare" të Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkuftare të ajrit në distancë të largët";
- Ligji Nr. 9548, datë 01.06.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin "Për regjistrat e shkarkimeve dhe transferimit të ndotësve" të Konventës së Aarhus-it "Mbi të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, si dhe të drejtën e tij për t'iu drejtuar gjykatës për problemet mjedisore";
- Ligji Nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore";
- Ligji Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore" i ndryshuar me Ligjin Në. 9592, datë 27.07.2006, Ligjin Nr. 9882, datë 28.02.2008;
- Ligji Nr. 8756, datë 26. 03. 2001, "Për emergjencat civile";
- Ligji Nr. 8766, datë 02.04.2001, "Për mbrojtjen dhe shpëtimin nga zjarri";
- Ligji Nr. 7643 datë 2.12.1992; "Për inspektoriatin sanitar shtetëror";

	<p>Faqe 48 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

- Ligji Nr. 9734, datë 14.05.2007; "Për turizmin";

6 Alternativa e planifikimit të territorit për projektin TAP

6.1 Alternativat e gjurmës në pjesën kontinentale

Shoqëria Trans Adriatik Pipeline AG ndermori një studim fizibiliteti për projektin TAP, për herë të parë në periudhën ndërmjet 2003 dhe 2005, me objektivin për të identifikuar korridorin më të përshtatshëm nga Evropa juglindore për në Itali. Pika e nisjes së projektit TAP në këtë periudhë u identifikua në Selanik të Greqisë si pika më lindore brenda rajonit të Ballkanit. Zona e daljes në det për kalimin e detit Adriatik ishte parashikuar në fillim në veri të qytetit të Vlorës.

Alternativa e parë e gjurmës së projektit TAP u aprovua me Vendimin Nr.1 të KRRTRSH, datë 14.08.2007 "Për aprovimin e gjurmës së projektit TAP në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe linjës së ruajtjes së gazit nëntokë" me kushtet për të shmangur zonat e ndjeshme si Parku Kombëtar "Bredhi Hotovës".

Në këto kushte shoqëria Trans Adriatic Pipeline AG filloi në vitin 2009 një proces të plotë përpunimi të gjurmës me qëllim që të përzgjidhte gjurmën më të favorshme për gazsjellësin në të ardhmen dhe për të shmangur çdo zonë problematike dhe pengesë të mundshme.


Në bazë të konsultimeve fillestare me palët e interesuara gjatë Fazës së Hartimit të Projektit (korrik '06 - prill '07), dalja në det në bregdetin shqiptar të Adriatikut u zhvendos më në veri drejt fushës së Hoxharës, në perëndim të qytetit të Fierit. Si rrjedhim, korridori i gjurmës devijoi nga korridori i parashikuar fillimisht pranë Kalivaçit/Shkozës drejt veriperëndimit, duke ndjekur kryesisht lumin Vjosë. Kjo fazë përfundoi me konfirmimin e korridorit të gjurmës së vlerësuar më parë gjatë fazës së fizibilitetit.

Megjithëse ishte e mundshme nga pikpamja teknike, kjo gjurmë do të kalonte për 27 km përmes Parkut Kombëtar, 7 km përmes zonës së tij qendrore dhe do të kërkonte ndërtimin e 25 km rrugë të reja brenda Parkut Kombëtar. Për më tepër, zona e Parkut Kombëtar të Hotovë-Fir-Dangëllisë u zgjerua në mënyrë të konsiderueshme në 2008.

Duke zbatuar kushtet e vendosura nga qeveria shqiptare (Vendimi Nr.1 datë 14/8/2007 i KRRTRSH), si rrjedhojë e zgjerimit të Parkut Kombëtar Hotovë-Fir-Dangëlli në 2008 dhe duke u mbështetur në praktikën më të mirë ndërkombëtare, projekti TAP e rishqyrtoi gjurmën e tij në vitin 2008 dhe zhvilloi një Vlerësim të Alternativave në periudhën 2009-2010 në përputhje me legjislacionin mjedisor shqiptar. Objektivi i këtij procesi ishte i trefishtë:

- Të identifikoheshin gjurma më të favorshme;
- Të identifikoheshin alternativat dhe masat për të shmangur dhe/ose minimizuar ndikimet mjedisore, socio-ekonomike dhe mbi trashëgiminë kulturore; dhe
- Përfshirja e autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe e popullsisë në përgjithsi.


Gjatë vitit 2009 u identifikuan gjithsej 6 korridore alternative në rajonin e Hotovës. Dy nga gjashtë alternativat ishin projektuar për ta anashkaluar plotësisht Parkun Kombëtar në veri të tij. U identifikua një gjurmë tjetër teknikisht e mundshme, e cila e anashkalonte zonën qendrore të

	Faqe 49 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Parkut Kombëtar, por që sidoqoftë përshkonte Zonat me Përdorim të Qëndrueshëm/Tradicional të Parkut Kombëtar.

Një përmbledhje e alternativave të identifikuar dhe studimeve të kryera nga 2003 në 2009 është paraqitur në *Figura 6-1*, ku vija me ngjyrë të purpurt tregon alternativat e mëparshme dhe vija e verdhë e errët paraqet rastin bazë në 2009.


Figura 6-1: Zona e projektit me alternativat e vlerësuara të gjurmës në periudhën ndërmjet 2003 dhe 2009



Burimi: ERM (2009)

Si rrjedhim, u studiuam 2 prej alternativave të gjurmës të përzgjedhura më parë në lindje dhe në perëndim të rajonit të Hotovës, nga 6 alternativat fillestare, duke e përfunduar vlerësimin për të gjithë seksionin qendror të pjesës kontinentale në Shqipërinë. Alternativat u vlerësuan nëpërmjet një vlerësimi të aspekteve teknike, mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore. Ky aktivitet që përfshiu karakteristikat e të dhënave referuese dhe vlerësimin e alternativave, u zhvillua nëpërmjet një kombinimi të studimeve në zyrë dhe vëzhgimeve në terren, të cilat u kryen në periudhën ndërmjet muajit prill 2009 dhe shkurt 2010.

Një kombinim i ngjashëm i studimeve në zyrë, punës në terren dhe përfshirjes së palëve të interesuara u përdor gjatë 2010 dhe 2011 për të identifikuar, krahasuar dhe përzgjedhur alternativat në seksionin lindor të gjurmës (ndërmjet kufirit grek dhe maleve qendrore) dhe seksionit perëndimor të gjurmës (ndërmjet qytetit të Fierit dhe zonës së daljes në det); 2 *alternativa kryesore u studiuam në seksionin lindor dhe 6 në seksionin perëndimor*. Seksioni 6.2 më poshtë paraqet më në detaje alternativat e gjurmës në seksionin qendror, lindor dhe perëndimor.


	Faqe 50 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

6.2 Përfundimet e vlerësimit të alternativave

6.2.1 Seksioni qendror

Në fund të 2009 u identifikuan 6 alternativa për të kaluar seksionin malor qendror të Shqipërisë. Pjesa qendrore dhe më e vështirë e këtij seksioni qendror është ai që njihet si rajoni i Hotovës. Figura 6-2 më poshtë paraqet vendndodhjen e 6 alternativave në atë rajon dhe pikat më të ndjeshme.

Figura 6-2: Rajoni i Hotovës, korridoret e gjurmëve të vlerësuara dhe seksionet e vështira




Burimi: ERM (2010)

Përmbledhja dhe rezultati përfundimtar i detyrës së ngarkuar ishte një përzgjedhje e 2 prej alternativave për t'u studiuar dhe krahasuar më tej.

Nga 6 alternativat e tjera të përmendura, 4 të renditura më poshtë u refuzuan për arsyet e mëposhtme:

- Alternativa 1 u konsiderua si e pamundur për t'u realizuar nga pikëpamja e ndërtimit, duke qenë se ajo kalon nëpër disa zona ku ka shkarje aktive të tokës;
- Alternativa 2 u konsiderua si e pamundur për të shmangur ndikimet në zonën qendrore të Parkut Kombëtar, duke qenë se ajo do të duhej të ndërtohej pjesërisht përgjatë kufijve të zonës qendrore ku ndërtimi dhe rrugët e reja për të hyrë në zonë do të shkaktonin

	<p>Faqe 51 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

ndryshime të pariparueshme mbi peizazhin e mbrojtur dhe të ndjeshëm dhe habitatet e pyjeve;

- Alternativa 4 synonte të shmangte zonën qendrore dhe të reduktonte ndikimet e përgjithshme mbi Parkun Kombëtar, ndërkohë që shfrytëzonte lidhjen më të drejtpërdrejtë ndërmjet zonave malore shqiptare dhe luginës së Vjosës. Vlerësimi nxorri si përfundim se kjo gjurmë nuk ishte e mundur nga pikpamja teknike, duke qenë se ajo kalonte nëpër disa zona me shkarje aktive të tokës dhe ajo ndjek shtratin e lumit Osum për 8 km; dhe
- Alternativa 5 kishte si objektiv të siguronte një gjurmë krejtësisht jashtë Parkut Kombëtar, por vëzhgimet në terren nxorrën si përfundim se kjo gjurmë nuk ishte e mundur nga pikpamja teknike për shkak të një numri të madh të shkarjeve aktive të tokës dhe nevojës për të ndjekur shtratin e lumit Osum për 8 km.


Si rrjedhim, rezultati i vlerësimit ndërdisiplinor të alternativave çoi në identifikimin e 2 alternativave të gjurmës, të realizueshme nga pikpamja teknike, për të cilat u vlerësuan më tej aspektet kryesore mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore. 2 alternativat (alternativa 6 e gjurmës në veri dhe alternativa 3 e gjurmës në jug) janë paraqitur në *Figura 6-3* më poshtë.

Figura 6-3: Alternativa 3 (në jug) dhe Alternativa 6 (në veri)



Burimi: ERM (2010)

Një përmbledhje e vlerësimit të të dyja alternativave demonstroi se të dyja u konsideruan se ishin të realizueshme nga pikpamja teknike dhe paraqisnin sfida të ngjashme të përgjithshme për ndërtimin. Gjithashtu, nuk u konstatuan ndryshime të konsiderueshme përse i përket sigurisë dhe ndikimeve mbi aspektet socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore. Alternativa 6 u konsiderua se paraqiste më pak sfida përse i përket sfidave mjedisore dhe ndërhyrjes në zonat e planifikuara nga autoritetet. Nga ana tjetër, ndërtimi i Alternativës 3 nuk do të respektonte legjislacionin shqiptar dhe të BE-së për shkak të ndikimeve të tij mbi Parkun Kombëtar Hotovë-

	<p>Faqe 52 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Fir-Dangëlli, duke qenë se ajo kalon përmes Zonave me përdorim të Qëndrueshëm/Tradicional përgjatë 18 km.

Paralelisht me këto studime, në periudhën ndërmjet muajve korrik dhe tetor 2009 u realizua përfshirja e palëve të interesuara për vlerësimin e alternativave. Konsultimi u përqëndrua tek palët që ndikoheshin direkt dhe indirekt, përfshirë komunitetet brenda ose në afërsi të korridorit të gazsjellësit, si dhe autoritetet në nivel vendor, qarku dhe rajonal. Aktivitetet e përfshirjes së palëve u përqëndruan brenda rajonit të Hotovës për shkak të numrit të alternativave të mundshme të gjurmës dhe mungesës së të dhënave kryesore të disponueshme për popullsinë vendase. Studimet socio-ekonomike të pjesëve lindore dhe perëndimore të Seksionin Qendror u planifikuan si një ushtrim në zyrë. Konsultime shtesë u zhvilluan përgjatë gjurmës së Alternativës 6 në seksionin perëndimor, që konsistuan në përfshirjen e autoriteteve në nivel komune dhe qarku.


Gjatë periudhës së përmendur në vitin 2009 u zhvilluan gjithsej konsultime me 4 autoritete rajonale, të 6 qarqeve, 30 komunave dhe 68 fshatrave. Të dhënat dhe mendimet e shprehura nga palët e interesuara gjatë aktiviteteve ku ato morën pjesë, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur më poshtë:

- *Pranimi i projektit:* Shumica e palëve të interesuara që u konsultuan ishin në favor të projektit dhe për synimin për të shmangur ndikimet mbi Parkun Kombëtar. Ata besonin se projekti do të sjellë zhvillim dhe do të rrisë mirëqënien e zonave lokale;
- *Preferencat e gjurmës:* Gjatë konsultimeve në rajonin e Hotovës, të gjithë fshatrat kërkuan që gjurma e projektit të kalojë nëpër tokat e tyre, duke besuar se kjo do të sjellë zhvillim në formën e rrugëve dhe vendeve të punës dhe do të krijojë mundësi të tjera në zonë;
- *Shqetësimet dhe pritshmëritë:* Asnjë prej banorëve vendas, me të cilët u diskutua për projektin, nuk ishte i shqetësuar në lidhje me *mundësinë* e shtrirjes së gazsjellësit përmes tokës së tyre bujqësore, për aq kohë sa kjo shkakton vetëm ndërprerje të përkohshme të aktivitetit të tyre. Ekziston shpresa se projekti do të sigurojë punësim për popullsinë vendase, në mënyrë direkte dhe indirekte nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse; dhe
- *Përmirësimi i rrugëve:* Ndërtimi dhe përmirësimi i rrugëve në zonën e studimit u konsideruan si nevoja kryesore e zhvillimit dhe një rezultat i mundshëm pozitiv i projektit.

Si rezultat i përfundimeve të vlerësimit të alternativave, shoqëria e gazsjellësit TAP vendosi të përdorë Alternativën 6 si gjurmën e rastit bazë për procesin e planifikimit dhe aprovimit të saj të mëtejshëm në Shqipëri.

6.2.2 Seksioni perëndimor

Të dyja alternativat 3 dhe 6 të përshkruara më sipër, bashkoheshin në një pikë të përbashkët në perëndim të qytetit të Fierit. Në perëndim të asaj pike disponoheshin një numër i konsiderueshëm gjurmësh, vendndodhjesh të daljes në det dhe Stacioni i Kompresorëve (CS03) nga një studim fizibiliteti i mëparshëm.

	<p>Faqe 53 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Një pamje e përgjithshme e Alternativës 6 nga fundi i vitit 2010, me alternativat e sektorit perëndimor të paraqitura me ngjyrë të verdhë, është paraqitur në Figura 6-4.

Figura 6-4: Alternativa 6 e gjurmës nga fundi vitit 2010



Burimi: ERM (nga fundi i 2010)

Gjatë fundit të 2010 dhe 2011 u realizua vlerësimi i alternativave duke përdorur një metodologji të përgjithshme të ngjashme me vlerësimin e gjurmës në Seksionin Qendror.

Një veçori e këtij Seksioni Perëndimor ishte vendndodhja e daljes në det dhe lidhja e saj me përzgjedhjen e gjurmës në seksionin detar. Procesi i përzgjedhjes së gjurmës për pjesën kontinentale në Shqipëri duhet të shërbente si nxitësi kryesor për daljen në det dhe si rrjedhim si pikë fillimi për korridorin e seksionit detar.

6 alternativa të gjurmës së gazsjellësit dhe vendndodhje të daljes në det dhe gjashtë vendndodhje të CS03 u identifikuan gjithsej nga pikpamja teknike dhe logjistike. Ato janë paraqitur respektivisht në Figura 6-5: dhe Figura 6-6:.



	<p>Faqe 54 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Figura 6-5: CS03 Vendndodhjet e mundshme



Burimi: ERM (2011)



	Faqe 55 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Figura 6-6: Gjurma e afrimit në breg të detit dhe alternativat e vendndodhjes së daljes në det



Burimi: ERM (2011)

Siç u përmend më përpara, metodologjia e vlerësimit të gjurmës, vendndodhjes së daljes në det dhe SK ishte e ngjashme si koncept me atë që u ndoq për Seksionin Qendror të gazsjellësit. Studimet në zyrë dhe vëzhgimet në terren, si edhe përfshirja e palëve të interesuara u zhvilluan në fillim të vitit 2011, me synimin për të përzgjedhur vendndodhjen më të përshtatshme të gjurmës, zonës së daljes në det dhe CS03. Në lidhje me përfshirjen e palëve të interesuara, seksioni perëndimor u përfshi pjesërisht në ciklet e mëparshme të përfshirjes së palëve të interesuara gjatë 2009 dhe 2010 dhe u plotësua me alternativat e reja gjatë 2011.

Në lidhje me vendndodhjen e stacionit të kompresorëve, nga 6 vendndodhje që u morën në konsideratë, 3 prej tyre ndodheshin në kodrën e Ardenicës për të siguruar kapacitetin dhe stabilitetin e mbajtjes së tokës (CS03 Alternativat 1, 2 dhe 4, shiko Figura 6-5:). Alternativa 3 ndodhet në zonën e sheshtë të fushës lymore të lumit Seman dhe të dyja alternativat 5 dhe 6 ndodhen më afër bregut të detit.

Çështjet kryesore në lidhje me secilën prej alternativave të CS03 janë paraqitur në Tabela 6-1.


	Faqe 56 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al


Tabela 6-1: Çështjet kryesore në lidhje me secilën prej vendndodhjeve të mundshme të CS03

Alternativa	Çështjet mjedisore	Çështjet socio-ekonomike	Çështjet e trashëgimisë kulturore
Alternativa 1	<ul style="list-style-type: none"> Afër rezervuarit të Petovës. Liqen pothuajse natyral eutrofik me vlera të larta si ekosistem Zonë me peizazh me vlera (kodra e Ardenicës) 	<ul style="list-style-type: none"> Afërsia me rezervuarin Afërsia me shtëpitë e veçuara (më pak se 300 m) Përdorimi i tokës bujqësore 	<ul style="list-style-type: none"> Treguesit e kufizimeve të trashëgimisë kulturore në formën e enëve prej balte në sipërfaqe të periudhave romake dhe helenike
Alternativa 2	<ul style="list-style-type: none"> Zonë me peizazh me vlera (kodra e Ardenicës) 	<ul style="list-style-type: none"> Zonë me peizazh me vlera (kodra e Ardenicës) Përdorimi i tokës bujqësore 	<ul style="list-style-type: none"> Treguesit e kufizimeve të trashëgimisë kulturore në formën e enëve prej balte në sipërfaqe të periudhave romake dhe helenike
Alternativa 3	<ul style="list-style-type: none"> 	<ul style="list-style-type: none"> Zonë e sheshtë e fushës lymore Në pronësi private Përdorimi i tokës bujqësore 	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka kufizime të dukshme
Alternativa 4	<ul style="list-style-type: none"> Zonë me peizazh me vlera (kodra e Ardenicës) 	<ul style="list-style-type: none"> Zonë me peizazh me vlera (kodra e Ardenicës) Afërsia me ndërtesa ekzistuese të veçuara Përdorimi i tokës bujqësore 	<ul style="list-style-type: none"> Treguesit e kufizimeve të trashëgimisë kulturore në formën e enëve prej balte në sipërfaqe të periudhave romake dhe helenike
Alternativa 5	<ul style="list-style-type: none"> 	<ul style="list-style-type: none"> Në zonën bregdetare (1 km nga buza e ujit) Ndërrhyrje e mundshme në zhvillimin e turizmit në të ardhmen 	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka kufizime të dukshme
Alternativa 6	<ul style="list-style-type: none"> 	<ul style="list-style-type: none"> Në zonën bregdetare (2 km nga buza e ujit) Ndërrhyrje e mundshme në zhvillimin e turizmit në të ardhmen 	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka kufizime të dukshme

Burimi: ERM (2011)

Si një përmbledhje e krahasimit të alternativave të mundshme të vendndodhjes së CS03 të përmendura më sipër dhe për shkak të aspekteve teknike (gërmimeve shumë të mëdha dhe mungesës së hapësirës), mjedisore (zonë me vlera të larta peizazhi) dhe socio-ekonomike (prodhimet e përhershme), alternativat 1, 2 dhe 4 u hodhën poshtë. Nga 3 alternativat e mbetura, alternative 6 është përzgjedhur kundrejt 5 vetëm mbi bazën e lidhjes së saj me gjurmën e preferuar të afrimit në breg të detit, e cila është përshkruar më poshtë. Alternativa 3 konsiderohet si alternativë zëvendësuese në rast se konstatohet se alternativa 6 është e pamundur për tu realizuar për shkak të kufizimeve gjeoteknike.

Në lidhje me afrimin e alternativave të gjurmës drejt bregdetit dhe vendndodhjeve të daljes në det, procesi i përzgjedhjes së gjurmës në Shqipëri u nxit nga aspekti teknik i fizibilitetit për seksionet në pjesën kontinentale dhe detare si dhe pikën e kalimit më të shkurtër dhe më të

	<p>Faqe 57 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

cekët të detit Adriatik ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, siç shpjegohet më pas në përshkrimin e përzgjedhjes së gjurmës në pjesën detare. Pasi u identifikuar zona përreth Fierit, u krye një përzgjedhje e zonave të përshtatshme të daljes në det duke përdorur kritere nga shumë disiplina, me synimin për të shmangur ndërhyrjet në:

- Zonat e mbrojtura;
- Zonat me vlerë të lartë ekologjike (në pjesën kontinentale dhe detare);
- Zona të njohura të trashëgimisë kulturore;
- Zona me potencial të madh arkeologjik;
- Zonat ushtarake;
- Zonat turistike;
- Zonat e peshkimit;
- Zonat me sediment të njohura të ndotura; dhe
- Fshatrat/qytetet/vendbanimet;

Nga 6 alternativat paraprake të identikuara, përfundimet e studimit në zyrë dhe vëzhgimet në terren të kryera nga ekspertët e Trans Adriatik Pipeline AG gjatë studimit mjedisor në terren (15 dhe 16 shkurt 2011) konkluduan se alternativat e vendndodhjes së daljes në det 6F dhe 6E ndodhen brenda kufijve të zgjeruar të zonës së mbrojtur të lagunës së Karavastasë (zonë Ramsar), dhe si të tilla u hodhën poshtë. Si rrjedhim, vlerësimi mjedisor, socio-ekonomik dhe kulturor u përqëndrua në 4 alternativat e mbetura të vendndodhjes së daljes në det, 6A deri në 6D.

Duhet mbajtur parasysh se këto alternativa të vendndodhjes së daljes në det ndajnë një gjurmë të përbashkët deri në një pikë ku ato ndahen në dy, një që kombinon 6A deri në 6C (alternativat jugore) dhe ajo që quhet 6D (alternativa veriore).

Figura 6-7 më poshtë paraqet katër alternativat e vendndodhjes së daljes në det (të emërtuara LF-6A deri në LF-6D) duke përdorur ngjyrën e kuqe. Vendndodhjet e mundshme 3, 5 dhe 6 të CS03 janë paraqitur gjithashtu me shumëkëndësja me ngjyrë jeshile.



	Faqe 58 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al


Figura 6-7: Pamje nga afër e alternativave 6A deri në 6D të vendndodhjes së daljes në det



Burimi: ERM (2011)

4 alternativat e daljes në det mund të konsiderohen shumë të ngjashme në aspektet mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore, krahas habitateve që ndodhen përgjatë bregdetit (tokave moçalore të kripura, lagunave, pyjeve të pishave mesdhetare dhe në drejtim të rrjedhës së kanaleve kulluese), të cilat janë të përbashkëta për të gjitha alternativat; llojet e tjera të habitateve natyrore janë shumë të rralla, të copëzuara dhe të degraduara dhe territori dominohet nga një larmi e tokës bujqësore. Përsa i përket aspekteve socio-ekonomike, mbizotëron përdorimi i tokës bujqësore dhe planet e zhvillimit për zonën janë përqëndruar në mundësinë për zhvillimin e turizmit në zonën bregdetare. E gjithë zona bregdetare ndërmjet lumit Seman dhe lumit Vjose është parashikuar që të caktohet për zhvillimin e turizmit. Alternativat nuk ndryshojnë as nga çështje të rëndësishme të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe as nga pikpamja teknike-ndërtimore.

Ndryshimi i vetëm i rëndësishëm është që alternativat jugore të daljes në det ndodhen në afërsi të kanalit Roskovec - Hoxharë. Gjatë vëzhgimit në terren u konstatua se kanali Roskovec – Hoxharë është shumë i ndotur me naftë bruto. Ndotja nga nafta bruto e ka origjinën nga fusha e

	<p>Faqe 59 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

naftës e Marinzës që ndodhet afërsisht 25 km larg nga bregu i detit. *Figura 6-8*: paraqet një pamje të kanalit me shenja të dukshme të ndotjes.

Figura 6-8: Kanali Roskovec-Hoxharë i ndotur me naftë bruto



Burimi: Vëzhgimi në terren i ERM-së (2011)


Kjo rrethanë ushtroi ndikimin kryesor për përzgjedhjen e Alternativës 6D të gjurmës së daljes në det dhe Alternativës 6 të CS03 të lidhur me të si rasti aktual bazë.

Në takimet e ndryshme të zhvilluara me autoritetet rajonale dhe komunale dhe me palë të tjera të interesuara në zonën përfundimtare në kuadër të procesit të përzgjedhjes së alternativës nuk u identifikua ose nuk u ngritën shqetësime ose çështje të veçanta, të cilat nuk janë marrë tashmë në konsideratë në vlerësim.

6.2.3 Seksioni Lindor i gjurmës së TAP-it

Gjatë përfundimit të vlerësimit të alternativave në fillim të vitit 2011 u përfshi edhe Seksioni Lindor ndërmjet kufirit grek dhe rajonit qendror malor. Gjatë këtij procesi u zhvilluan tre aktivitete të ndryshme në kohë. Në fillim të 2011 u krye një vlerësim në detaje i alternativës së vetme ekzistuese (Alternativës 6) me gjatësi rreth 30 km, përfshirë një seri tjetër konsultimesh me autoritetet kombëtare dhe rajonale (d.m.th. MMPAU, METE, MPPT, Qarkut të Korçës, rrethit të Devollit (komunat Bilisht Qendër, Hoçisht, Bilisht, etj). Si rezultat i këtyre aktiviteteve u ngritën disa çështje të rëndësishme në lidhje me Seksionin Lindor, të cilat përfshinin të dhëna që ishin identifikuar tashmë në fazat e mëparshme, kryesisht në periudhën ndërmjet 2009 dhe 2011.

Si një përmbledhje e të dhënave që kanë më tepër lidhje për këtë seksion, mund të përmenden të dhënat e mëposhtme:

	<p>Faqe 60 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Mjedisore

- Zona e Moravës në Qarkun e Korçës, pranë kufirit me Greqinë, është përfshirë në rrjetin Emerald⁷ dhe është parashikuar të kthehet në një zonë të mbrojtur, ndoshta e kategorisë V të UNKN, Peizazh i Mbrojtur. Zona e re e mbrojtur do të lidhë Parkun Kombëtar të Drenovës me zonën e mbrojtur të Nikolicës në jug. Arsyet e këtyre klasifikimeve në të ardhmen përfshijnë disa ekosisteme me vlera të larta, pyje të vjetër (Monumente të Natyrës) dhe habitate të mëdha të faunës; të gjitha këto do të ndikohen nga korridori;
- Topografia e zonës nënkupton volume punimesh të konsiderueshme përgjatë kreshtave shumë të ngushta të maleve, me efektet e erozionit dhe të peisazhit që i shoqërojnë.

Socio-ekonomike

- Të dyja vendndodhjet e disponueshme të Stacioneve të Kompresorëve ndodhen relativisht afër qendrave të banuara;
- Zona e Dardhës në malet ku kalon korridori i gazsjellësit është në qendër të vëmendjes për zhvillimin dhe planifikimin e tokës së qarkut, duke qenë se është marrë në konsideratë për potencialin e konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i turizmit ka filluar tashmë në zonë, siç është pista e skive që paraqitet në *Figura 6-9*: më poshtë;


Figura 6-9: Pistë skish në zonën ndërmjet Korçës - Boboshticës - Dardhës



Burimi: Vrojtimi në terren i ERM-së (2011)


- “*Studimi për zhvillimin dhe mbrojtjen e zonës së Dardhës si një zonë prioritare për turizmin*” përcaktoi kufijtë hapësinorë të një zone me potencial për turizmin, e cila është paraqitur në *Figura 6-10*: më poshtë; dhe

⁷ **Rrjeti Emerald** është një rrjet ekologjik për konservimin e florës dhe faunës dhe habitateve të tyre natyrore në Evropë, i cili u krijua në 1998 nga Këshilli i Evropës si pjesë e punës së tij në kuadër të Konventës për Konservimin e jetës së gjallë dhe habitateve natyrore ose Konventës së Bernës që hyri në fuqi në 1 qershor 1982.

	<p>Faqe 61 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

- Pyjet kanë gjithashtu një vlerë të rëndësishme ekonomike në zonën e studimit, megjithëse shfrytëzimi i tyre i pakontrolluar, kryesisht për ngrohje dhe përdorime familjare, i ka dëmtuar rëndë gjatë viteve të kaluara.

Figura 6-10: Zonë me potencial turizmi në Dardhë (Komuna Drenovë)



Burimi: ERM (2011)

Këto rrethana bënë të domosdoshëm identifikimin dhe vlerësimin e një gjurme alternative. Ky identifikim i gjurmës alternative kishte lidhje me një ndryshim të vendndodhjes së pikës së kalimit të kufirit ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë dhe me një ndryshim gjithashtu të një seksioni të veçantë të gjurmës në anën greke. Të dy vlerësimet u kryen pak a shumë në të njëjtën kohë për të siguruar që mos të paraqitej asnjë kufizim i veçantë në njërën anë si rezultat i ndryshimeve në anën tjetër të kufirit.

Pas identifikimit të një alternative të mundshme, që u emertua Alternativa 6A e gjurmës, u krye një vlerësim krahasues i të dyja alternativave duke përdorur të njëjtën metodologji të përshkruar për Seksionet Qendrore dhe Perëndimore. *Figura 6-11*: paraqet të dyja alternativat.



	Faqe 62 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al


Figura 6-11: Alternativat e gjurmës së "Lakut të Korçës"



Burimi: ERM (2011)

Vlerësimi i këtyre alternativave u krye në dy periudha të ndryshme, për shkak të çështjeve logjistike specifike. Në rastin e parë u zhvillua një analizë në zyrë dhe vrojtim në terren në muajin maj 2011, nga i cili u krye një vlerësim paraprak. Në një fazë të mëvonshme gjatë vitit, në shtator, u zhvillua një seri tjetër takimesh për përfshirjen e palëve të interesuara dhe konsultimesh publike, për të konfirmuar ose kundërshtuar konkluzionet dhe të dhënat e mbledhura nga vlerësimi paraprak.

Si rezultat i punës për përmirësimin e gjurmës, në qershor 2011 u vendos që "Laku i Korçës" të përfshihej në rastin bazë.

	<p>Faqe 63 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Rrethanat kryesore të Alternativës 6 të gjurmës janë përshkruar në paragrafët e mëparshëm, por një përmbledhje e çështjeve kryesore jepet më poshtë:

- Korridori i gjurmës nuk kalon nëpër ndonjë zonë të propozuar për tu mbrojtur. Një pjesë e Rezervatit Natyror të Administruar të Cangonjit ndodhet brenda korridorit prej 2 km;
- Gjurma nuk kalon nëpër toka pyjore ose habitate natyrore me interes, përveç rasti të kalimit të madh të ujit. Pjesa më e madhe e gjurmës kalon nëpër tokë të sheshtë bujqësore. Menjëherë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit peizazhi këtu do të kthehet në gjendjen e mëparshme dhe duke qenë se këto peizazhe kanë tashmë një nivel të lartë aktiviteti antropogjenik dhe shpesh kanë karakteristika lineare, vetëm elementë të vegjël, si shenjat e gazsjellësit, do të jenë të dukshme;
- Ekzistojnë 6 zona të trashëgimisë kulturore që shfaqen brenda korridorit prej 500 m të ripërcaktimit të gjurmës në vitin 2011 në Shqipëri, nga të cilat një është zonë potencialisht e rëndësishme. Rreth 90% e zonës brenda korridorit të alternativës konsiderohet se ka një potencial të madh për zona të panjohura arkeologjike;
- Shumica e tokës që përdoret në zonë është tokë bujqësore, nga e cila një përqindje relativisht e konsiderueshme përbëhet nga prodhime të përhershme (kryesisht pemë frutore). Brenda korridorit prej 2 km ekzistojnë 18 vendbanime; dhe
- Vendndodhja e preferuar e Stacionit të Kompresorëve CSO2 ndodhet në një distancë prej më shumë se 1500 m nga vendbanimi i vogël i Vishocicës.


Siç u përmend, metodologjia e përdorur për vlerësimin ishte e njëjtë me ato të përdorura për të gjitha aktivitetet e tjera të përzgjedhjes së gjurmës të kryera deri më sot, duke u përqëndruar në treguesit përkatës. Treguesit e përdorur dhe rezultatet e krahasimit janë paraqitur në *Tabela 6-2* më poshtë.

Tabela 6-2: Treguesit e ndikimit të përdorur për vlerësimin e Alternativës 6A të gjurmës

<i>Treguesi i ndikimit</i>	<i>Njësitë</i>	<i>Rëndësia për vlerësimin</i>
Gjatësia totale dhe sipërfaqja e pastruar (nga ndërtimi i gazsjellësit) brenda Zonave ekzistuese të Mbrojtura	Km/ha (duke konsideruar brezin e punimeve 38 m të gjerë)	Zonat ekzistuese të Mbrojtura sipas përcaktimit ligjor, të cilat preken (përfshirë zonat Emerald) përbëjnë zona me interes të lartë mjedisor (ekologjik, peizazhi, speciet e florës dhe faunës, etj.)
Gjatësia totale dhe sipërfaqja e pastruar (nga ndërtimi i gazsjellësit) brenda biotopeve CORINE	Km/ha (duke konsideruar brezin e punimeve 38 m të gjerë)	Niveli i dytë i përcaktimit përbëhet nga zona me interes të lartë mjedisor (ekologjik, peizazhi, specie e florës dhe faunës, etj.)
Numri i Monumenteve Natyrore brenda korridorit prej 2 km	Numri	Pikat e propozuara që duhen mbrojtur sipas përcaktimit ligjor



Treguesi i ndikimit	Njësitë	Rëndësia për vlerësimin
Zona totale e habitateve natyrore që përshkohet (nga ndërtimi i gazsjellësit)	Ha (duke konsideruar brezin e punimeve 38 m të gjerë)	Habitatet natyrore (siç janë identifikuar në bazën e të dhënave CORINE Land Cover) janë një tregues i vlerës natyrore
Sipërfaqja totale e pyjeve të prera (nga ndërtimi i gazsjellësit)	Ha (duke konsideruar brezin e punimeve 38 m të gjerë)	Është i rëndësishëm vetë si habitat dhe si një tregues i faunës
Numri total i kalimeve të mëdha të lumenjve	Numri	Habitatet e rëndësishme në brigjet e lumit
Heqja e kreshtës	Km	Është shumë e dukshme dhe ka ndryshim të peizazhit (ndikim i përhershëm). Është tregues i gjurmëve përkatëse dhe vendeve të mundshme për hedhjen e mbetjeve dhe vështirësitë për restaurim
Distanca e vendndodhjes së preferuar të CSO2 nga vendbanimet	Km	Ndikimet pamjen dhe zhurmat janë më të larta sa më afër vendbanimeve janë vendndodhjet
Zonë arkeologjike ose zonë/vendndodhje me potencial të madh	1 zonë = 6 pika	Numri i zonave arkeologjike ose i vendndodhjeve me potencial të madh brenda korridorit prej 500 m, ku një zonë është përcaktuar si çdo territor që është i njohur ose shpresohet shumë se ka nën tokë mbetje kulturore antike, vepra arti, themele arkitekturore, ose veçori të dheut (p.sh. varr, vendbanim ose fortifikim i mbuluar me dhe, shesh kampi ose fshat prehistorik)
Zona të rëndësishme arkeologjike	1 zonë = 12 pika	Është i rëndësishëm në këtë kontekst. Means physically substantial that would require considerable time to investigate and/or rescue
Potenciali i përgjithshëm arkeologjik i korridorit	Përqindja (%)	Përqindja e "tokës së kultivuar" (Kodi 211 dhe 223) brenda korridorit 500m e siguruar nga hartat e sistemit CORINE land cover.
Fleksibiliteti arkeologjik	Me cilësi (të lartë, të mesme, të ulët)	Alternativat e ripërcaktimit të gjurmës për shkak të gjetjeve rastësore janë të zakonshme gjatë fazës së ndërtimit. Nëse kufizimet e ndërtimit janë të mëdha për shkak topografisë së ashpër, topografia e sheshtë ofron më shumë mundësi për të krijuar variante të vogla të gjurmës gjatë ndërtimit dhe si rrjedhim, më shumë fleksibilitet për t'iu përgjigjur gjetjeve arkeologjike të rastësishme.
Palët e interesuara në strukturat e qarkut	Numri i qarqeve që përshkohen nga secila alternativë	Popullsia që mund të ndikohet nga projekti
Palët e interesuara të qeverisë vendore	Numri i bashkive që përshkohen nga secila alternativë	Popullsia që mund të ndikohet nga projekti
Popullsia në vendbanimet brenda korridorit prej 2 km	Numri i banorëve	Popullsia që mund të ndikohet nga projekti
Dendësia e popullsisë brenda korridorit prej 2 km	Numri i banorëve/km ²	Popullsia që mund të ndikohet nga projekti
Vendbanimet brenda korridorit të gjurmëve	Numri i vendbanimeve	Popullsia që mund të ndikohet nga projekti
Zonë me toka bujqësore	Ha (brezi i punimeve 38 m i gjerë)	Treguesi i kompensimit të tokës që do të merret


	<p>Faqe 65 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Pas një analize të treguesve të dy alternativave të gjurmë, u nxorrën konkluzionet e mëposhtme:

- Alternativa 6A e gjurmës duket se ka një profil shumë të mirë mjedisor sesa Alternativa 6 e gjurmës, për shkak të ndikimit më të ulët mbi zonat e mbrojtura, florën, faunën, etj.;
- Përdorimi i tokës në secilën prej alternativave është shumë i ndryshëm: Alt 6 është kryesisht me pyje, ndërsa Alt 6A është kryesisht bujqësore. Nga kjo pikpamje, asnjë prej alternativave nuk ka avantazhe të qarta dhe në të dyja rastet ndikimet mund të trajtohen si duhet në parim. Sidoqoftë, ndikimi mbi turizmin i dallon qartë të dyja, duke qenë se Alternativa 6 ndikon mbi turizmin 6A në parim nuk ndikon;
- Alternativa 6A e gjurmës ka një potencial më të madh për zona të pazbuluara sesa Alternativa 6, kryesisht sepse ajo ka një potencial më të madh për zona të groposuara në qiell të hapur nën fushën me depozitime aluviale, të cilat janë më të vështira për tu zbuluar nga vëzhgimi mbi tokë. Nga ana tjetër, duke qenë se janë të zakonshme alternativat e ripërcaktimit të gjurmës për shkak të gjetjeve rastësore gjatë ndërtimit, fleksibiliteti për këto gjurmë që ripërcaktohen është gjithashtu një faktor i rëndësishëm. Nëse kufizimet e ndërtimit janë më të mëdha për shkak të topografisë më të ashpër në Alternativën 6 të gjurmës, gjë që është e vërtetë, atëherë topografia më e sheshtë e kësaj alternative do të ofronte më shumë mundësi për të krijuar variante të vogla të gjurmës gjatë ndërtimit dhe si rrjedhim më shumë fleksibilitet për t'iu përgjigjur gjetjeve rastësore arkeologjike; dhe
- Gjatësia shtesë e Alternativës 6A kompensohet nga kufizime më të pakta ndërtimore që paraqiten në lidhje me Alternativën 6.

Si rezultat i këtyre konkluzioneve, projekti përzgjedhi Alternativën 6A të gjurmës si alternativën e rastit bazë, në varësi të rezultateve të përfshirjes së palëve të interesuara dhe konsultimit publik, i cili u zhvillua në shtator 2011. Ky aktivitet konsistoi në një ushtrim konsultimi gjithëpërfshirës, përfshirë takimet me të gjitha nivelet e autoriteteve dhe publikun në përgjithsi përgjatë gjurmës. Rezultatet e këtyre aktiviteteve nuk kundërshtojnë ndonjë prej konkluzioneve kryesore të vlerësimit paraprak, duke sugjeruar sidoqoftë mënyra që publiku ta pranojë alternativën 6A nëpërmjet ripërcaktimit të pjesëshëm të gjurmës dhe masave të tjera.

Në muajin nëntor 2011 u krye një analizë e re gjurmës së projektit (gjurmës së azhornuar të gazsjellësit, vendndodhjeve të stacioneve të kompresorëve, rrugëve hyrëse që duhen ndërtuar ose përmirësuar, vendndodhjes së shesheve të tubave dhe kampeve të bazës, ndryshimit të kreshtës, kalimeve të lumenjve, etj.) përkundrejt shtresave të ndryshme të sistemit GIS, me qëllim që të identifikoheshin gjetje të reja kryesore të mundshme. Si rezultat i analizës së përmendur, u kryen disa ndryshime të vogla të gjurmës me qëllim për ta përmirësuar atë në maksimum.

	<p>Faqe 66 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Analiza përfshiu:

- (1) Analizën socio-ekonomike në një zonë të kufizimeve prej 60 m (30 m në secilën anë të vijës së mesit) për ndërtesat e veçuara dhe 200 m (100 m në secilën anë të vijës së mesit) për grupet e ndërtesave.
- (2) Analizën e trashëgimisë kulturore në një zonë të kufizimeve prej 50 m (25 m në secilën anë të vijës së mesit)
- (3) Analizën mjedisore në një zonë të kufizimeve prej 500 m (250 m në secilën anë të vijës së mesit), megjithëse është e ndryshueshme në varësi të të dhënave të mbledhura.

Si rezultat i analziës së përmendur, u propozuan disa ndryshime të vogla për të përmirësuar alternativën e përzgjedhur, duke shmangur aspektet ekzistuese të ndjeshme.

Duhet përmendur se vija e mesit e përdorur në të gjithë këtë dokument përbën bazën e vlerësimit të VNMS-së. Deri në muajin nëntor 2011 përshtatjet brenda korridorit prej 500 m u realizuan në kuadër të procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të gjurmës. Pas asaj periudhe, zhvendosja e vijës së mesit u parashikua vetëm për pika të veçanta me rëndësi teknike ose mjedisore, brenda kuadrit të përmirësimit sa më shumë të gjurmës lokale.

6.3 Alternativa e preferuar e gjurmës për projektin TAP

Si rezultat i aktiviteteve të përshkruara më përpara, në datën kur u përpilua ky raport Alternativa 6A e gjurmës (shiko *Figura 6-12*: më poshtë) është konsideruar si rasti bazë për projektin TAP. Siç është përshkruar në nënseksionet e mëparshme të raportit, kjo gjurmë përfshin lakun e Korçës në lindje dhe Alternativën 6D të daljes në det në perëndim. Në hartat e Shtojcave nga 6 deri në 12 jepen detaje mbi çështje tematike për të gjithë korridorin e gjurmës.


	Faqe 67 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Figura 6-12: Alternativa 6A e gjurmës së rastit bazë




Burimi: ERM (2011)

6.4 Alternativat e gjurmës në seksionin detar

Procesi i përzgjedhjes së gjurmës në Shqipëri u nxit nga studimi i kombinuar i fizibilitetit i seksionit tokësor dhe detar. Përsa i përket seksionit detar, faktori kryesor nxitës për përzgjedhjen e gjurmës ishte dëshira për të përcaktuar lidhjen më të shkurtër dhe më të cekët të mundshme ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, me kusht që një gjurmë e tillë të ishte e realizueshme nga të gjitha pikpamjet (teknike, socio-ekonomike, mjedisore, etj).

Lidhja e seksionit tokësor-detar përsa i përket përzgjedhjes së gjurmës në Shqipëri u nxit nga vendndodhja e zonës së daljes në det, e cila duhej të ishte e përshtatshme për të dy seksionet e

	Faqe 68 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

gjurmës, tokësor dhe detar dhe duhej të përshtatej me seksionin detar të gjurmës në anën italiane dhe vendndodhjen e zonës së daljes në det në Itali.

Këto marrëdhënie të ndërlydhura kanë përcaktuar kryerjen e një procesi të përzgjedhjes së gjurmës në det paralelisht me përzgjedhjen e gjurmës në tokë, duke përdorur një metodologji disi të ngjashme, por me më shumë nivele se në seksionin tokësor dhe duke marrë në konsideratë rrethanat e veçanta të mjedisit detar.

Procesi i përzgjedhjes së gjurmës në seksionin detar çoi në identifikimin e tre korridoreve makroskopikë të gjurmës, për lidhjen ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Këto korridore janë paraqitur në *Figura 6-13* më poshtë.


Figura 6-13: Alternativat makroskopike të gjurmës në det



Burimi: ERM (2011)

Në kohën e studimit, të dyja vendndodhjet e daljeve në det në Shqipëri dhe në Itali, si dhe thellësia e përmendur e ujit dhe madhësitë e ndryshueshme të gjatësisë së gjurmës rezultuan në një përzgjedhje kryesore të korridorit verior (me ngjyrë të kuqe në *Figura 6-13*). Zhvillimet e mëvonshme, sidomos në Itali, kanë rezultuar në përzgjedhjen e gjurmës së një rasti bazë, i cili në fakt kombinon me korridorin me ngjyrë të kuqe në Shqipëri, por zhvendoset drejt korridorit qendror me ngjyrë të zezë.

Paralelisht me procesin e përzgjedhjes së vendndodhjes së daljeve në det, procesi i përzgjedhjes së gjurmës në det të hapur (jashtë ujërave territoriale), ose në mesin e ujit të seksionin detar, u krye duke u mbështetur kryesisht në vlerësimin e kufizimeve të tilla si: zonat e mbrojtura;

	<p>Faqe 69 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

habitatet detare me vlera të mëdha ekologjike (p.sh. bari i detit); zonat arkeologjike; zonat ushtarake; zonat e peshkimit; zonat e ankorimit; rreziqet gjeologjike (p.sh. rrëshqitjet e tokës nën fundit e detit); kufizimet e rrëshqitjes së tokës; zonat turistike; instalimet ekzistuese në det (p.sh. platformat, tubacionet, pusët nën fundin e detit, kabllot), krahas faktorëve të thellësisë së ujit dhe madhësisë së ndryshueshme të gjatësisë së gjurmës të përmendura më sipër.

Gjatë këtij procesi secili korridor alternativ u rishikua gjatë një serie studimesh në zyrë dhe vëzhgimesh në terren, gjatë të cilave u identifikuan dhe u vlerësuan kufizimet përgjatë gjurmëve, me informacionin e disponueshëm në atë periudhë, si pjesë e një procesi përsëritës dhe duke i krahasuar me vlerësimin e alternativave të metodave të duhura të projektimit dhe ndërtimit.

Me të gjitha këto madhësi të ndryshueshme, u krijuan disa alternativa potencialisht të realizueshme, që lidhnin zonat e mundshme shqiptare dhe italiane të daljes në det dhe nëpërmjet korridorëve ekzistues dhe karakteristikave gjeofizike të pjerrësive kontinentale.

Në lidhje me anën shqiptare të seksionin detar të gjurmës, ekzistojnë tre alternativa që e kanë origjinën në vendndodhjen aktuale të përzgjedhur të daljes në det, alternativa veriore, qendrore dhe jugore. Në kohën e hartimit të këtij raporti alternativa jugore përbënte rastin bazë të përzgjedhur dhe përzgjedhja u ndikua kryesisht nga vendndodhja e zonës italiane të daljes në det si dhe karakteristikat e njohura gjeofizike të pjerrësive kontinentale shqiptare. Kjo gjurmë e rastit bazë do të konfirmohet dhe përpunohet më tej pas studimit të detajuar të gjurmës, i cili është planifikuar për tu kryer nga fundi i 2012.

7 Analiza makro-ekonomike, sociale, mjedisore, demografike dhe territoriale

7.1 Demografia

Sipas përmbledhjes së paraqitur në Tabela 7-2, u studiuam 69 vendbanime të shtrira në 3 qarqe, 6 rrethe dhe 32 komuna, të cilat ndodheshin pjesërisht ose tërësisht brenda korridorit prej 2 km të zonës së studimit. Një listë me gjithë vendbanimet dhe përmasat e tyre është përfshirë në Tabela 7-1 më poshtë.

Tabela 7-1: Lista e Vendbanimeve brenda Zonës së Studimit Social

Qarku	Rrethi	Komuna / Bashkia	Vendbanimi	Popullsia
Korça	Devoll	Bilisht	Vishocicë	925
			Trestenik	817
			Kuç	517
			Bilisht	9946
		Progër	Cangonj	1329
			Vranisht	1425
	Korça	Progër	Progër	1004
			Mançurisht	N/A
			Ravonik	1025
		Mollaj	Turan	340
			Pulahë	652



Autoriteti Planifikimit **Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**
Titulli i Dokumentit: **Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik**

Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001,
web: www.mete.gov.al

Qarku	Rrethi	Komuna / Bashkia	Vendbanimi	Popullsia
			Floq	N/A
		Projan	Zëmbllak	1772
			Plasë	1764
			Terrovë	368
			Pendavinj	634
		Qendër	Çiflik	1021
			Bulgarec	2534
			Malavec	301
			Shamoll	776
Berat	Skrapar	Bogove	Ustië	142
			Valë	142
		Çorovoda	Çorovoda	8907
		Poliçan	Zgërbonjë	407
		Potom	Backë	425
			Qafë	33
		Qender	Arizaj	345
			Buzuk	361
			Çerenishte	279
			Munushtir	472
			Orizaj	345
			Osoje	261
			Polenë	101
		Vendreshe	Therpel	587
			Vëndreshë e vogël	184
	Berat	Berat	Berat	65,000
			Uznovë	5809
		Cukalat	Vetëm tokë	Vetëm tokë
		Kutalli	Drenovicë	3075
			Kutalli	1447
			Pobrat	1686
			Protoduar	110
			Rërez-kumarak	1183
			Sqepur	608
		Otlak	Moravë	2534
			Otlak	747
			Ullinjas	705
			Çiflik	1550
		Poshnjë	Poshnjë	2450
		Roshnik	Kodras	N/A
		Tërpan	Vetëm tokë	Vetëm tokë
		Ura Vajgurore	Guri i bardhë	30
			Konisbaltë	805
			Ura vajgurore	7915
			Vokopolë	365
		Velabisht	Duhas	1469
			Malinat	726
		Vërtop	Bregas	503
			Fushë peshtan	794
			Mbrakull	1213
			Vërtop	445
			Vodicë	1159
Fier	Fier	Dermenas	Dermenas	1641



Qarku	Rrethi	Komuna / Bashkia	Vendbanimi	Popullsia
			Hamil	779
			Hoxharë	643
			Sulaj	570
		Mbrostar	Kallm i vogël	1256
			Mbrostar ura	3351
			Petovë	1978
			Verri	1035
			Imesht	N/A
		Kurjan	Land Vetëm	1978
		Libofshë	Rreth Libofshë	1870
		Qendër	Mujalli	683
		Roskovec	Vetëm tokë	Vetëm tokë
		Strum	Strum	3000
		Topoje	Fushë	975
			Kavaklli	765
			Seman	948
			Seman i ri	1276
			Topojë	1553
	Lushnjë	Bubullimë	Vajkan	N/A

Burimi: ERM (2011)

Ripërcaktimi i gjurmës së projektit TAP, siç është përshkruar në seksionet e mësipërme, rezultoi në përfshirjen brenda zonës së studimit të 5 vendbanimeve⁸ të reja të cilat nuk ishin studiuar. Secili prej këtyre vendbanimeve ndodhet brenda një komune që ka qenë e përfshirë në zonën e studimit.

Popullsia në vendbanimet e studiara arrin në total 161,159, e cila përbën afërsisht 5% të popullsisë kombëtare sipas vlerësimeve të saj. Është vënë re se 1 nga rrethet (Lushnjë) dhe 7 komuna nuk kanë asnjë vendbanim prej atyre të studiuar brenda korridorit prej 2 km. Këto janë përfshirë në numrin total të rretheve dhe komunave të paraqitur në Tabela 7-2 dhe në analizën e përdorimit të tokës, gjithsesi nuk do të përmenden për raste të tjera.

Tabela 7-2: Vendbanime të Studiara dhe Popullsia Përkatëse brenda zonës së studimit socio-ekonomik

Rrethet	Qarku Korçë		Qarku Berat		Qarku Fier		Total
	Korça	Devolli	Skrapar	Berat	Fier	Lushnje	
Komuna & Bashki	5	2	6	10	5	1	32
Vendbanime të studiara	11(1)	7	15	24(2)	12(3)	0	69
Popullsia	11187	15963	12991	102328	18690	0	161159
Përmasa mesatare e vendbanimit	1017	2280	292*	1623**	1558	N/A	N/A

1 Dy vendbanime shtesë, Mançurisht dhe Floq tashmë brenda zonës së studimit socio-ekonomik si pasojë e ri-përcaktimit¹ të gjurmës së gazsjellësit

2 Vendbanimi shtesë Kodras tashmë brenda zonës së studimit socio-ekonomik si pasojë e ri-përcaktimit të gjurmës


3 Vendbanimet shtesë Imesht dhe Vajkan tashmë brenda zonës së studimit socio-ekonomik si pasojë e ri-përcaktimit të gjurmës

⁸ Mançurisht (Komuna Progër), Korçë; Floq (Komuna Mollaj), Korçë; Kodras (Komuna Roshnik), Berat; Imesht (Komuna Bubullimë) Fier; dhe Vajkan (Komuna Mbrostar), Fier.

*Përjashtuar qytetin Çorovodë, me popullsi 8,907
 ** Përjashtuar qytetin Berat, me popullsi 65,000

Figura 7-1 paraqet një pasqyrë të shpërndarjes së popullsisë përgjatë gjurmës së gazsjellësit.

Figura 7-1: Shpërndarja e Popullsisë përgjatë Gjurmës së Gazsjellësit




Burimi: ERM (2012)

4 qendra të mëdha të popullsisë ndodhen brenda ose shumë pranë (2 km) nga zona e studimit. Çdo qendër është një nyje administrative, punësimi dhe tregtie.

Berat: Qyteti i Beratit është qendra administrative e Qarkut dhe Rrethit të Beratit. Në vitin 2009 popullsia e qytetit vlerësohej në kuotën 71,000 banorë. Berati ka qenë banuar qysh nga shekulli 6 p.e.s dhe pjesa e vjetër e qytetit është klasifikuar si Vend i Trashëgimisë Botërore që prej vitit 2008. Qyteti ka një ekonomi të përzier, ku zonat përreth njihen për prodhimin e verës, ullinjve dhe frutave.

Fier: Qyteti i Fierit ka një popullsi prej afërsisht 85,000 banorë dhe shtrihet 2 km në jug të zonës së studimit. Fieri ishte një qendër e rëndësishme industriale gjatë periudhës komuniste dhe qendra e industrisë së naftës, bitumit dhe asaj kimike në Shqipëri. Gjatë periudhës periudhës

	<p>Faqe 73 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

komuniste Fieri ishte qyteti i dytë në Shqipëri për nga madhësia pas Tiranës, por më pas ka kaluar në vendin e katërt për nga madhësia pas qyteteve Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

Korça: Qyteti i Korçës gjendet në jug-lindje të Shqipërisë dhe ka një popullsi që vlerësohet në shifrat 105,000 banorë. Qyteti ka një universitet i cili specializon në shkencat humane, biznes dhe shkenca. Korça është një qytet i rëndësishëm edhe për Kishën Ortodokse edhe për Myslimanët Sunni, pasi është qendra e Mitropolisë Ortodokse dhe vendndodhja e xhamisë më të vjetër në Shqipëri. Zona përreth njihet për prodhimet bujqësorë dhe është zona kryesore në Shqipëri për prodhimin e grurit.

Çorovodë: Qyteti i Çorovodës ka një popullsi prej mbi 7,000 banorë dhe është qendra kryesore për rrethin e Skraparit. Qyteti përshkohet nga dy lumenj, Çorovoda dhe Osumi.

Jashtë qendrave të mëdha të banuara, vendbanimet e studiuara brenda zonës së studimit variojnë shumë për sa i përket madhësisë dhe popullsisë. Në përgjithësi ky ndryshim vjen si rezultat i faktorëve gjeografikë, përfshirë këtu nëse vendbanimi ndodhet në zonë malore apo fushore, lidhja me rrugë dhe distanca nga qendrat më të mëdha të popullsisë. Për pasojë, shumë nga vendbanimet e vogla në zonën e studimit gjenden në rrethin e Skraparit dhe pjesën lindore të rrethit të Beratit, ndërsa vendbanime më të mëdha në zonat fushore të Korçës, Devollit dhe Fierit.


7.1.1 Migrimi dhe ndryshimi i popullsisë

Gjatë periudhës komuniste, gjithë lëvizjet e brendshme të popullsisë ishin të planifikuara dhe menaxhuara nga qeveria dhe gjithë kufijtë e jashtëm ishin të mbyllur dhe të ruajtur me shumë forca. Shqiptarëve nuk u lejohej të dilnin jashtë shtetit dhe përpjekja për tu larguar konsiderohej si akt tradhtie dhe dënohej nga 10 vite burgim deri në dënim me vdekje.

Në vitin 1990, si pasojë e reformave politike dhe presionit në rritje nga popullsia, kufijtë u hapën dhe, për herë të parë në 45 vite, shqiptarët ishin në gjendje të dilnin jashtë shtetit. Kjo solli për pasojë një eksod masiv të popullsisë drejt Evropës Perëndimore dhe Jugore, SHBA dhe Kanadasë, plus një migracioni të brendshëm në shkallë të lartë nga zonat rurale në ato urbane. Numri i njerëzve që janë larguar nga Shqipëria që nga viti 1990 nuk dihet për shkak të migracioneve të paligjshme. Gjithsesi, vlerësohet se rreth 700,000 deri 1 milion (25%)⁹ e popullsisë është zhvendosur jashtë vendit, përgjithmonë, përkohësisht ose për periudha të caktuara kohe.

Përveç migracionit masiv jashtë kufijve, ka pasur lëvizje të brendshme po kaq të vrullshme nga zonat rurale në ato urbane. Njerëzit janë shpërngulur nga zonat veriore dhe ato malore në kërkim të mundësive më të shumta për punësim në zonat qendrore dhe ato bregdetare. Në vitin 1989 popullsia e qytetit përbënte 35% të popullsisë së përgjithshme. Deri në vitin 2001 kjo shifër është

⁹ Barjarba. K. (2004) Migracioni dhe Etniciteti në Shqipëri: Sinergjitë dhe Ndër-varësitë. Nxjerrë nga: <http://www.watsoninstitute.org/bjwa/archive/11.1/Essays/Barjarba.pdf>

	<p>Faqe 74 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

rritur në 42% dhe vazhdoi të rritet duke arritur në 49% në vitin 2009¹⁰. Tirana është destinacioni për një pjesë të madhe të migracionit të brendshëm dhe midis viteve 1989 dhe 2001 qyteti njohu një rritje të popullsisë me 43% (nga 238,057 në 343,078). Durrësi, qyteti i dytë për nga madhësia, pasuar nga Fieri dhe Elbasani janë gjithashtu destinacione të preferuara.


Qysh nga viti 2008 dhe fillimi i krizës globale ekonomike, fshatrat kanë filluar të përjetojnë një lëvizje në kthim, ndërkohë që njerëzit fillojnë të kthehen në fshatin e tyre të origjinës ose në një qendër të madhe të banuar, si pasojë e përkeqësimit të situatës ekonomike në vendet ku kanë shkuar. Kriza ekonomike ka bërë gjithashtu që disa njerëz të kthehen në Shqipëri për të punuar gjatë verës, dhe kthehen sërish në vendin ku janë vendosur. Në rrethin e Korçës njerëzit kthehen nga Greqia në muajt e verës për të punuar në bujqësi.

Brenda kësaj tabloje të lëvizjeve të popullsisë ka megjithatë disa situata të ndryshme përgjatë zonës së studimit. Që nga viti 2001 popullsia në shumicën e komunave brenda zonës së studimit në Korçë dhe Fier kanë pësuar rritje, ndërsa disa komuna në Berat kanë pësuar pakësim të ndjeshëm të popullsisë (Terpan, në Rrethin e Beratit ka humbur pothuajse gjysmën e popullsisë). Vendbanimet brenda zonës së studimit në Rrethin e Skraparit kanë humbur nga 5 deri 50% të popullsisë. Humbjet më të mëdha të popullsisë vërehen në komuna që ndodhen në zona malore me vendbanime të izoluar ku shkohet me vështirësi (p.sh. Komuna Potom në Rrethin e Skraparit). Një pjesë e kësaj humbjeje të popullsisë i përket migracionit të brendshëm. Familjarët në banesat e studiuara në Skrapar deklarorin një numër më të madh të pjesëtarëve të familjes që jetonin diku tjetër në Shqipëri sesa numri i atyre që jetonin jashtë Shqipërisë (në total 24 persona diku tjetër në Shqipëri dhe 9 jashtë shtetit). E njëjta situatë ishte në Berat (24 persona diku tjetër në Shqipëri dhe 9 jashtë shtetit), ndërkohë që në Devoll më shumë pjesëtarë të familjes jetojnë aktualisht jashtë shtetit sesa diku tjetër në Shqipëri (8 persona diku tjetër në Shqipëri dhe 14 jashtë shtetit). Personat që u përgjigjën gjatë studimit në Fier dhe Korçë (të cilat kanë qendra më të mëdha të banuara si dhe infrastrukturë dhe sistem më të mirë shërbimesh) deklaruan numër të ulët të pjesëtarëve të familjes që jetojnë diku tjetër në Shqipëri ose jashtë shtetit.

Profili i moshave i vendbanimeve të studiuara brenda zonës së studimit është e ngjashme me profilin kombëtar, me grup-moshën më të madhe midis 16 dhe 40 vjeç (30%), pasuar nga 41-60 (29%), nën 15 (21%) dhe mbi 60 (17%).

Janë disa vendbanime të studiuara që përbëjnë përjashtime nga kjo strukturë, si pasojë e numrit të lartë të personave të moshuar. Në fshatrat Sqepur dhe Pobrat (Komuna Kutalli, Rrethi Berat), dhe vendbanimi i izoluar Backë (Komuna Potom, Rrethi Skrapar), banorët e moshuar përbëjnë 30% të popullsisë. Në Rrethin e Korçës, vendbanimet Zemblak, Pendavinj dhe Terrovë (Komuna Pojan) pranë kufirit me Greqinë kanë midis 30 dhe 50% të popullsisë në moshën mbi 60 vjeç, si pasojë e nivelit të lartë të migracionit të përhershëm dhe sezonal.

¹⁰ INSTAT

	<p>Faqe 75 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

7.2 Përdorimi dhe pronësia e tokës brenda gjurmës së projektit TAP


7.2.1 Përdorimi i tokës së përfshirë në projektin TAP

Projekti do të kërkojë zënie e përhershme të tokës për instalimet mbi sipërfaqe, p.sh. stacionet e kompresorëve, stacionet e valvulave të bllokimit, si dhe për rrugët që do të ndërtohen të reja ose ato që do të përmirësohen. Në total toka që do të merret për projektin TAP përbën një sipërfaqe afërsisht 73 ha për instalimet mbi tokë dhe rreth 140 ha për rrugë të reja / të përmirësuara. Kjo zënie e tokës prek kryesisht toka bujqësore (shumica private) dhe pyje (kryesisht publike). Përveç kësaj, do të kërkohen edhe vende për depozitim të gurëve të thërrmuar dhe tepricat nga gërmimet në seksionet malore. Shoqëria Trans Adriatic Pipeline AG do të marrë në mënyrë të përhershme tokën që nevojitet për instalimet mbi sipërfaqen e tokës. Pronarët aktual të tokës do të kompensohen me vlerën e zëvendësimit (vlera e tregut plus kosto të mundshme të trans-aksioneve). Në bazë të marrëveshjeve, pronësia e disa rrugëve të reja që do të ndërtohen mund t'i kalohet administratës publike.

Ndërtimi i gazsjellësit kërkon zënie të përkohshme të tokës në një sipërfaqe totale prej afërsisht 800 ha, e cila është rezultat i brezit të punimeve, sheshet e tubave dhe kampet, etj. Niveli i shpyllëzime që kërkohen gjatë fazës së ndërtimit varion sipas rretheve, por në total 235 ha pyje do të duhet të priten, sipërfaqe e cila përbën 30% të gjithë tokës që do të përdoret brenda brezit të punimeve.

Druri që merret nga këto zona është burimi kryesor i lëndës djegëse për ngrohje dhe gatim përgjatë gjithë zonës së studimit, gjithashtu përbën edhe një burim shtesë të ardhurash për disa familje. Burimet alternative të energjisë janë të kufizuara dhe ndikimi varet nga niveli i shpyllëzimit në një zonë të vetme dhe mundësia për të përdorur zonat e tjera. Për shembull, 108 ha pyje do të priten në Skrapar, por brenda një korridorit prej 200 m në të dy anët e brezit të punimeve shtrihet një sipërfaqe tjetër prej 400 ha pyje, e cila mund të përdoret për mbledhjen e druve të zjarrit.

Pas përfundimit të ndërtimit, do të ndërmerret rikthimi në gjendjen e mëparshme dhe mbjellja e pemëve përgjatë gjurmës së gazsjellësit, në përputhje me Planin e Rimëkëmbjes së Zonës dhe Planin e Menaxhimit të Peisazhit të projektit TAP, i detajuar si pjesë e VNMS në studimin e thelluar. Kjo do të synojë rikthimin e mjedisit në gjendjen e para-ndërtimit sa të jetë e mundur. Situata para ndërtimit do të studiohet dhe do të regjistrohet si bazë referuese për kompensim. Për masat e rimëkëmbjes do të bihet dakord me pronarët / përdoruesit e tokës dhe administratën lokale. Masat e mbrojtjes nga erozioni do të aplikohen siç kërkohen, do të rivendoset në gjendjen e mëparshme kullimi i tokës, dhe do të riparohen sistemet e ujitjes apo rrugë e rrugica të zonës, nëse janë dëmtuar gjatë ndërtimit.

	<p>Faqe 76 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Për të zgjidhur çështjet që lidhen me tokën dhe në veçanti me kompensimin e saj, Trans Adriatic Pipeline AG ka hartuar një Strategji për Blerjen e Tokës dhe Servitutin (LEA) dhe një projekt Plan për Aksesin në Tokë (LAP)¹¹.

Pronarët e tokës do të kompensohen për humbjet dhe dëmet e shkaktuara gjatë ndërtimit. Këtu përfshihen ndër të tjera humbje të strukturave (p.sh. serra), të mbjella të përhershme dhe humbje të prodhimit bujqësor, etj.

Pronësia e tokës përgjatë gjurmës së gazsjellësit nuk do të ndryshojë, gjithsesi toka do të nënshtrohet servitutit, gjë e cila do të kufizojë disa përdorime në të ardhmen nga ana e pronarëve të tokës. Kjo përfshin mbrojtjen e përhershme të brezit të gazsjellësit në një gjerësi 8m, ku nuk do të lejohet mbjellja e pemëve apo bimëve të përhershme me rrënjë të thella, për të mbrojtur paprekshmërinë e gazsjellësit. Afërsisht 100 ha tokë bujqësore do t'i nënshtrohet këtij kufizimi. Punimet bujqësore me të mbjella një-vjeçare do të vazhdojnë pa problem pasi të jetë shtruar tubacioni, pasi mbulesa minimale mbi tubacion do të jetë jo më pak se 1 m. Pemë frutore etj. mund të ri-mbillen në brezin e punimeve gjatë procesit të rimëkëmbjes, por brezi i përhershëm për mbrojtjen e gazsjellësit duhet të ruhet i paprekur. Servituti mbi tokën do të kompensohet nga Trans Adriatic Pipeline AG.


Plus kësaj, përdorimi i tokës do të kufizohet edhe për zonat e sigurisë që do të kërkohen. Nuk do të lejohet ndërtimi i asnjë lloj ndërtese brenda një distance 20 m nga gazsjellësi (zona e sigurisë). Midis distancës 30 dhe 200 m nga gazsjellësi (zona e zgjeruar e sigurisë), do të lejohen vetëm ndërtesa njëkatëshe, ndërsa projektet për ndërtime të planifikuara (të tilla si projekte zhvillimi të hartuara nga bashkitë) janë të kufizuara të mos afrohen më shumë se 200 m nga gazsjellësi. Si pasojë e kryerjes së ndërtimeve kryesisht në formë lineare dhe aktualisht në mënyrë ende të pakontrolluar në shumicën e rasteve, kjo kërkesë për zona të kontrolluara shkakton kufizime faktike në disa raste përgjatë gjurmës, gjë e cila kërkon koordinim të mëtejshëm me bashkitë. Është menduar që kompensimi të mbulojë ndryshimin e vlerës së tokës si pasojë e vendosjes së zonave të sigurisë dhe kufizimeve në përdorimin e tokës që vijnë si rrjedhojë.

Kompensimi për zënien e përhershme apo të përkohshme të tokës do të kryhet sipas legjislacionit shqiptar dhe PR5 të BERZH. Trans Adriatic Pipeline AG do të hartojë një Plan për Blerjen e Tokës dhe Servitutin dhe detajet rreth kompensimit do të komunikohen me pronarët/përdoruesit privat dhe publik, si dhe do të lidhen marrëveshje mbi blerjen e tokës dhe të drejtat e servitutit shumë kohë para se të fillojë ndërtimi.

7.2.1.1 Përdorimi i tokës brenda korridorit 500 m të gjurmës së gazsjellësit TAP

Plani Kombëtar Sektorial për projektin TAP do të sigurojë integrimin siç duhet të zonës së përcaktuar për projektin TAP me gjithë politikat/strategjitë dhe planifikimin territorial Shqiptar në

¹¹ Shoqëria TAP është duke identifikuar aktualisht pronat që ndikohen dhe çmimet përkatëse të tregut, të cilat do të përdoren si referencë për trans-aksionet përkatëse për tokën.

	<p>Faqe 77 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

fuqi. Ai do të ruaj zonën e përcaktuar për projektin TAP derisa të jepet leja e infrastrukturës për gjithë projektin (pra, instalimin e tubacionit, stacioneve të kompresorëve, shesheve për tubat, rrugëve që të çojnë te brezi i punimeve, etj.), të përfundojë ndërtimi i gazsjellësit dhe të aprovohet autorizimi për gazsjellësin dhe objektet plotësuese të tij.

Përderisa projekti është në fazën përfundimtare të projektimit teknik, dhe mund të ndodhin ndryshime të vogla përsa i përket gjurmës dhe/ose rrugëve lidhëse që planifikohen të ndërtohen/përmirësohen nga ana e Trans Adriatic Pipeline AG, Plani Kombëtar Sektorial do të marrë në konsideratë korridorin 500 m për projektin TAP, në mënyrë që të garantohet zbatimi i sigurt i projektit.

Siç është shpjeguar tashmë në seksione të tjera, Trans Adriatic Pipeline AG prej disa vitesh ka kryer shumë vëzhgime dhe studime dhe ka grumbulluar të dhëna për një korridor prej 2000 m. Pasi gjurma e gazsjellësit TAP u përcaktua ndërmjet 6 gjurmëve alternative, janë kryer studime mbi përdorimin e tokës, zhvillimin ekonomik, popullsinë, zhvillimin industrial, zonat e mbrojtura kulturore dhe mjedisore, zonat ushtarake brenda një korridori prej 500 m të projektit TAP.

Për qëllime të PKS për projektin TAP, të gjitha të dhënat e disponueshme janë mbledhur në rrugë institucionale nga ana e Trans Adriatic Pipeline AG, po kështu të gjitha të dhënat e marra nga ministri të ndryshme të linjës, brenda korridorit të gjurmës prej 500 m të gazsjellësit TAP, gjatë procesit të konsultimeve, janë reflektuar brenda këtij dokumenti të PKS.

Më poshtë po paraqesim detajet mbi sipërfaqet e tokës bujqësore, pyje, kullotë, dhe ato urbane brenda një korridori prej 500 m (shih hartën në shtojcën 11).

Toka e pyllëzuar në zonën e studimit është një përzierje e sipërfaqeve në pronësi publike (d.m.th. në pronësi të shtetit, por të menaxhuara nga komuna), sipërfaqe në pronësi private dhe atyre të mbrojtura. Pyjet në pronësi publike përdoren nga banorët e zonës, të cilët paguajnë një tarifë për të mbledhur dru si lëndë djegëse për ngrohje apo qëllime të tjera, ose për ndërtimin e shtëpive. Komuna mund të lëshojë leje për shfrytëzim të lëndës drusore në shkallë më të gjerë nëse personi që aplikon për këtë është në gjendje të paraqesë prova se ka pajiset e duhura, të garantojë dhe të provojë se pylli nuk do të keqpërdoret. Raste të sipërfaqeve pyjore në pronësi private u deklaruan në rrethin e Korçës dhe atë të Devollit në rrëzë të malit Morava. Mbi-shfrytëzimi dhe prerja e paligjshme e pemëve u raportua si problem në sipërfaqet pyjore në pronësi publike dhe ato të mbrojtura përgjatë zonës së studimit, si pasojë e mungesës së burimeve të disponueshme për të trajtuar dhe monitoruar këtë problem.

Sipas ndarjes së tokës në fillim të viteve '90 gjithë toka bujqësore ishte privatizuar dhe çdo familje kishte marrë në pronësi nga 1.5 deri në 5 ha tokë në disa parcela të ndryshme. Brenda zonës së studimit janë disa zona që kanë tokë shumë pjellore, të cilat janë ndarë në shumë parcela të vogla. Kjo është vënë re në zonën e kultivimit të mollëve në komunat Pojan, Progër dhe Bilisht në rrethet e Korçës e Devollit ku parcelat janë afërsisht 400 m të gjata dhe 50 m të gjera.



	<p>Faqe 78 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Tabela 7-3 paraqet zonat kadastrale dhe sipërfaqet përkatëse të tokës bujqësore, pyjore, kullota dhe urbane brenda korridorit prej 500 m të projektit TAP.

Tabela 7-3: Klasifikim i Tokës (Bujqësore, Pyje, Kullota, Urbane) – Korridor prej 500 m

Veçori	Sip. (Ha)	Lloji
Ujë	64.6	
Lan_C_Sipërfaqe bujqësore_792_6000	2852.66	B
Lan_C_Sip. me përdorim të përzier bujqësor_792_6700	1593.18	B
Lan_C_Shkurre_792_5546	1907.51	P
Lan_C_Pyje halore_792_7200	31.68	P
Lan_C_- Korije_792_7400	0	P
Lan_C_Tokë me të mbjella bujqësore_792_6100	1165.93	B
Lan_C_Pyje gjethe- rënës_792_7100	228.55	P
Lan_C_Tokë e zënë me kopshte_792_6300	116.84	U
Lan_C_Kullota_792_6200	62.6	K
Lan_C_Shqopishte_792_6600	0	
Lan_C_Shkurre rrethimesh, kufizimesh_792_9311	6.78	P
Lan_C_Tokë jo-pjellore_792_9500	1337.08	K
Lan_C_Rreshta pemësh_792_7506	50.63	P
Lan_C_Pyje të shumëllojshëm_792_7300	626.78	P
Lan_C_Vende monumentesh, përmendoresh_792_9332	3.92	U
Lan_C_Zonë e hapur_792_2900	0	
Lan_C_Vend për aktivitet me drejtim bujqësor_792_6800	172.1	U
Lan_C_Vend i shfrytëzuar për hedhje mbetjesh_792_3200	4.5	U
Lan_C_Vend i shfrytëzuar për gurore_792_3100	0	
Lan_C_Vend i shfrytëzuar për magazinim_792_3300	0	
Lan_C_Vend për grumbullim të mbetjeve_792_3500	0.38	U
Lan_C_Të mbjella të veçanta_792_6400	1.51	B
Lan_C_Moçalishte_792_8900	0	
Lan_C_Toka djerrë_792_6900	1.38	
Str_C-Ndërtesa_792_9325	22.56	U
Str_C_- Port_792_8300	0	
Str_C_- Terrene Sportive_792_4100	1.12	U
Tra_C_- Aerodrom i shtruar_792_5500	0	
Tra_C_- Aerodrom i pashtuar_792_5500	0	
Tra_C_- Hapësirë e shtruar me material të ngurtë_792_5300	0.11	U
Tra_C_- Rrugë të tjera të pashtuara_792_5452	81.7	B
Tra_C_- Zonë hekurudhore_792_5400	0	
Tra_C_Rrugë të shtruar_792_5100	19.9	U
Tra_C_Rrugë të pa-shtruar_792_5100	25.62	B
Tra_C_Objekte të trafikut detar_792_5600	0	

	Faqe 79 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al


Veçori	Sip. (Ha)	Lloji
Tra_C_Zona qarkullimi të shtruara _792_5000	5.15	U
Tra_C_Zona qarkullimi të pa-shtruara _792_5000	9.73	B
Uti_C_Shtylla tensioni në përgjithësi _792_3459	0.22	B
Total(Ha)	10394.72	

Rezultatet	Sip (Ha)	% e Totalit
B – Bujqësore	5730.55	55%
P – Pyje	2851.93	27%
K –Kullota	1399.68	13%
U – Urbane	346.58	3%

Më shumë se gjysma e Shqipërisë është zonë pyjore dhe malore; vetëm çereku i gjithë tokës mundëson kultivimin e bimëve bujqësore. Zona e studimit kalon nëpër lloje të ndryshme të përdorimit të tokës, duke filluar nga fusha e Devollit pranë kufirit me Greqinë, përmes luginave, mbi male dhe drejt ultësirave para se të arrijë në detin Adriatik. Në rrethet e Korçës dhe Fierit mbizotërojnë sipërfaqet e mbjella me bimë bujqësore sezonale, ndërsa në rrethet Berat dhe Devoll vërehet një kombinim pothuajse e barabartë i sipërfaqeve me të mbjella sezonale me sipërfaqe të mbjella me bimësi të dendur të përhershme. Skrapari bën përjashtim sepse shumica e tokës në këtë rreth janë pyje dhe kullota dhe ka vetëm sipërfaqe të vogla me të mbjella sezonale. Tabela 7-4 më poshtë paraqet përdorimet e ndryshme të tokës vërejtur në secilin rreth dhe vende të rëndësishme të veçantë ose zona me interes.

Tabela 7-4: Përdorimi i Tokës sipas Rretheve

Rrethi	Përdorimi i Tokës	Zonat kryesore të Ndikueshme
Korça	Kryesisht të mbjella sezonale të kombinuara me parcela me bimë të përhershme(mollë). Vendbanimet Turan-Ravonik (Komuna Drenovë) dhe Bulgarec-Çiflik (Komuna Qendër) janë zona rurale, por janë duke u transformuar shumë shpejt në zona gjysmë-urbane. Zona me pyje në malet midis rretheve Korçë dhe Skrapar.	Rruga që lidh Korçën me Pogradecin kalon në jug të vendbanimeve Çiflik dhe Bulgarec. Shumë biznese të vogla janë vendosur përgjatë rrugës. Është përcaktuar një zonë urbane në të dy anët e rrugës dhe është pika kryesore për zhvillimin urban në nivel rajonal. Plantacione të dendura me mollë rrethojnë vendbanimet Zemblak (Komuna Pojan) dhe në pjesën perëndimore të Mollaj (Komuna Mollaj).
Devoll	Përzjerje e të mbjellave sezonale me ato të përhershme. Në pjesën ku rrethi takohet me Korçën (Komuna Progër) toka përbëhet nga pyje malore dhe bimë të përhershme(mollë) në luginë. Përdorim gjysmë-urban i tokës përreth vendbanimeve (Vishocicë, Kuç dhe Vranisht).	Plantacione me mollë me nivel të lartë prodhimi përreth vendbanimit Cangonj (Komuna Progër).
Skrapar	Kryesisht zona pyjore dhe kullota. Sipërfaqe të vogla me të mbjella sezonale përreth çdo vendbanimi dhe në ultësira. Disa sipërfaqe të vogla me të mbjella të	Sipërfaqe të kufizuara me të mbjella sezonale përreth vendbanimeve në Komunën Potom (varësi e madhe nga sipërfaqja e vogël e tokës). Dy aktivitete guroresh në Komunën Vendresh.

	<p>Faqe 80 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Rrethi	Përdorimi i Tokës	Zonat kryesore të Ndikueshme
	<p>përhershme (vreshta rrushi) përgjatë Lumit Osum në Komunën Qendër. Të gjitha vendbanimet janë rurale, përveç Çorovodës, e cila është urbane, dhe Vendresh që ka 2 zona guroresh.</p>	
Berat	<p>Përdorim i shumëllojshëm i tokës. Zonat kodrinore dhe malore të pyllëzuara. Të mbjella të llojeve të ndryshme, të përhershme dhe sezonale in ultësira. Zonë urbane përreth Beratit dhe Uznovës. Aktivitete gurore dhe të nxjerrjes së naftës.</p>	<p>Të mbjella të përhershme me dendësi të lartë (vreshta dhe pemë frutore përreth Beratit dhe komunave Otlak, Poshnje, Velabisht dhe Vertop. Aktivitete gurore në komunën Otlak dhe bashkinë Ura Vajgurore.</p>
Fier	<p>Kryesisht prodhime nga të mbjella sezonale. Sipërfaqe të vogla me të mbjella të përhershme në Petovë (Komuna Mbrostar). Nxjerrje nafte në Komunën Mbrostar Zonë gjysmë-urbane përreth vendbanimeve Kavaklli/Seman (Komuna Topojë). Vendndodhja e daljes në det që shtrihet në një sipërfaqe të përzier pyje dhe moçalishte.</p>	<p>Komplekse të mëdha me serra në vendbanimin Petovë (Komuna Mbrostar dhe Rreth- Libofshë (Komuna Libofshë). Zonë aktive për nxjerrje nafte në Komunën Mbrostar</p>

7.2.2 Pronësia e tokës

Niveli i pronësisë mbi tokën është i lartë përgjatë zonës së studimit dhe nga 80% deri 100% të personave që u përgjigjën gjatë studimit mbi familjet deklaruan se ata kishin në pronësi tokën që përdornin.


U vërejtën probleme lidhur me dokumentacionin e pronësisë mbi tokën dhe titujve të pronësisë mbi tokën përgjatë zonës së studimit. Pronësia mbi tokën u diskutua në 12 takime me grupet e përfshira drejtpërdrejt në këtë aktivitet me pjesëmarrje të fermerëve përveç ngritjes së këtij problemi në takime me komunitetin. Konkluzionet ishin të ndryshme; disa nga personat që u përgjigjën deklaruan se i zotëronin dokumentet e titujve të pronësisë mbi tokën dhe disa të tjerë pothuajse me të njëjtin numër deklaruan se kishin probleme në lidhje me marrjen e dokumentacionit të saktë, veçanërisht në Fier, Berat dhe Skrapar. Ky konkluzion u përforcua me studimin mbi familjet, nga i cili rezultoi se diçka më pak se çereku i personave që u përgjigjën në Berat dhe Skrapar nuk zotërojnë dokumentet e pronësisë mbi tokën.


Kur u pyetën pse njerëzit hasnin vështirësi në marrjen e dokumentacionit të pronësisë çdo person që u përgjigj dha të njëjtën arsye, pavarësisht nga vendndodhja brenda zonës së studimit. Ndërkohë që ata morën një certifikatë përdorimi në fillim të viteve '90, për të marrë dokumentacionin e plotë të pronësisë mbi tokën kërkohen disa pagesa që duhen bërë pranë qeverisjes vendore, të cilat mund të shkojnë deri në mbi 400€. Në Fier u deklaruan raste kur disa persona kishin marrë dokumentet e pronësisë në mënyrë që ta shisnin tokën e tyre dhe kishin zbuluar se dokumenti i pronësisë nuk përkonte me sipërfaqen e tokës që ata mendonin se e zotëronin. Kjo u raportua si një problem dhe si burim konflikti midis fqinjëve.

Gjashtë takime me grupet e përfshira drejtpërdrejt në këtë aktivitet u zhvilluan me fermerë në rrethet Korçë dhe Devoll dhe të gjithë personat që u përgjigjen deklaruan se i kishin dokumentet e pronësisë mbi tokën. Fermerë në Ravonik (Komuna Drenovë, Korçë) deklaruan se gjatë komunizmit toka në atë komunë kishte qenë kooperativë, jo fermë shtetërore, që nënkuptonte se ndarja e tokës kishte kaluar në një proces të ndryshëm. Personat që u përgjigjen theksuan se kooperativat ishin ferma më të mëdha, të menaxhuara në mënyrë të pavarur, jo drejtpërdrejt nga shteti. Në fillim të viteve '90 banorët vendas punuan me qeverinë për të menaxhuar procesin e ndarjes së tokës, si rrjedhojë gjithë banorët i morën dokumentet e pronësisë mbi tokën relativisht shpejt. Tani banorëve u kërkohet që të regjistrojnë dokumentet e tyre çdo vit për arsye të tatimeve, proces i cili kushton, prandaj nuk kryhet siç kërkohet. Fermerët deklaruan se duke menaxhuar procesin në nivel lokal ata kanë shmangur problemet e vërejtura në pjesë të tjera të vendit.

Përveç problemeve që lidhen me dokumentet e titujve të pronësisë mbi tokën, shumë nga familjet e përfshira në studim deklaruan se kishin pasur në pronësi tokë para vitit 1945, e cila u ishte marrë gjatë komunizmit, por nuk u ishte rikthyer në vitet '90. Familjet e përfshira në studim deklaruan se zotëronin ende dokumente në origjinal të pronësisë mbi tokën që para vitit 1945 dhe se ishin përpjekur të rifiton pronësinë mbi gjithë sasinë e tokës që kishin pasur më parë në pronësi, dhe rastet ndryshonin nga njëri – tjetri nëse kishin patur sukses apo jo.

Figura 7-2: Zotërimi i tokës nga familjet e përfshira në studim, para vitit 1945



	<p>Faqe 82 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Numri më i lartë i familjeve të përfshira në studim që deklaruan se kishin patur tokë në pronësi para vitit 1945 u vërejt në Skrapar (68% e familjeve të përfshira në studim) pasuar nga Devolli (50%), Berati (38%), Korça (36%) dhe Fieri (31%). Në Berat, Fier dhe Korçë vetëm 18% e familjeve të përfshira në studim deklaruan se ishin përpjekur të rifitonin pronësinë mbi tokën që zotëronin para vitit 1945. Në Skrapar 55% janë përpjekur të rifitojnë pronësinë mbi tokën dhe 31% pre tyre kanë patur sukses. Në Devoll 26% e familjeve të përfshira në studim janë përpjekur të rifitojnë pronësinë mbi tokën, por asnjë prej tyre nuk ka patur sukses.

U raportua se disa sipërfaqe toke të papërdorura për ndërtim deri tani ndodhen nën një presion të shtuar rreth zonave të populluara, nga e cila dëmtohen të rinjtë, duke mos patur mundësi të kenë hapësirat e tyre të banimit. Shumë të rinj detyrohen të jetojnë me prindërit e tyre ose të emigrojnë, pasi mundësitë e tyre të punësimit janë të kufizuara dhe toka nuk është e mjaftueshme që të mund të ndahet midis motrave dhe vëllezërve.

Në disa komuna u deklaruan raste të marrjes me qera të tokës, ku fermerët po marrin toka me qera nga familjet që kanë emigruar ose banorë të moshuar që e kanë të pamundur të punojnë tokën e tyre. Banorët deklaruan raste kur personat që banojnë në fshatra malor marrin me qera tokë në zona fushore, ku ka më shumë tokë pjellore. Marrëveshjet e qerasë shpesh bëhen me shkrim dhe mund të përfshijnë shkëmbim të vlerave monetare dhe/ose mallrave. Në Korçë u deklaruan raste kur njerëzit ishin shpërngulur në zonën ku kishin marrë tokë me qera dhe plus kësaj duke mbajtur edhe tokën që e zotëronin në fshatin e tyre të origjinës. U raportua se njerëzit ishin tërhequr nga zonat urbane, pasi Korça ka sisteme të mira të furnizimit me ujë dhe tregjeve, si dhe të shërbimeve për familjet.


7.3 Ekonomia, Punësimi dhe të Ardhurat

7.3.1 Vështrim i Përgjithshëm në nivel Kombëtar

Gjatë regjimit komunist sektori privat ishte i shtypur dhe tregtia me jashtë ishte rreptësisht e kontrolluar nga shteti. Shqipëria filloi kalimin e saj drejt një ekonomie tregu në vitin 1991. Me përjashtim të vitit 1997, kur rënia e skemave financiare piramidale shkaktoi një rënie të ekonomisë me afro 10%, Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP) u rrit me mbi 7% çdo vit nga viti 1993 deri 2001. Rritja u ngadalësua midis viteve 2002 dhe 2007, por megjithatë mbeti rreth 5%. Pas një ri-ngritjeje të përkohshme në vitin 2008 në nivelin 7.7%, rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto (GDP) ra në nivelin 3.3% në 2009 dhe 3.5% në 2010¹² si pasojë e krizës globale ekonomike. Shqipëria është ndikuar nga kriza ekonomike edhe direkt edhe indirekt për arsye të varësisë që vendi ka nga dërgesat e parave nga Greqia dhe Italia.

Sektori i shërbimeve, që përfshin transportin, tregtinë, hotelet dhe restorantet, është kontribuesi më i madh në GDP (21.2%). Gjithsesi, ekonomia mbetet e varur shumë nga bujqësia, e cila përbënte një nivel të përllogaritur në 18.5% të GDP (me çmimet aktuale) në vitin 2009. Sektori i


¹² INSTAT

	Faqe 83 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

fermave është mbizotëruar nga aktivitete të vogla private qysh nga rënia e sistemit komunist në 1991, kur fermat kolektive u shpërbënë. Numri i fermave të përmasave të vogla dhe atyre që shërbejnë si mjet jetese mbetet i lartë, veçanërisht në zonat malore dhe vendbanimet e izoluara.

Përsa i përket punësimit, bujqësia mbetet sektori më i rëndësishëm, i cili zë pothuajse 55% të punësimit të përgjithshëm. Sektori publik gjithashtu mbetet një fushë punësimi e rëndësishme përsa i përket numrit të të punësuarve dhe është paraqitur më poshtë në Figurën Figura 7-3 në kategorinë "Shërbime të Tjera".

Figura 7-3: Punësimi sipas Aktivitetit Ekonomik në Shqipëri



Burimi: INSTAT (2009)


Është e vështirë të merren shifra zyrtare të punësimit, si pasojë e nivelit të lartë të aktivitetit privat bujqësor dhe fermave që shërbejnë si mjete jetese. Banorë, që zyrtarisht figurojnë si të papunë, shpesh janë të angazhuar në aktivitete bujqësore që shërbejnë si mjet jetese, për këtë arsye, papunësia shpeshherë regjistrohet vetëm në qendrat urbane. Niveli zyrtar i papunësisë ka pësuar rënie të lehtë në vitet e fundit, nga 14% në vitin 2004 në 13% në vitin 2008, kryesisht si rezultat i shtimit të vendeve të reja të punës në sektorin privat, jo-bujqësor.

Niveli i papunësisë mbizotërohet nga papunësia afat-gjatë, e cila përbën 90% të shifrave totale të papunësisë. (EIU, 2009).

Sipas statistikave kombëtare, të ardhurat mesatare mujore për familje në Shqipëri në vitin 2009 ishin 40,874Lek (294€), që përbën një rritje me 30% nga viti 2006 (28,822Lek (207€))¹³.

Përkatësisht, sipas Bazës së të Dhënave të Bankës Botërore, nivelet e varfërisë¹⁴ në Shqipëri kanë pësuar rënie të ndjeshme, nga 25% në vitin 2002 në 12.4% në vitin 2008¹⁵. Gjithsesi,

¹³ INSTAT 2009

	<p>Faqe 84 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

ekzistojnë mospërputhje të thella midis popullsisë urbane dhe asaj rurale, me nivele të varfërisë në zonat rurale tre herë më të larta se në Tiranë dhe dy herë më të mëdha se në zonat e tjera urbane¹⁶ Të ardhurat mujore zyrtare në zonat urbane janë mesatarisht 100€ më shumë se në zonat rurale, me të ardhura në zonat urbane të regjistruara në 2009 në shifrat 45,053Lek (324€) krahasuar me të ardhurat në zonat rurale në shifrat 31,499Lek (227€).

Pjesët më të varfra në Shqipëri gjenden në zonat malore në veri, pasuar nga disa zona në pjesën qendrore, që përfshin rrethet Berat dhe Skrapar në zonën aktuale të studimit.

Sipas Bankës Botërore, rënia e nivelit të varfërisë në Shqipëri është rezultat i numrit të familjeve që përfitojnë para të dërguara nga jashtë dhe faktit që sasia e këtyre dërgesave ka qenë në ngritje graduale¹⁷.

Gjendja e varfërisë lidhet me madhësinë e familjes, shkallën analfabetizmit, nivelin e ulët të arsimimit dhe papunësinë. Rreziku i varfërisë është më i lartë në radhët e të vet-punësuarve, i cili në vitin 2001 përbënte 89.9% të popullsisë rurale. Përveç kësaj, varfëria në radhët e pjesëtarëve në moshë më të re në familje është në rritje, e cila lidhet me çështje të ndarjes së tokës, siç u përshkrua në Seksionin 7.2 më sipër. Gjendja e varfërisë raportohet se është më e ulët në rastet e familjeve të menaxhuara nga femra, gjë e cila mund të lidhet me struktura të migracionit dhe të ardhura nga dërgesat nga jashtë¹⁸.

7.3.2 Ekonomia dhe mjetet e jetesës në zonën e studimit

Informacione mbi aktivitetet ekonomike siç janë dhënë nga drejtuesit e vendbanimeve në zonën e studimit janë paraqitur në Figurën 7-4 dhe Figurën 7-5 më poshtë:

¹⁴ Niveli i varfërisë i referuar në këto statistika përfshin çdo person që fiton më pak se 4891Lek (€35) në muaj. Shiko <http://www.instat.gov.al/graphics/doc/downloads/New/Living%20Standard%20Measurement%20Survey%202008.pdf>


¹⁵ <http://data.worldbank.org/country/albania?display=graph>

¹⁶ Hoti. E., (2009) Paratë e dërguara nga jashtë dhe varfëria në Shqipëri. Departmenti i Ekonomisë në Universitetin e Lundit

¹⁷ BB (2007)


¹⁸ BB (2007)

Figura 7-4: Aktivitetet Ekonomike në Vendbanimet brenda korridorit të gjurmës së gazsjellësit TAP



Burimi: INSTAT (2009)

Figura 7-5: Aktivitetet Ekonomike në Vendbanimet brenda korridorit të gjurmës së gazsjellësit TAP




Burimi: Studimi i vendbanimeve nga ERM


Siç paraqitet, shumica dërrmuese e vendbanimeve të përfshira në studim deklaruan se bujqësia (prodhimet bujqësore, blegtoaria ose aktivitete bujqësore të disa llojeve) është aktiviteti kryesor në këto vendbanime. Të gjitha vendbanimet e përfshira në studim në rrethet Devoll, Skrapar dhe Fier deklaruan si aktivitet kryesor ekonomik prodhimin nga kultivimi i të mbjellave të ndryshme, po kështu edhe përkatësisht 91% dhe 79% e vendbanimeve të përfshira në studim në rrethet Korçë dhe Berat. Pjesa tjetër, përkatësisht 9% dhe 21% e vendbanimeve të përfshira në studim në Korçë dhe Berat deklaruan se kishin një ekonomi të përzier, me aktivitete që përfshinin punimet me gurë, tekstile, ndërtim dhe përpunim ushqimor. Të gjitha vendbanimet e përfshira në studim me ekonomi të përzier kanë një qendër të madhe të banuar (Berat dhe Uznovë) ose ndodhen pranë një qendre të madhe të banuar (Kutalli në Berat dhe Çiflik në Korçë). Ura Vajguore (Bashkia Ura Vajguore) është një vendbanim i madh i pozicionuar pranë guroveve me gurë gëlqeror dhe është i vetmi vendbanim me një aktivitet të vetëm ekonomik (shfrytëzimi i gurit). Qyteti i Beratit dhe Ura Vajguore, janë të vetmit vendbanime ku vërehet se banorët nuk janë të përfshirë në asnjë proces të prodhimeve bujqësore.

Burimet e të ardhurave për familjet e përfshira në studim paraqiten në Figura 7-6, e cila ilustron rëndësinë e vetëpunësimit, mbizotërues në bujqësi, si burim kryesor i të ardhurave. Për sa i përket punësimit me rrogë, është një numër i vogël banorësh që punojnë për shtetin në çdo komunë (afërsisht 5-10 të punësuar), dhe disa njerëz që punojnë në kafene, dyqane ose industri të lehtë (furra ose baxho bulmeti). Pjesëmarrja që raportohet në punësimin me rrogë varion sipas rretheve. Skrapari ka raportin më të madh të familjeve të përfshira në studim që përfitojnë të ardhura nga punësimi me rrogë. (29%), pasuar nga Berati (25%), Korça (21%), Devolli (18%) dhe në fund Fieri (12%).

Figura 7-6: Burimet e të ardhurave të familjeve (% e kontributit të secilit burim) sipas rretheve



Burimi: Studimi i familjeve nga ERM

	<p>Faqe 87 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Niveli i të ardhurave nga burimet e ndryshme të përmendura më sipër variojnë sipas rretheve, ku vërehet një numër i lartë i personave që u përgjigjën të cilët deklarorin të ardhura të ulëta siç paraqitet në Figura 7-7. Megjithëse vërehet se niveli i raportuar i të ardhurave mund të ketë një shkallë të lartë pasaktësie si pasojë e ndjeshmërisë që paraqesin pyetjet në lidhje me të ardhurat dhe praninë në shkallë të lartë të fermave që përdoren si mjete jetese, rezultatet përpunohen me tablonë që del nga studimi socio-ekonomik, i cili lidh nivelet e të ardhurave me llojin e produktit bujqësor, praninë e infrastrukturës dhe rrugëve lidhëse me tregjet, si më poshtë:


Shumica e familjeve të përfshira në studim në rrethet Korçë dhe Devoll (60%) deklaruan të ardhura midis 20,000 dhe 50,000 Lek (140€-350€), me pjesën tjetër të popullsisë të ndarë midis atyre me të ardhura në kategorinë e pagave të ulëta (më pak se 20,000 Lek) dhe atyre me të ardhura në kategorinë e pagave të larta (më shumë se 50,000 Lek). Brenda zonës së studimit, këto dy rrethe kanë numrin më të vogël të personave me të ardhura në kategorinë e pagave të ulëta dhe raportin më të madh të personave me të ardhura në kategorinë e pagave të larta.

Berati ka një përzjerje më të madhe të niveleve të të ardhurave, me 26% të familjeve të përfshira në studim të cilat deklarorin të ardhura më pak se 10,000 Lek (70€) në muaj, 23% që deklarorin të ardhura midis 10,000 dhe 20,000 Lek (70€ - 140€) në muaj) dhe 42% që fitojnë midis 20,000 dhe 50,000 Lek (140€-350€).

Familjet e përfshira në studim në Fier gjithashtu deklarorin se kishin nivele të ndryshme të ardhurash, me 31% të cilët deklarorin të ardhura më pak se 10,000 Lek (€70) në muaj, 24% të cilët deklarorin të ardhura midis 10,000 dhe 20,000 Lek (70€-140€) në muaj) dhe 40% që fitojnë midis 20,000 dhe 50,000 Lek (140€-350€).

Familjet e përfshira në studim në Skrapar deklarorin nivele të ulëta të të ardhurave, me 33% të familjeve të përfshira në studim të cilat deklarorin të ardhura më pak se 10,000 Lek (70€) në muaj, 15% deklarorin të ardhura midis 10,000 dhe 20,000 Lek (70€-140€) dhe 21% e familjeve të përfshira në studim deklarorin të ardhura midis 20,000 dhe 30,000 Lek (140€-210€ në muaj. Vetëm 25% e familjeve të përfshira në studim deklarorin të ardhura midis 20,000 dhe 50,000 Lek (140€-350€).

Figura 7-7: Totali i të ardhurave të familjeve që përfshin korridori i gazsjellësit TAP (‘000 Lek)*




*1 EUR = 142.302 Lek

Burimi: Studimi i familjeve nga ERM

Varfëria në zonën e studimit është e vështirë të matet pasi shumica e popullsisë është rurale, me nivele të larta të pronësisë mbi tokën dhe mbështetje të fermat si mjet jetese. Studimi i familjeve synoi të trajtonte këto çështje duke bërë pyetjen “a ka përjetuar dikush në familjen tuaj uri?” Në Fier 4% e personave që u përgjigjën theksuan se kishin provuar uri gjatë vitit të fundit, dhe në Berat dhe Skrapar ky numër binte në 1%. Në Korçë dhe Devoll të gjithë personat iu përgjigjën me jo kësaj pyetjeje.

Nuk disponoheshin të dhëna zyrtare mbi punësimin në zonën e studimit. Gjithsesi, studimi i familjeve ofron mundësi për të kuptuar nivelet e punësimit dhe burimet e ndryshme të jetesës. Figura 7-8 më poshtë paraqet punën që kanë raportuar se bëjnë kryefamiljarët e familjeve të përfshira në studim. Shumica e personave që u përgjigjën deklaruan se ishin të angazhuar me lloje të ndryshme të punëve në fermë (të mbjella sezonale, bimë shumëvjeçare dhe blegtori) si punësim i tyre kryesor; gjithsesi, kishte një numër të madh të personave që u përgjigjën të cilët ishin pensionistë, veçanërisht në rrethet Devoll (30%) dhe Skrapar (24%). Punësimi me rrogë jashtë aktivitetit në ferma është në nivele të ulëta duke patur si aktivitete kryesore tregtinë/shitjen në treg, transport/shofer, punëtor ndërtimi dhe më pas mësues. Numri i kryefamiljarëve që deklaruan që janë të papunë varion nga 5% në Devoll deri në 13% në Berat, nivel që përkon me nivelet e papunësisë në shkallë kombëtare.

Figura 7-8: Punësimi i kryefamiljarëve brenda korridorit të gjurmës së gazsjellësit TAP




Burimi: Studimi i Familjeve nga ERM

Mungesa e mundësive për punësim u deklarua gjerësisht si një problem për brezin më të ri brenda zonës së studimit, një faktor i cili shtyn njerëzit drejt migracionit. Kjo raportohej si ndikim më shumë te brezi i ri për shkak se disponojnë më pak tokë. Kjo lidhet jo vetëm me sasinë e pakët të tokës në shitje, por edhe me ngastrat e vogla të tokës që duhet të ndahen ndërmjet motrave dhe vëllezërve si dhe mungesën e dokumenteve të pronësisë mbi tokën gjë e cila kufizon shitjen e tokës.

7.3.3 Prodhimi Bujqësor

Gama e aktiviteteve bujqësore siç deklarohen në studimin e familjeve të kryer sipas vendbanimeve që ndodhen brenda zonës së studimit socio-ekonomik paraqiten në Figura 7-9 më poshtë.

Figura 7-9: Aktivitetet bujqësore që kryhen prej familjeve brenda korridorit të gazsjellësit TAP (sipas rretheve)




Burimi: Studimi i Familjeve nga ERM

Shitja dhe përpunimi i bulmetit është një aktivitet kyç ekonomik për vendbanimet e studiuara dhe ka të paktën një fabrikë bulmeti në çdo komunë. Qumështi ose u shitet direkt fabrikave të qumështit/baxhove për përpunim dhe prodhim djathi, ose shitet derë më derë nga vetë fermerët. Banorët deklaruan se shumica e familjeve mbajnë të paktën 1 lopë dhe disa dele për konsum familjar, edhe në rastet kur nuk bazohen te mbajtja e bagëtive për qëllime ekonomike. Secili pjesëtar i familjes ka një rol të ndryshëm në lidhje me mbajtjen e bagëtive. Gratë kanë përgjegjësi për ushqimin dhe mjeljen e tyre, fëmijët për t'i ushqyer dhe për t'i çuar në objektet ku i strehojnë, pas shkollë dhe gjatë pushimeve, ndërsa burrat kanë përgjegjësi për shitjen e produktit.

Gruri është gjithashtu një bimë të cilën e mbjellin shumica e familjeve, ose për ta shitur, ose për ta përdorur në shtëpi për të bërë bukë, po kështu edhe misri i cili përdoret si ushqim për bagëtitë.

Përveç prodhimeve bazë bujqësore që u vërejtën se kultivohen përgjatë zonës së studimit, ka disa zona specifike përgjatë gjurmës së planifikuar të gazsjellësit, të cilat kanë si specialitet prodhime të caktuara. Këtu përfshihen:

- Prodhimi i mollës dhe frutave të tjera të buta në rrethet Korçë dhe Devoll;
- Prodhimi i ullirit në rrethin Berat; dhe
- Perimet e rritura në sera në përdorim të qytetit të Beratit dhe në rrethin Fier;

	<p>Faqe 91 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

7.3.3.1 Prodhimi i frutave në Korçë dhe Devoll

Prodhimi i frutave në Korçë dhe Devoll: Rrethet e Korçës dhe Devollit janë të njohura në gjithë Shqipërinë për prodhimin e mollëve dhe frutave të tjera të buta, të tilla si kumbulla. Vendbanimet Bilisht (Komuna Bilisht), Cangonj dhe Vranisht (Komuna Progër), Zëmlak dhe Plasë (Komuna Pojan) dhe Mollaj, të gjitha bazohen te prodhimi i mollës. Emri i komunës dhe fshatit Mollaj e kanë marrë emrin pikërisht nga fjala 'mollë'.

Kur toka u nda në vitet '90 fermerët e shtuan sasinë e parave të investuara në prodhimin e mollës duke ndërtuar komplekse me sisteme ujitjeje me tuba plastikë, duke blerë makineri dhe duke përdorur pesticide dhe insekticide. Investimi i parë në një parcelë me sipërfaqe 1 hektarë u raportua nga fermerët në Cangonj (Komuna Progër), e cila kishte kushtuar 17,000€, ku secila familje kishte investuar midis 4,000€ dhe 5,000€ vetëm për sistemin e ujitjes. Kostot e investimeve janë të larta, megjithatë fermerët deklaruan se prisnin nga ky investim një xhiro vjetore prej 25,000€. U raportua në takimet me grupet e përfshira drejtpërdrejt në këtë aktivitet se familjet kanë mundur të investojnë të tilla shuma të mëdha parash falë parave të ardhura si dërgesa nga pjesëtarët e familjes që punojnë jashtë shtetit.

Pemët e mollës janë prodhuese gjatë gjithë vitit, por periudhën më intensive të punës e kanë nga tetori në janar. Fermerët deklaruan se frutat grumbullohen nga një ndërmjetës i cili më pas e shet prodhimin brenda Shqipërisë dhe jashtë saj.


Qeveria ka ngritur një skenë subvencionimi për të inkurajuar fermerët të mbjellin më shumë mollë në Devoll. Fermerëve u kërkohet t'i drejtohen me shkrim Ministrisë së Bujqësisë, ku të theksojnë se synojnë të blejnë më shumë se 200 fidanë mollë. Pasi dorëzohet dokumentacioni, fermerët mund të blejnë fidanët e mollës dhe të kërkojnë nga qeveria rimbursim të plotë të parave.

7.3.3.2 Prodhimi i ullirit në Berat

Prodhimi i ullirit në Berat: Ullinjët janë prodhuar në Berat për mijëra vite. Në fund të periudhës së komunizmit numëroheshin 5.9 milion rrënjë ulliri të mbjella në një sipërfaqe prej 45,000 ha. Ky numër ra në 3.9 milion rrënjë në 1996 pas një periudhe trazirash, megjithatë që prej asaj kohe numri i fidanëve të mbjellë ka ardhur në rritje pasi janë mbjellë mesatarisht 160,000 ullinj çdo vit nga viti 2000 deri në 2006. Ky sektor mbizotërohet nga ullishte me sipërfaqe të vogla në pronësi të familjeve, dhe në total ka 180 prodhues në të gjithë vendin. Pjesa më e madhe e ullinjve (80%) përdoret për prodhimin e vajit të ullirit dhe pjesa tjetër përdoret si ullinj tavoline (20%), të cilët ruhen në kripë/konservohen¹⁹.

Berati është një zonë e rëndësishme e kultivimit të ullirit dhe varieteti "Kokërrmadh i Beratit" e ka marrë këtë emër sipas vendit ku prodhohet dhe ai përbën 20% të të gjithë sasisë së ullinjve të kultivuar. Në 2008, Berati zinte 22% të tregut të ullirit në Shqipëri dhe kishte si specialitet


¹⁹ Bujqësor K. (2011) Ulliri dhe vaji i ullirit në Shqipëri. (Online) Gjetet në faqen: <http://keshilluesibujqesor.al/?p=1788> (Klikuar më 15 Shtator 2011)

	Faqe 92 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

prodhimin e ullinjve të tavolinës. Në takimet me grupet e përfshira drejtpërdrejt në këtë aktivitet me kultivuesit e ullirit në Berat u theksua se ky ishte një prodhim i rëndësishëm për fshatrat e rrethit të Beratit. Pemëve të ullirit u duhen 5 vite për të hyrë në prodhim dhe 5 vite të tjera (në total 10 vite) që pemët të arrijnë prodhimin e plotë. Sasia e prodhimit ndryshon nga viti në vit. Secila familje zotëron sipërfaqe të ndryshme toke të mbjella me ullinj dhe nëse është e nevojshme familjet ndihmojnë njëra – tjetrën për të vjelë prodhimin²⁰.


Figura 7-10 paraqet ullishtat nëpër të cilat kalon gjurma e gazsjellësit pranë vendbanimit Otlak në rrethin e Beratit.

Figura 7-10: Pamje satelitore të ullishtave në Otlak, rrethi Berat (gazsjellësi me të verdhë)



Burimi: VHR Orthomosaics ofruar nga Astrium

²⁰ Leonetti L. et al. (2009) Ullinjët dhe zinxhiri i vlerës së vajit të ullirit në Shqipëri, përgatitur në emër të Development Solutions Associates. (Online) Gjendet në faqen: <http://www.eastagri.org/files/Oil-Albania.pdf> (Klikuar më 15 Shtator 2011)

	<p>Faqe 93 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

7.3.3.3 Prodhimi i perimeve në Berat dhe Fier

Prodhimi i perimeve në Berat dhe Fier: 25% e vendbanimeve të përfshira në studim deklaruan gjatë studimit socio-ekonomik se kultivonin perime si një aktivitet plus për të siguruar jetesën. Në komunat Otlak, Kutalli dhe Poshnje në rrethin e Beratit si dhe në komunat Mbrostar dhe Libofshë në rrethin e Fierit, perimet kultivohen në sera të mëdha të cilat janë ngritur në shumë pjesë të fshatrave. Ndërtimi dhe përdorimi i serave për kultivimin e perimeve u raportua se ishte një aktivitet gjithmonë e më i përhapur. Në takimet me grupet e përfshira drejtpërdrejt në këtë aktivitet, fermerët në këto zona theksuan se praktikat e organizimit të fermave po bëheshin më të avancuara me futjen e makinerive dhe teknologjisë së re. Kultivimi i perimeve në sera është një biznes fitimprurës duke rritur dhe më pas shitur domate, kastravec dhe sallatë.


Fermerët nuk përdorin persona ndërmjetës për të shitur prodhimin, ata e transportojnë mallin ose drejt qytetit më të afërt (Berat ose Fier), ose e çojnë në një treg të madh shumice në Lushnje, e cila ndodhet në veri të zonës së studimit socio-ekonomik.

Më pas prodhimi shitet në gjithë Shqipërinë ose eksportohet. Fermerët deklaruan se donin të prodhonin më shumë fruta dhe perime, megjithatë ata mendonin se tregu ishte i ngopur dhe thanë se do të hasnin vështirësi në shitjen e prodhimit më të shumtë. Fermerët mendonin se shitja e prodhimit tek një subjekt ndërmjetës do të sillte si rezultat rritjen e shitjeve të prodhimit të tyre me çmime më të mira.

Përveç aktiviteteve kryesore ekonomike të përmendura më sipër, disa fshatra deklaruan se kryenin disa aktivitete të tjera për të fituar të ardhura plus. Prej këtyre aktiviteteve më i përhapuri është rritja e bletëve pasuar nga mbledhje e druve të zjarrit (midis 1% dhe 17% të personave që u përgjigjën) dhe pas tyre, grumbullimi i bimëve mjekësore (midis 1% dhe 5% të personave që u përgjigjën).

7.3.3.4 Industria dhe Tregtia


Të gjitha vendbanimet e përfshira në zonën e studimit kanë të paktën një kafene dhe 1 dyqan ushqimor ku shiten produkte për konsum shtëpiak dhe ushqime të paketuara (biskota, patatina etj). Numri i dyqaneve në çdo vendbanim vjen në rritje në raport me numrin e popullsisë. Kafenetë janë një pikë e rëndësishme bisedash dhe takimesh për burrat e komunitetit. Aty shkëmbehen informacione dhe lajme dhe diskutohet mbi çështjet më të fundit si dhe për politikë. Në përgjithësi gratë nuk hynë nëpër kafene, megjithëse shumë nga këto biznese menaxhohen familjarisht, pra një femër nga familja mund tu shërbejë klientëve dhe të pastrojë. Dyqanet ushqimore janë gjithashtu të rëndësishme për komunitetin dhe në çdo vendbanim u raportua se familje të varfra mund të blejnë artikuj veresi/me listë, dhe t'i paguajnë shumat pjesë – pjesë kur të kenë para.

	<p>Faqe 94 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Aktivitetet industriale dhe tregtare në qytete aktualisht janë në përmasa të vogla ose mesatare, të menaxhuara familjarisht. Këto aktivitete mund të përfshijnë; fabrika të përpunimit ushqimor, fabrika tekstili, biznese ndërtimi, mekanike, etj.


Janë disa zona të reja zhvillimi të planifikuara në rrethet Korçë dhe Fier, siç paraqitet në Figura 7-11, të cilat do të rrisin përmasat dhe numrin e aktiviteteve tregtare dhe industriale në zonën e studimit.

Figura 7-11: Pamje satelitore të Zonës së Zhvillimit në Fier (me ngjyrë blu)



Burimi: VHR Orthomosaics ofruar nga Astrium

Në rrethin e Korçës ndodhet një zonë e madhe zhvillimi e planifikuar të shtrihet përgjatë rrugës kryesore nga qyteti i Korçës drejt atij të Pogradecit, zonë e cila kalon nëpër korridorin e projektuar të gazsjellësit. Zyra e planifikimit rajonal e ka përcaktuar këtë zonë si urbane dhe tani

	<p>Faqe 95 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>


ajo është më kryesorja ndërmjet gjithë zhvillimeve madhore në qarkun e Korçës. Kanë filluar të ngrihen biznese përgjatë kësaj rruge dhe pasi të vihen në zbatim ligjet e planifikimit, zyra rajonale do të hartojë hartat përfundimtare të zonës së zhvilluar sipas planifikimit dhe më pas të fillojë tërheqjen e bizneseve drejt kësaj zone.

Në mënyrë të ngjashme në rrethin e Fierit është planifikuar një zonë e re industriale përgjatë rrugës kryesore e cila kryqëzohet me gjurmën e projektuar të gazsjellësit në komunën Mbrostar. Administrata e qarkut është duke pritur miratimin përfundimtar nga qeveria qendrore para se të fillojë zyrtarisht ndërtimin. Një numër biznesesh të mëdha për shitje ose riparim makinash kanë filluar të hapen përgjatë rrugës, megjithëse disa prej tyre nuk janë të regjistruara ligjërisht.

7.3.3.5 Peshkimi dhe Gjuetia

Peshkimi në Shqipëri kryesisht kryhet si aktivitet në përmasa të vogla nga individë në formën e një aktiviteti shtesë si mjet jetese. Brenda zonës së studimit, një numër midis 2% dhe 4% të personave që u përgjigjën gjatë studimit të familjeve deklaruan se kryenin këtë aktivitet si mjet jetese. Banorë që jetojnë në komunat Topojë dhe Dermenas në rrethin e Fierit deklaruan se kryenin këtë aktivitet si mjet jetese plus. U raportua se ishin 25 familje që zotëronin barka të vogla dhe peshkonin përgjatë bregdetit pranë grykëderdhjes së lumit Seman. Peshkimi me varka kryhet përgjatë gjithë vitit, në varësi të motit. Përveç kësaj, grupe peshkatarësh, gjithashtu peshkojnë përgjatë një distance prej 4 km të lumit Seman duke përdorur rrjeta, por ky aktivitet kryhet vetëm në muajt e verës. Peshkatarët deklaruan se vetëm persona nga komuna Topojë peshkojnë edhe në lum edhe përgjatë bregdetit në këtë zonë, gjithsesi ka familje të tjera përgjatë bregut të përfshira në aktivitete të ngjashme. Pasi kapet, peshku shitet duke e transportuar me motoçikleta nëpër lagjet e fshatit. Peshkatarët deklaruan se ata do të donin të kapnin më shumë peshk pasi pëlqehet dhe nuk mbetet asnjëherë pa u shitur, por me mjetet që ata përdorin harxhojnë shumë kohë dhe sasia që kapin është e pakët.

Gjuetia në Shqipëri kryesisht zhvillohet si aktivitet argëtimi dhe vetëm pak familje e ushtrojnë këtë aktivitet si mjet jetese. Gjuetia është e kontrolluar rreptësisht nëpërmjet licencimit të armëve të gjahut, mbajtjen nën kontroll të numrit të licencave të gjuetisë që lëshohen çdo vit, si edhe duke e lejuar atë në zona të caktuara, në periudha të caktuara të vitit. Njerëzit kryesisht gjuajnë lepuj, pëllumba të egër, dhelpra dhe disa lloje zogjsh të egër. Nga studimi i familjeve u vërejt se midis 3% dhe 14% të personave që u përgjigjën, deklaruan se ushtronin gjuetinë, ku përqindja më e lartë ishte në rrethin e Devollit (14%) ndjekur nga Skrapari (6%). Asnjë familje nga ato të përfshira në studim nuk deklaruan se gjuetia kontribuonte në të ardhurat e tyre, pasi gjahu konsumohet nga familja.

	<p>Faqe 96 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

7.3.3.6 Turizmi

Turizmi në Shqipëri është një industri relativisht e pazhvilluar por në rritje. Numri i turistëve përbëhet kryesisht nga shqiptarë që udhëtojnë brenda vendit; gjithsesi, numri i vizitorëve nga vende të tjera është në rritje me një numër total të turistëve të huaj që ka ardhur në rritje, nga 75,000 në 2005 në 2.8 milion në 2010²¹. Brenda zonës së studimit Berati ishte destinacioni kryesor turistik për vizitorë shqiptarë dhe të huaj. Ky qytet është vend i trashëgimisë botërore përfshirë në UNESCO dhe tërheq afërsisht 500,000 vizitorë në vit vendas dhe të huaj, duke qenë kështu një kontribuues i rëndësishëm për të ardhurat e qytetit.

Vendndodhja e daljes në det ndodhet përafërsisht 100m larg një zone që shfrytëzohet për turizëm nga njerëz që banojnë në zonën përreth. Turizmi aktualisht është në shkallë të vogël dhe përfshin afërsisht 8 rulotë të lëvizshëm, 5 shtëpi të vogla pushimi dhe një kafene të vogël. Dy shtëpi të vogla pushimi ndodhen në një distancë afërsisht 50m nga vendndodhja e daljes në det. Në një nga intervistat që u bënë me informues të rëndësishëm, me personin që drejton sektorin e zhvillimit/ndërtimit në Komunën Topojë, doli se kufizimet mbi përdorimin e tokës aktualisht e ndalojnë ndërtimin e strukturave të përhershme, kështu që ndërtesat e ndodhura përgjatë bregdetit pranë vendndodhjes së daljes në det janë ndërtuar pa leje ndërtimi.

Është planifikuar një zonë zhvillimi turistike për tu ndërtuar përgjatë bregdetit Adriatik në komunën Seman, në rrethin e Fierit. Planet për zhvillimin e bregdetit kanë marrë miratimin nga qeveria qendrore, por aktualisht ndodhen në pritje të fondeve për tu akorduar. Pasi këto fonde të jepen, ato do të përdoren për të ndërtuar një rrugë që do të përshkojë një vijë që nga qyteti i Vlorës në jug, përgjatë bregut deti në qytetin e Durrësit në veri. Kjo zonë zhvillimi do të përfshijë aktivitete si hotele, restorante, kafene dhe bare.


7.3.3.7 Dërgesat nga jashtë dhe ndihma sociale

Të ardhurat nga dërgesat nga jashtë kanë patur një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Shqipërisë që nga viti 1990. Në vitin 2007, një shumë totale prej \$1 miliard të dërguara nga jashtë hynë në Shqipëri, shumë e cila përbën sipas vlerësimeve 15% të GDP²². Dërgesat nga jashtë drejt Shqipërisë janë tre herë më të larta se investimet e huaja neto të drejtpërdrejta dhe janë afërsisht dy herë më të mëdha se sa ndihma zyrtare për zhvillim që merret nga Shqipëria. Një përqindje e lartë e emigrantëve (68,6%) sjellin dërgesa të hollash në Shqipëri, nga të cilat 90% e fluksit të këtyre dërgesave nisen nga vendet Evropiane (UNDP, 2009).

Studimi i familjeve nxori në pah faktin që midis 5% (Skrapar) dhe 18% (Devoll) të personave që u përgjigjën bazohen te dërgesat nga jashtë si burim kryesor i të ardhurave. Përgjatë zonës së studimit u deklarua se shumica e dërgesave dhe shpeshësia e tyre ka pësuar ndryshime që nga viti 2008 si rezultat i krizës ekonomike. Duke filluar që nga fillimi i viteve '90 deri në 2008

²¹ Mbërritja, largimi dhe shpenzimet nga ana e turistëve / vizitorëve në Shqipëri dhe në vende të tjera është marrë nga Organizata Botërore e Turizmit. Gjetet në internet në <http://data.un.org/DocumentData.aspx?q=Albania+Tourism&id=261>

²² Hoti. E. (2009) Remitancat dhe Varfëria në Shqipëri. Departamenti i Ekonomisë në Universitetin Lund

	<p>Faqe 97 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

familjarët rregullisht u kanë dërguar shuma parash pjesëtarëve të familjes, të cilat përdorshin për të ndërtuar shtëpi, për të investuar në tokën e tyre dhe si të ardhura për konsum të përditshëm. Që nga viti 2008 dërgesat nga jashtë ose kanë ndaluar krejtësisht në disa raste, ose janë pakësuar në sasi dhe/ose shpeshtësi. U raportua se kjo ndodhte kryesisht për ato familje që kishin të afërm në Greqi dhe Itali, vende të cilat janë goditur fort nga kriza ekonomike. Banorët deklaruan se mungesa e këtyre dërgesave kishte patur një ndikim të madh në cilësinë e jetës për ta, sepse shumë njerëz tani nuk arrijnë të përballojnë nevojat bazë.

Ndihma sociale për familjet në nevojë jepet nga administrata e bashkisë ose e komunës. Familjet ose individët që përfitojnë ndihmë sociale duhet të futen në një nga këto 4 kategori:


- Familje me të ardhura të pamjaftueshme;
- persona jetim, mbi 25 vjeç;
- persona jetim të moshës 18-25 të cilët nuk ndodhen institucione të shërbimit social ose nën kujdestari; ose
- prindër me më shumë se 2 fëmijë;

Familjet përfitojnë një shumë maksimale 60€ (7500 Lek) në muaj, pavarësisht numrit të fëmijëve në familje. Familjet që jetojnë jashtë zonave urbane janë përfituese në një shkallë të caktuar në varësi të tokës dhe numrit të bagëtive që zotërojnë. Sipas përlogaritjeve të INSTAT, ndihma sociale mesatare për familje varion nga 159 në 300 Euro në muaj. Të dhënat zyrtare raportojnë se sasia mesatare e ndihmës sociale për qarkun e Korçës është rreth 166 Euro në muaj dhe 230 Euro në muaj në qarkun e Beratit (INSTAT, 2006-2007). Megjithatë, familjet e përfshira në zonën e studimit deklaruan se merrnin shumë më pak se kaq, ku në disa raste merrnin vetëm €10 në muaj.

Gjatë studimit të vendbanimeve u raportua se numri i personave që merrnin ndihmë sociale është i ulët, sepse pronësia mbi tokën dhe bagëtitë është në nivel të lartë. U raportua se janë afërsisht 1 ose 2 familje në çdo vendbanim të përfshirë në studim që marrin ndihmë sociale nga qeveria. Kjo shifër mbështetet edhe nga rezultatet e studimit të familjeve (paraqitur në Figura 7-6 më sipër), nga i cili rezultoi se 10% e personave që u përgjigjën në vendbanimet e përfshira në studim në rrethin e Skraparit bazohen te ndihma sociale si burim i tyre kryesor i të ardhurave, megjithatë në të gjithë rrethet e tjerë ky numër bie në nivelet 4% dhe 2%.

Të gjithë personat e moshuar përfitojnë pension nga shteti sipas kontributit që kanë dhënë gjatë komunizmit. Megjithatë, shuma që marrin varion në varësi të punës që kanë kryer. Personat që kanë punuar në bujqësi, në ferma kolektive ose kooperativa marrin 60€ në muaj, ndërsa ata që kanë punuar në punë shtetërore marrin 115€. Pensionet janë një burim i rëndësishëm të ardhurash për banorët e moshuar, por konsiderohen edhe si ndihmë shtesë për ata që jetojnë me familjet e tyre.


Banorët e moshuar që jetojnë vetëm thanë se hasnin vështirësi për të mbijetuar me pensionet e tyre, sidomos kur janë shumë të moshuar e nuk mund të punojnë tokën e të sigurojnë prodhime prej saj.


	Faqe 98 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

7.3.4 Mjedisi socio-ekonomik në pjesën detare

Ky seksion paraqet një vështrim të përgjithshëm të karakteristikave socio-ekonomike që gjenden në pjesën detare të Projektit TAP në Shqipëri. Zona e studimit socio-ekonomik përfshin një korridor me gjerësi të ndryshueshme sipas çështjes së trajtuar, nga vendndodhja e daljes në det në bregdetin Adriatik, nëpër ujërat territoriale shqiptare deri në vijën e pranuar midis ujërave të Shqipërisë dhe atyre të Italisë, në një distancë të përafërt 55 km nga bregu. Figura 7-12 më poshtë paraqet një hartë të zonës së studimit socio-ekonomik për pjesën detare përse i përket pjesës shqiptare të Projektit TAP, përfshirë dy portet kryesore të Shqipërisë, të Durrësit dhe Vlorës, brenda zonës së ndikimit të projektit.

Figura 7-12: Zona e studimit socio-ekonomik në pjesën detare (me ngjyrë të kuqe)



	<p>Faqe 99 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Burimi: ERM

Të dhënat e paraqitura në këtë seksion janë marrë nga burime dytësore të disponueshme publikisht përkrahë të dhënave primare të mbledhura gjatë një vizite në terren, pra në zonë, në qershor 2011, duke përfshirë këtu informacion nga takime me persona të përfshirë drejtpërdrejt në këtë aktivitet me peshkatarë si dhe nga intervista të marra nga informues të rëndësishëm, zyrtarë të portit të Vlorës.

Baza referuese mjedisore socio-ekonomike në pjesën detare përqendrohet në porte, lundrim, aktivitetet e anijeve dhe peshkim. Një përshkrim i detajuar i mjedisit socio-ekonomik të pjesës tokësore mund të gjendet në kapitujt 7.2 dhe 0, i cili përfshin gjithashtu informacion mbi vendbanimet që ndodhen pranë vendndodhjes së daljes në det dhe mbi zonat turistike dhe çlodhëse pranë bregut.

7.3.5 Portet

Ndodhen 4 porte kryesore në Shqipëri: Durrës, Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë. Durrësi ndodhet mbi 55 km në veri dhe Vlora 40 km në jug të vendndodhjes së daljes në det (shih Figura 7-12) Saranda dhe Shëngjini ndodhen më larg.

7.3.5.1 Porti i Durrësit

Durrësi është porti kryesor në Shqipëri për lëvizjen e mjeteve detare dhe ndodhet pranë qytetit të Durrësit, 33 km në perëndim të kryeqytetit Tirana. Përveç anijeve të peshkimit porti mban disa lloje të tjera mjetesh lundruese përfshirë këtu: anije transporti, jahte dhe anije cisternë. Janë tre kompani traqetesh që operojnë me transport udhëtarësh nga Durrësi në Ankona dhe Bari në Itali gjatë 7 ditëve të javës. Figura 7-13 më poshtë paraqet një foto të Portit të Durrësit.


	<p>Faqe 100 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Figura 7-13: Pamje e Portit të Durrësit




Burimi: wwwapDurrës.com.al

Porti ka 11 vende ankorimi që variojnë në gjatësinë e tyre nga 30m-400m dhe ka një thellësi midis 7 m-11 m. Durrësi ka afërsisht 2,700 mjete lundruese që hyjnë e dalin në port çdo vit. Porti ka kapacitet për të përpunuar 3 milion ton mallra çdo vit dhe aktualisht menaxhon 85% të eksporteve dhe importeve në Shqipëri. Në vitin 2010 në Durrës hynë 1,601,321 ton mallra, një vëllim kontejnerësh prej 66,000 TEU²³ dhe 1,162,321 pasagjerë trageti.

Pranë hyrjes së portit ndodhen disa mbetje anijesh që nga Lufta e Dytë Botërore dhe ka urdhëresa të cilat detyrojnë përdorimin e mjeteve rimorkiuese. Gjithashtu porti i Durrësit ka një kurs specifik të rekomanduar për anijet kur i afrohen portit, i cili nevojitet për të shmangur pengesat nën ujë.

Porti i Durrësit administrohet nga Autoriteti Portual Durrës, i cili është përgjegjës për gjithë aktivitetet në port d.m.th. përpunimin e mallrave, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe superstrukturës detare dhe portuale, pajisjeve dhe ndërtesave, kryen veprimet e ngarkimit dhe shkarkimit si dhe magazinimin e mallrave, po kështu tërheqjen e mallrave nga mjetet rrugore dhe hekurudhore. Aktualisht në port janë duke u kryer punime mirëmbajtjeje dhe përmirësimi, të cilat kanë filluar në vitin 2011.

²³ TEU është shkurtime i fjalëve në anglisht – njësi ekuivalente me 20 ft, e cila është një njësi jo-ekzakte e kapacitetit të mallrave që shpesh përdoret për të përshkruar kapacitetin e anijeve të kontejnerëve dhe terminaleve të kontejnerëve, bazuar në kontejnerin inter-modal prej 20 ft (6.1 m) të gjatë.

	<p>Faqe 101 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

7.3.5.2 Porti i Vlorës

Vlora është porti detar i dyti për nga madhësia në Shqipëri, i cili mban anije mallrash, anije transporti, anije cisternë dhe anije peshkimi. Porti ka një thellësi 7.6 m dhe ka gjatësi të mjaftueshme ankorimi për anijet e projektit.

Dy kompani operojnë zakonisht tragetet e pasagjerëve nga porti i Vlorës për në Bari dhe Brindisi në Itali. Megjithatë bashkia e Vlorës ka anuluar kontratën me një nga kompanitë e trageteve, për arsye të mos-respektimit të rregulloreve të sigurisë. Në këtë periudhë nuk operojnë tragete nga porti i Vlorës.

Ndërtimi i një terminali të ri për kontejnerë në portin e Vlorës filloi në vitin 2009, megjithatë është e paqartë se kur do të vihet në funksionim terminali i ri.

7.3.6 Trafiku detar

Deti Adriatik është një hapësirë lundrimi e ngarkuar, ku përqendrohen një numër i madh i rrugëve detare Veri-Jug, ku bashkë-ekzistojnë anije tregtare, anije cisternë (me vaj, gaz, kimikate), tragete, anije të mëdha turistike, mjete lundruese peshkimi, anije luftarake dhe të tjera anije turistike.

Figura 7-14 paraqet rrugët e trafikut që janë krijuar në këtë zonë, ku tregohet rruga kryesore gjatësore, rruga gjatësore lindore (përgjatë ishujve të Kroacisë), rruga gjatësore perëndimore (përgjatë bregdetit Italian), dhe rrugët e tërthorta (përfshirë atë midis porteve të Durrësit dhe Vlorës në Shqipëri dhe Brindisi në Itali). Autoriteti Portual që operon në portet kryesore të Shqipërisë është subjekt i ligjshëm, i cili menaxhon veprimet në port dhe trafikun detar përfshirë transportin e mallrave, lundrimet turistike, transportin e pasagjerëve, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave.

Figura 7-14 paraqet fluksin e trafikut në detin Adriatik bazuar në një studim të kryer në shtator 2008 nga ekspertë në Fakultetin e Studimeve Detare në Universitetin e Rijeka, Kroaci. Rezultatet e studimit tregojnë se trafiku detar në pjesën Shqiptare ku kalon gazsjellësi është në shkallë të ulët krahasuar me rrugën kryesore gjatësore perëndimore përgjatë bregdetit Italian, apo me rrugët e tërthorta në veri.




	Faqe 102 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Figura 7-14: Trafiku Detar monitoruar në 2008 (gazsjellësi me të kuqe)



Burimi: Transporti dhe Aksidentet e Mundshme në Detin Adriatik, Damir Zec, Ph.D et al, 2009


Fakti i trafikut detar në shkallë të ulët në pjesën Shqiptare është konfirmuar gjithashtu nga vlerësimi që i është bërë dendësisë së trafikut të anijeve, vlerësim i cili u zhvillua si pjesë e Analizës së Rrezikut të Gazsjellësit në Pjesën Detare, miratuar nga TAP në vitin 2010. Rezultatet e vlerësimit të trafikut të anijeve që kalojnë tërthorë gazsjellësit tregohen në Figura 7-15 më poshtë. Figura paraqet dendësinë e trafikut të anijeve në zonën që ka lidhje me gjurmën e gazsjellësit. Ngjyrat që variojnë nga e verdha në të kuqe dhe të zezë përdoren për të treguar

	<p>Faqe 103 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

dendësinë e trafikut të anijeve për të dhënat përkatëse nga Sistemi Automatik i Identifikimit²⁴ (AIS në anglisht).

Është e qartë që zona përreth Durrësit është me ngjyra më të errëta si pasojë e një numri më të madh të mjeteve lundruese të vëzhguara në zonë.

Figura 7-15: Skicë e Dendësisë së Trafikut të Anijeve (gjurma e gazsjellësit me të kuqe) (anije/ditë)



Burimi: TAP

7.3.6.1 Trafiku i Trageteve

Trafiku i trageteve që kalojnë tërthorë gazsjellësit krijohet kryesisht nga lëvizjet e trageteve ndërmjet Italisë dhe Greqisë. Është identifikuar vetëm një rrugë tragetesh midis Italisë dhe Shqipërisë. Lëvizjet e tyre, të cilat operohen nga gjashtë kompani të ndryshme, nisen kryesisht nga Venecia, Bari ose Brindisi në Itali dhe mbërrin në Igumenica, Korfuz, Patra, Cefalonia në Greqi ose në Vlorë, Shqipëri. Tabela 7-5 paraqet linjat e ndryshme që i përkasin secilës kompani dhe numrin e kalimeve në vit.

²⁴ Për të vlerësuar vëllimin dhe veçantitë e qarkullimit të anijeve që kryqëzohen me gazsjellësin, u morën në konsideratë të dhëna të ndryshme nga ana e TAP: (a) të dhënat nga Sistemi Automatik i Identifikimit u përdorën për të marrë informacion cilësor për vendet ku anijet kryqëzoheshin me gazsjellësin, dhe (b) numri specifik i anijeve që kryqëzohen me gazsjellësin u morën nga raporti mbi fluksin e trafikut detar në Detin Adriatik, /25/, dhe nga informacioni i mbërritjes së anijeve në porte në Detin Adriatik.



Tabela 7-5: Linjat e trageteve që kalojnë tërthor gazsjellësit


Kompania e trageteve	Burimi i informacionit	Nga/Për në	Nga/Për në	Tragetet	Numri i Kalimeve në vit
Anek Lines	http://www.aneke.gr	Venezia	Igoumenitas, Korfuz, Patras	Sophocoles, Lefka Orl	416
		Ancona	Igoumenica, Patras	Olympic Champion, Hellenic spirit	716
Superfast ferries	http://www.superfast.com/	Ancona	Igumenica, Patras	Superfast I, V, VI, XI, XII	1040
		Bari	Igumenica, Korfuz, Patras	Superfast I, V, VI, XI, XII	728
Minoan Lines	http://www.minoan.gr	Venezia	Igumenica, Korfuz, Patras	Ikarus Palace, Zeus Palace	352
		Ancona	Igumenica, Patras	Olympia Palace, Europa Palace	616
Agoudimons Lines	http://agoudimos-lines.com	Bari	Igumenica, Patras	Ionian King	728
		Bari	Cephalonita	Ionian King	728
		Brindisi	Korfuz, Igumenica	Ionian Sky	624
		Brindisi	Vlorë	Kapetan alexdheros	624
Endeavor Lines	http://www.endeavor-lines.com	Brindisi	Patras	Elli T, Erotokritos T, Ionian Queen	298
		Brindisi	Igumenica	Elli T, Erotokritos T, Ionian Queen	377
		Brindisi	Korfuz	Elli T, Erotokritos T, Ionian Queen	64
		Brindisi	Cepgalonia	Elli T, Erotokritos T, Ionian Queen	81
Ventouris Lines	http://www.ventouris.gr	Bari	Korfuz, Igumenica	Polaris, Sea Trade	490

Burimi: TAP

Sipas vlerësimit të rrezikut në pjesën detare të kryer nga TAP, vlerësohet se do të kalojë një tragjet pasagjerësh tërthorë gazsjellësit afërsisht 7,900 herë në vit. Për sa i përket karakteristikave të këtyre trageteve u arrit në konkluzionin se shumica e trageteve kanë një kapacitet prej më shumë se 1,000 pasagjerë me një mesatare kapaciteti prej 1,400 pasagjerë.


7.3.7 Peshkimi në zonën e studimit

Nuk ka zona për zbarkim ose pjesë të banuara bregdetare në afërsi të zonës së daljes në det të gazsjellësit, prandaj peshkimi në zonën e studimit përbëhet nga aktivitete peshkimi në shkallë të vogël artizanale dhe peshkim me rrjeta, të cilat kryhen në thellësinë 30 m dhe afërsisht 6.5 km nga bregu (në mes të distancës nga ndarja me ujërat Italiane).

	Faqe 105 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al


Në nivel lokal, peshkimi artizanal në përmasa të vogla në lumenj dhe përgjatë bregdetit zhvillohet nga banorët e fshatrave Sheq-Marinas, Seman dhe Kavaklli, në komunës Topojë (rrethi Fier). Figura 7-16 më poshtë paraqet komunitetet vendase të peshkimit në komunat Dermenas dhe Topojë. Zona më e afërt për zbarkim është porti i Vlorës që ndodhet më shumë se 40 km në jug të zonës së daljes në det. Nuk ka zona zbarkimi të përhershme apo të përkohshme në veri të gjurmës së gazsjellësit.

Figura 7-16: Komunitetet lokale të peshkimit



Burimi: ERM

Peshkimi zhvillohet kryesisht si aktivitet shtesë për të siguruar jetesën për familjet e përfshira në zonën e studimit, më shumë sesa si aktivitet kryesor ekonomik. Një takim me persona të përfshirë drejtpërdrejt në këtë aktivitet u zhvillua me një grup peshkatarësh që jetojnë në Kavaklli

	<p>Faqe 106 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

në komunën Topojë, të cilat deklaruan se janë 25 familje në këtë zonë të cilët zotërojnë varka të vogla dhe peshkojnë përgjatë bregut pranë grykëderdhjes së lumit Seman (Shih Figura 7-16). Ata që nuk zotërojnë varka peshkojnë në grykëderdhje të lumit Seman duke përdorur rrjeta. Të organizuar në dyshe me radhë gjatë një periudhe 24-orë ata hedhin rrjeta përgjatë një gjatësie 4 km të lumit.

Familjet që kanë varka peshkojnë përgjatë gjithë vitit, në varësi të motit, ndërsa peshkatarët që peshkojnë në lum e bëjnë këtë vetëm gjatë muajve të verës. Peshkatarët thanë se nuk vinin njerëz nga zona të tjera për të peshkuar në zonën e daljes në det, në Seman apo në zonën e daljes në det, megjithatë banorët e fshatrave përgjatë bregut në veri dhe në jug të zonës së daljes në det peshkojnë në ujërat që janë pranë fshatrave të tyre. Peshkimi është shumë i lokalizuar përreth plazheve pranë fshatrave përkatës.

Pasi kapet, peshku shitet nëpër lagjet e fshatit duke e transportuar me motoçikleta. Gjatë takimeve me peshkatarët ata theksuan se peshku kërkohet dhe nuk mbetet asnjëherë pa u shitur. Peshkatarët do të donin të kapnin më shumë peshk, por me mjetet që ata përdorin harxhojnë shumë kohë dhe sasia që kapin është e pakët.

Anijet e mëdha të peshkimit që vijnë nga portet e Vlorës ose Durrësit, apo diku nga Italia apo ndoshta edhe vende të tjera, përtej vijës të ujërave territoriale prej 20 km, praktikojnë peshkimin me rrjeta fundore në zonën e studimit. Këto mjete kryesisht lundrojnë diku në distancat nga 6.5 km deri në 65 km nga bregu për të peshkuar. Peshkimi me rrjeta fundore është një metodë peshkimi e larmishme, e cila përdor disa modele pajisjesh, të përmasave, materialeve dhe metodash të ndryshme. Zona e studimit nuk konsiderohet si vend i pasur për peshkim krahasuar me zona të tjera të bregdetit shqiptar, gjithsesi ekziston ky lloj aktiviteti.


7.4 Zonat me rëndësi kombëtare

Bazuar në Ligjin nr. 10119, më datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, si edhe bazuar në legjislacionin përkatës për sektorin e gazit, mjedisin dhe qeverisjen vendore, METE i propozoi AKPT (Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit) të ndërmerre iniciativën për përcaktimin e rëndësisë kombëtare të projektit TAP në planifikimin e territorit'.

AKPT, duke ndjekur procedurën ligjore në fuqi, filloi punën për përcaktimin e projektit TAP si një çështje me rëndësi kombëtare.

Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) me anë të vendimit të tij nr. 2, datë 20.12.2012 përcaktoi projektin TAP si një çështje me rëndësi kombëtare dhe u vendos që një korridor prej 500 m i gjurmës së TAP të jetë një zonë me rëndësi kombëtare.

Bazuar në të dhënat e disponueshme brenda kësaj zone, nuk ekziston zonë tjetër me rëndësi kombëtare e krijuar për interes të ndonjë projekti tjetër, bazuar në Ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar.

	<p>Faqe 107 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

8 Përcaktimi i territorit për projektin TAP brenda korridorit 500 m

8.1 Karakteristikat e gjurmës së gazsjellësit në seksionin detar

Rasti bazë i gjurmës së përzgjedhur nëpër Shqipëri mund të ndahet në pesë seksione të veçanta të pjesës kontinentale, bazuar në mjedisin e tyre natyror dhe përdorimin e tokës. Nga lindja në perëndim sipas pikës kilometrike (pk) ose një vije imagjinare e përdorur për të matur distancën, që shpesh korrespondon me qendrën e një rruge të drejtë të gjurmës së gazsjellësit, karakteristikat kryesore janë si më poshtë:


Seksioni lindor (pk 0-50) i gjurmës kalon pranë qytetit të Korçës dhe është kryesisht ultësirë bujqësore, ku dominojnë të korrat sezonale me vende veçuara të korrash të përhershme.

Ky seksion i gjurmës kalon përmes lumit të Devollit dhe përmes shumë rrjedhave të tjera më të vogla të cilat kanë habitate ujore dhe pyje bregore të rëndësishme ekologjike. Gjurma gjithashtu kalon në afërsi të një pjese të Rezervuarit Natural të Menaxhuar të Cangonjit (me status ruajtje të kategorisë IV të IUCN – (Bashkimit Nderkombëtar për Ruajtjen e Natyrës).

Pjesa më e madhe e korridorit të seksionit qendror-lindor (pk 50-65) është e pyllëzuar, me zona të prodhimeve të korrash sezonale të gjetura në vendbanimet përreth. Komuna e Vithkuqit është kodrinore, me një larmi zonash pyjore, kullota dhe prodhim të korrash sezonale.

Zona e seksionit qendror (pk 65-130) është kryesisht malore me një lartësi mbi 2,000 metra mbi nivelin e detit; lumi i Osumit (rrjedha kryesore në lumin e Semanit) është burimi i ujit më i rëndësishëm brenda korridorit. Ai fillon në malin e Ostrovicës dhe kalon përmes një zone me pyje të përziera. 20 km e para të gjurmës në këtë seksion janë të largëta, me një fshat të quajtur Backë, të vendosur në fund të rrugës që lidh këtë fshat me Çorovodën (qendra e rajonale e popullsisë), të cilat kalojnë përmes qytetit të Çorovodës përpara së të kalojnë përmes Komunave të Qendër (rrethit të Skraparit), Vëndreshë, Bogovë dhe në Poliçan. Ekziston një përzjerje pyjesh dhe kullotash në zonat malore, dhe kryesisht tokë bujqësore në luginat e ultësirës së lumit të Osumit.

Seksioni qendror-perëndimor (pk 130-185) i gjurmës fillon në Poliçan dhe vazhdon në perëndim përmes Beratit dhe veriut të Fierit deri sa arrin në fshatin Strum. Gjurma kalon përmes një larmi peisazesh, duke filluar në një zonë malore jashtë Poliçanit në të cilën ka varietete të prodhimit të korrave sezonale dhe të përhershme si edhe kullota. Gjurma kalon në veri të qytetit të Beratit përmes një zone ullishtore, vreshtore dhe me pemë frutore (burimi i të ardhurave kryesore në këtë zonë). Më pas gjurma hyn në tokën e Komunës së Kutallit ku ka një përzjerje të pyllit me tokën e punueshme. Ndërsa gjurma lë Komunën e Kutallit toka fillon të rrafshohet dhe gjithnjë e më shumë dominojnë fusha të mëdha bujqësore, me komuna të cilat mbështeten në të korrat sezonale si gruri, misri, tërshëra dhe perimet.

	<p>Faqe 108 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Seksioni perëndimor (pk 185-209) i gjurmës është i vendosur në qarkun e Fierit. Fillon me një zonë me kodra të valëzuara e cila më pas rrafshohet ndërsa gjurma lëviz drejt bregdetit të Adriatikut. Në këtë zonë vendbanimet janë të mëdha dhe të lidhura mirë me njëra tjetrën. Bujqësia mbetet e rëndësishme; veçanërisht blegtoaria, por gjithashtu prodhimi i perimeve në sera të gjera. Ekzistojnë disa zona të mëdha industriale në dhe përreth Fierit të cilat ofrojnë gjithashtu alternativa punësimi. Ky seksion përshkon fushën bregdetare të zonës natyrore të Grykëderdhjes të Semanit-Pishë Poro (Fier), e cila mbështet një gamë të gjerë të habitateve ekologjike dhe një grumbull të larmishëm të zogjve, përfshirë dallëndyshe që mbarështohen dhe grabitqarët dimërorë. Pamvarësisht përpjekjeve për drejtimin e gjurmës, ekzistojnë disa sajte të njohura për rëndësinë e ruajtjes përmes të cilave kalon gjurma ose në afërsi të të cilave kalon gjurma: lumi i Semanit (në veri-perëndim të fshatit Mujalli) ka pyll të pasur bregdetar përgjatë brigjeve të tij dhe rezervuare uji të vendosura disa qindra metra në lindje dhe perëndim të pikës së kalimit; dhe lagunat bregdetare dhe moçalet kripore të vendosura në veri të daljes në det konsiderohen me rëndësi të veçantë ekologjike.


8.2 Karakteristikat e gjurmës së gazsjellësit në pjesën kontinentale

Seksioni i pjesës tokësore i gjurmës së gazsjellësit do të zgjerohet përafërsisht 60 km nga dalja në det në bregdetin shqiptar në vijën e mesit në Gjirin e Otrantos (dmth në mes të rrugës ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë në detin Adriatik²⁵). Seksioni fillon në një plazh i vendosur në perëndim të Fierit (shikoni detajet në hartën bashkëngjitur 6 dhe 7).

Seksioni pranë bregut është afërsisht 7 km i gjatë, me thellësi uji afërsisht deri në 30 m, duke u shtrirë përgjatë një bregu me pjerrësi të lehtë dhe të rregullt (< 3%). Pas kësaj pike hyn në seksionin e pjesës tokësore duke krijuar një pjerrësi rreth 100 m thellësi uji, ku pas 30 km kalon kufirin e ujërave territorial shqiptare (dmth 12 milje / përafërsisht 20 km drejtpërsëdrejti nga bregdeti). Pas 23 km të tjera, në një thellësi prej afërsisht 750 m, kalon në ujërat territoriale italiane.

Zona e pjesës tokësore e projektit është e vendosur afërsisht 150 km në veri të kalimit ndërmjet detit Jon dhe detit Adriatik me një mjedis fizik dhe biologjik tipik për këtë pjesë të detit të Mesdheut. Shkëmbimi i ujërave ndërmjet detit Adriatik dhe detit Jon ndjek një model sezonal; në rajonin lindor, derdhja e ujit nga deti Jon mbizotëron, megjithatë gjatë pranverës dhe verës, mekanzimi i shkëmbimit dobësohet dhe gjatë vjeshtës, rrjedha e ujit të thellë të Adriatikut është e lartë. Për sa i përket morfologjisë, fusha e tabanit detar të thellë gjendet përafërsisht në vijën mesatare ndërmjet ujërave italiane dhe shqiptare, dhe pjerrësia kontinentale shqiptare pritet thikë me kanione dhe kanale. Në afërsi të bregut shqiptar dhe seksionit bregdetar shtrati i detit është shumë i rrafshët, për shkak të recesionit historik bregdetar.

²⁵ Seksioni i pjesës tokësore nga pika e mesit të rrugës në daljen e detit Italian përcaktohet në VNMS e projektit TAP për Italinë.

	<p>Faqe 109 nga 147</p>
<p>Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik</p>	<p>Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al</p>

Mjedisi në afërsi të bregut përgjatë bregdetit shqiptar është ndikuar nga ndotja e konsiderueshme gjatë 30 viteve të fundit, si nga shkarkimi i ujërave të ndotura të lumit në det dhe nga shkarkimi i drejtpërdrejt i ujërave të zeza të patrajuara industriale dhe urbane. Sedimentet në afërsi të bregut kanë rritur nivelet e përqendrimeve të metalit. Nuk janë gjetur habitate të ndjeshme dhe të mbrojtura në zonën e drejtpërsëdrejtë të ndikimit të projektit përgjatë këtij seksioni në afërsi të bregut. Gjithashtu nuk ka sajte detare të mbrojtura të përcaktuara ose të propozuara brenda një rreze prej 30 km nga dalja në det e gazsjellësit.

Ujërat e pjesës tokësore janë një gjurmë migrimi e rëndësishme për baza folesh të breshkave të detit të vendosura më tej në veri, por nuk u gjetën prova për baza folesh në seksionin e bregdetit shqiptar ku propozohet dalja në det. Njihen shtatë lloje gjitarësh detar që jetojnë në detin Adriatik, ku më të zakonshmit janë balenat hiperodon dhe delfinët me shirita.

Lloji kryesor i aktivitetit të peshkimit përgjatë bregdetit shqiptar është peshkimi me tratë (rrjetë) dhe në një shkallë pak më të ulët me rrjeta të mëdha tralë, në të dyja rastet peshkimi kryhet në portet kryesore. Nuk ka sajte të zbarkimit ose komunitete bregdetare në afërsi të zonës së daljes në det. Aktivitetet e peshkimit në zonën e propozuar të projektit përfshijnë zona peshkimi artizanale në një shkallë shumë të ulët, dhe zonat e peshkimit me tratë që fillojnë në një distancë prej afërsisht 6 deri në 7 km nga bregdeti dhe zgjerohen në kufirin me Italinë. Trafiku detar është gjithashtu jo i shpeshtë në zonën e projektit në krahasim me pjesë të tjera të Adriatikut. Ekziston infrastrukturë e kufizuar turizmi në zonën bregdetare të projektit, me plazhe kryesisht të përdorura nga popullsia vendase gjatë muajve të verës.


8.3 Zonat koncesionare

Për hir të qartësisë, zonat koncesionare janë zonat e ashtquajtura në të cilat kompanitë private kryejnë aktivitetin ekonomik të liçensuar, të autorizuar dhe /ose të kontraktuara nga ente publike ose qeveria shqiptare.

METE ka trajtuar kërkesat e institucioneve të ndryshme në Shqipëri me qëllim marrjen e përgjigjes së tyre në lidhje me projektet/zonat koncesionare brenda korridorit prej 2km të gjurmës së TAP; METE ka kontaktuar institucionet e ndryshme:

- Këshillat Rajonal të Beratit, Korçës, dhe Fierit, me anë të letrës nr. prot. 5542, datë 08.06.2012; letra i është dërguar për dijeni Kabinetit të Kryeministrit dhe Ministrisë së Brendshme;
- Institucione të ndryshme në varësi të METE si (KESH, OST sha, Albpetrol sha, AKBN dhe SHGJSH), me anë të letrës me nr. Prot. 5543, datë 08.06.2012;
- Ministrinë e linjës (MPPT, MMPAU, MBUMK, MTKRS dhe Ministria e Mbrojtjes) me anë të letrës me nr. Prot. 5544, datë 08.06.2012.

Shtojca 2 tregon të gjitha letrat e dërguara si përgjigje nga institucione të ndryshme në METE në lidhje me zonat e koncesionit brenda korridorit 2 km të gjurmës së TAP.


	Faqe 110 nga 147
Autoriteti Planifikimit Ministria Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Titulli i Dokumentit: Plani Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik	Adresa: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", 1001, web: www.mete.gov.al

Aktiviteti i minierave në Shqipëri kryhet nga kompani private, sipas kushteve të vendosura në liçensat përkatëse të nxjerra nga METE. Në shtojcat 7 dhe 8 sigurohet informacion për zonat minerare brenda 2 km të korridorit të projektit të TAP.

Lista ne Tabela 8-1 jep informacion mbi zonat minerare qe ndodhen Brenda, ose ne aferi te gjurmes prej 500 m te korridorit te projektit TAP.

Tabela 8-1: Lista e zonave minerare qe ndodhen brenda, ose ne aferi te gjurmes prej 2 km te korridorit te projektit TAP

Nr .	Stacioni (km)	Nr. i lejes (Ref. METE)	Data e miratimit	Lloji i Lejes	Sipërfaqja km ²	Lloji i mineralit	Vendndodhja e Vendburimit minerar	Afërsia me korridorin
1	5	L1436		Zbulimi	0,972	Fe-Ni	Bilisht	brenda gjurmës
2	39	L838		Shfrytëzimi	0,22	Argjile		
3	50,8	L729	30.09.2003	Shfrytëzimi	0,012	Gëlqeror	Bellovode	
4	51	L842	07.02.2005	Shfrytëzimi	0,03	Gëlqeror	Fshati Floq	
5	52	L847	18.03.2005	Shfrytëzimi	0,08	Gëlqeror	Floq	
6	59	L1545	15.04.2011	Shfrytëzimi	15	Bakër	Bregu i Gështenjës	brenda gjurmës
7	59	L1327	17.03.2009	Shfrytëzimi	24,5	Bakër	Rehove	brenda gjurmës
8	113	L1218		Kerkim-Zbulimi	2,2	Ranorë pllakorë	Qender / Vendreshe	brenda gjurmës
